



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 412 Akti

Nr. 567 Vendimi
Tiranë, më 28.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------------|----------|
| Roland Ilia | Kryesues |
| Pamela Qirko | Relatore |
| Valbona Sanxhaktari | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Steven Kessler, në datën 26.9.2022, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seanca dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Shefkie Mataj (Demiraj)**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Shefkie Mataj (Demiraj), me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 20.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit¹.

5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe

¹Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 20.12.2019.

Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin² e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Shefkie Mataj (Demiraj), në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë;*
- ii. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. ka kryer deklarim të rremë;*
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin³ e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dhe analizuar tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor që i përkasin periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të dhënat nga burimet arkivore, duke dërguar një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Pasi u njoh me rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, në datën 9.6.2022, anëtarja e trupit gjykues, komisionere Etleda Çiftja, deklaroi pasjen e konfliktin e interesit me subjektin e rivlerësimit, duke kërkuar heqjen dorë nga vlerësimi/shqyrtimi i kësaj çështjeje.

15. Në datën 14.6.2022, trupi gjykues i ngritur për këtë shkak⁵, me shumicë votash, vendosi pranimin e kërkesës për dorëheqje të komisioneres Etleda Çiftja nga vlerësimi/shqyrtimi i çështjes së subjektit të rivlerësimit.

16. Pas miratimit të kësaj kërkesë, pjesë e trupit gjykues u bë anëtari zëvendësues, komisionere Valbona Sanxhaktari, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.

17. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 2.9.2022, vendosi⁶: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të

²Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë me nr. *** prot., datë 5.10.2018.

³Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 20.1.2021, të KDZH-së.

⁴Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 23.11.2021.

⁵Trupi gjykues i ngritur me vendimin nr. ***, datë 9.6.2022, të Komisionit.

⁶Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 2.9.2022.

rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18. Subjekti i rivlerësimit, në datën 6.9.2022, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 9.9.2022, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve në datën 20.9.2022, në rrugë elektronike me *e-mail*, duke i depozituar edhe fizikisht provat mbështetëse në Komision⁷.

19. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁸. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 23.9.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

20. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 26.9.2022, ora 12:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

20.1. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Znj. Shefkie Mataj (Demiraj) ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

21.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

22.1. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit që kryhet nga Komisioni.

⁷Provat e depozituara sipas listës së inventarizuar, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.9.2022.

⁸Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 22.9.2022.

22.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

22.4. Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

22.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; (b) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (c) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (d) denoncimet e publikut; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e saj.

23.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

23.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat janë deklaruar si burim i krijimi të pasurive. Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të

⁹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

dorëzuar në ILDKPKI më 29.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

24. Pasuria e llojit “shtëpi banimi”, tri kate + papafingo, e ndërtuar në vitet 1998 – 2012, e legalizuar në datën 6.8.2012, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 20.11.2012, rivlerësuar në datën 23.5.2013, si dhe truall me sipërfaqe 461.5 m². Kjo shtëpi banimi ndodhet në adresën: rruga “****”, sipër Q.S, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë.

24.1. Në vijim, lidhur me këtë pasuri, ka deklaruar se toka me sipërfaqe 710 m², ku është ndërtuar shtëpia (të cilën deklaroi se e kanë ndërtuar vetë), është blerë në vitin 1998 nga bashkëshorti (provuar ky fakt me kontratën e shitblerjes së truallit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.1998).

24.2. Si vlerë të ndërtimit të kësaj shtëpie, subjekti ka deklaruar shumën prej 20,000,000 lekësh, nga të cilat 5,000,000 lekë janë dhënë nga kunati, i ndjeri S.H, i cili i ka shitur shtetasit S.M shtëpinë në Bajram Curri, në vlerën 500,000 lekë, si dhe mjetin tip “****”, të përfituar nga privatizimi i ndërmarrjes së grumbullim-përpunimit, në vlerën prej 600,000 lekësh, shtetasit P.K.

24.3. Subjekti deklaroi se një kat banimi (kati i parë) është i familjes së vëllait të bashkëshortit, ku jeton e veja e tij S.H me djalin e vogël E.H (fakt ky i njohur nga gjithë komuniteti dhe të afërmit e tyre). Në ndërtimin e katit të kunatit kanë kontribuar vajza V.H, që jeton në Kanada prej 17 vjetësh dhe djali I.H, që jeton në Itali prej 14 vjetësh.

24.4. Subjekti deklaroi se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

24.5. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar:

- i. të ardhurat në shumën 800,000 lekë, të përfituara nga shitja e apartamentit 3+1, në qytetin e Bajram Currit, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2001;
- ii. të ardhurat në shumën 15,000,000 lekë, të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit privat nga bashkëshorti A.H (M), për periudhën 1994 – 2000, në Tropojë, me fushë veprimtarie “tregtim i artikujve ushqimorë dhe industriale me shumicë dhe pakicë”, për vitet 1994 – 1997, pajisur me kod fiskal nr. *** dhe nr. serial ***. Për vitet 1997 – 2001 ka ushtruar aktivitetin e grumbullimit dhe shitjeve të bimëve medicinale;
- iii. të ardhurat në shumën 200,000 lekë, të përfituara nga shitja e dyqanit në qytetin e Bajram Currit me kontratë shitjeje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.1999, shitur pronarit të tokës shtetasit M.U.M;
- iv. të ardhurat e përfituara nga kompensimi i një parcele toke me sipërfaqe 248.5 m², miratuar me VKM-në Nr. 685, datë 16.8.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 22.8.2013. Parcela ka qenë në emër të bashkëshortit A.M. Në vitin 2013 është kompensuar 57% e vlerës, në shumën prej 4,755,648 lekësh, ndërsa, më 20.4.2016, është kompensuar 13% e vlerës, në shumën prej 1,084,621 lekësh.

24.6. Gjithashtu, në deklarin e bërë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se apartamenti 3+1 në qytetin Bajram Curri është përfituar nga privatizimi i apartamenteve në vitin 1993. Këtë shtëpi e kanë marrë me vendim të Këshillit të Qytetit pas kërkesës për zgjerim, pasi deri në vitin 1992 kishin një apartament 1+1 në përdorim¹⁰. Gjithashtu, ka shpjeguar se bashkëshorti A. M ka blerë një apartament me sip. 73 m², në lagjen “****”, pallati ***, kati i parë, me akt pronësie nr. ***, datë 16.9.1996, të cilin e ka përshtatur si dyqan, ku ka ushtruar aktivitetin privat nga muaji prill i vitit 1994 deri në prill të vitit 1997, si person fizik. Në vitin 1997 dyqanin e ka

¹⁰Vendimi i Këshillit të Qytetit Bajram Curri, datë 15.10.1993 dhe gjithë dokumentacioni përkatës bashkëngjitur deklaratës.

përshtatur në një pikë grumbullimi të bimëve medicinale dhe ka ushtruar këtë aktivitet deri në fund të vitit 2000.

Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite

25. Në deklaratën fillestare të pasurisë, të depozituar në datën 23.6.2004 në ILDKPKI, në seksionin “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi me sip. 180 m² dhe truall më sip. 400 m², ndodhur në lagjen ‘***’, K, Tiranë”*. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit A.M për periudhën prill 1994 – korrik 1997 (tregti artikuj industrialë dhe ushqimorë). Ndërsa, lidhur me vlerën e kësaj pasurie, rezulton të jetë deklaruar 30 milionë lekë (apo 3,000,000 lekë), pasi nuk është paraqitur në mënyrë të qartë në formularin e deklaramit¹¹. Subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

25.1. Në deklaratën e interesave private/periodikë vjetore (këtej e në vijim DIPP) të vitit 2004, në seksionin “Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: (i) sip. 400 m² tokë në zonë informale, në rrugën “***”, lagja “***”, K, Tiranë, me vlerë 1,500,000 lekë, pjesa takuese 35%, data dhe viti i krijimit të pasurisë: 10.5.1998; (ii) shtëpi banimi me sip. 180 m², e papërfunduar, pjesa takuese 100%, data dhe viti i krijimit të pasurisë: 5.10.1999.

25.2. Në DIPP/2012, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi 3 kat + papafingo, ndërtuar në vitet 1998 – 2012, e legalizuar me nr. ***, datë 6.8.2012 dhe e regjistruar në ZVRPP. Një kat banimi është i nënës dhe familjes së kunatit. Është regjistruar në pronësinë e bashkëshortit. Vlera: 15,000,000 lekë”*.

25.3. Në DIPP/2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: *“Godinë banimi 4 kate dhe truall me sipërfaqe 461.5 m², e ndërtuar në vitet 1998 – 2012, e legalizuar me nr. ***, datë 6.8.2012 dhe regjistruar në ZVRPP me nr. ***, datë, 20.11.2012, rivlerësuar në datën 23.5.2013. Një kat banimi është i familjes së vëllait të bashkëshortit, por figuron në pronësinë e bashkëshortit. Vlera e rivlerësuar në datën 23.5.2013, në shumën 67,766,719 lekë”*.

Deklarimet e bëra në ILDKPKI për këtë pasuri nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.M¹²

26. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (DIPP/2012), në seksionin “Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme – pasuritë e luajtshme” personi i lidhur ka deklaruar: *“Shtëpi 3 kat plus papafingo ndërtuar në vitet 1998 – 2012, e legalizuar me nr. ***, datë 6.8.2012. Është në proces regjistrimi në ZVRPP. Një kat banimi është i nënës dhe familjes së vëllait, S.M (konkretisht kati i dytë). Sipërfaqe ndërtimi 673 m². Vlera: 15,000,000 lekë. Toka mbi të cilën është ndërtuar shtëpia blerë në vitin 1998, në bashkëpronësi me P.P, ndarë në vitin 2010 dhe regjistruar në ZVRPP në vitin 2011, me certifikatë pronësie nr. ***, volumni ***, faqe ***, datë 7.1.2011. Toka është blerë me vlerën 3,500 lekë/m², nga trashëgimtarët e M.Zh. Vlera: 1,600,000 lekë. Burimi financiar është kontributi i dy bashkëshortëve në vite nga punë të ndryshme, si dhe puna e tij në sektorin privat në vitet 1994 deri në vitin 2006, kjo e dokumentuar dhe deklaruar nga Shefkie Mataj (Demiraj)”*.

26.1. Ndërsa, në seksionin e veçantë të kësaj deklarate, personi i lidhur ka deklaruar se në ZVRPP-në Tiranë figuron e regjistruar në emrin e tij toka me sipërfaqe 736 m². Ai ka në pronësi reale 461 m², ku është ndërtuar shtëpia e tij e legalizuar. Sipërfaqja prej 275 m² është

¹¹Nga verifikimi në tërësi i deklaratës fillestare të pasurisë (përfshirë këtu edhe seksionin e të ardhurave) rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram me lekë të vjetra.

¹²Deklarime të bëra në cilësinë e subjektit deklarues në ILDKPKI, pra jo në cilësinë e personit të lidhur me subjektin deklarues – që mbart detyrimin për deklaram.

e kunatit, I.D. Kunati ka ndërtuar mbi këtë sipërfaqe një shtëpi dhe është në proces legalizimi. I ka dhënë një deklaratë noteriale dhe janë në proces të kalimit të pronësisë për sipërfaqen 275 m². Deri tani ka qenë e pamundur për arsye procedurash. Pra, ai vetë ka 461 m² tokë faktike. Toka është në emrin e tij, sepse në vitin 1998 kunati ka qenë në emigracion dhe nuk vinte dot në Shqipëri. Për sipërfaqen 275 m², kunati ka paguar 1,100,000 lekë të reja. Çmimi: 4,000 lekë/m².

26.2. Në DIPP/2012, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur ka deklaruar: *“Shtëpi banimi 3 kat + papafingo ndërtuar në vitet 1998 – 2012, e legalizuar me nr. ***, datë 6.8.2012 dhe e regjistruar në ZVRPP, nr. ***, datë 20.11.2012. Një kat banimi është i nënës dhe familjes së kunatit. Është regjistruar në pronësinë e tij, pasi dhe toka mbi të cilën është ndërtuar është në pronësinë e tij. Vlera: 15,000,000 lekë. Kjo vlerë është vendosur sipas shpenzimeve të kryera prej tyre dhe nuk është vlerësuar me çmimet e tregut, pasi deri tani ka qenë në proces legalizimi dhe regjistrimi në ZVRPP”.*

26.3. Në DIPP/2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur ka deklaruar: *“Godinë banimi 4 kate dhe truall me sipërfaqe 461.5 m², e ndërtuar në vitet 1998 – 2012, e legalizuar me nr. ***, datë 6.8.2012 dhe regjistruar në ZRPP me nr. ***, datë, 20.11.2012, rivlerësuar në datë 23.5.2013. Një kat banimi është i familjes së vëllait, por figuron në pronësinë e tij. Vlera e rivlerësuar në datën 23.5.2013, në shumën 67,766,719 lekë”.*

26.4. Konkluzionet e ILDKPKI-së për këtë pasuri

- i. Deklarim i rremë lidhur me blerjen e truallit me sip. 1,634 m², nga shtetasi P.P dhe bashkëshorti i subjektit A.H, pasi, sipas kontratës së shitblerjes, datë 6.7.1998, vlera e truallit është 1,900,000 lekë, ndërkohë, sipas kontratës së kaparit, datë 5.5.1998, rezulton se vlera totale e truallit është 5,820,000 lekë, nga të cilat janë dhënë kapar 1,200,000 lekë nga shtetasi P.P.
- ii. Mungesë burimi financiar nga shtetasi A.H për blerjen e pjesës takuese të truallit me sipërfaqe totale 1,634 m².
- iii. Në deklaratat e interesave private ndër vite ka pasaktësi lidhur me deklarin e vlerës dhe sipërfaqes së truallit të mësipërm.
- iv. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor si preventiv, situacion punimesh për objektin banesë me katër kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 672.9 m², të ndodhur në Tiranë, si dhe për mobilimin e kryer.
- v. Deklarim i rremë lidhur me ndërtimin e objektit katër kate, pasi në deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar ndërtimi, për periudhën 1998 – 2012, ndërkohë, që rezulton se në deklaratat e interesave privatë, ndër vite, janë fshehur shpenzimet për ndërtimin e objektit dhe, si rrjedhojë, ka mungesë burimi financiar të ligjshëm.
- vi. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me deklarin e subjektit se një kat banimi (kati i parë) është i familjes së vëllait të bashkëshortit, ku jeton e veja e tij S.H me djalin e vogël E.H, të burimit të krijimit të shumës 5,000,000 lekë, që ka shërbyer për ndërtimin e tij.
- vii. Konstatohet se për shitjen e pasurisë me sip. 73 m², në Tropojë, e blerë në datën 11.1.1995 në shumën 600,000 lekë rezultojnë dy kontrata dhe, konkretisht, kontrata e paraqitur nga subjekti nr. ***, datë 17.12.1997, ku pasuria shitet në shumën 200,000 lekë dhe kontrata e konfirmuar nga ZVRPP-ja Tropojë, nr. ***, datë 27.2.2007, ku pasuria shitet në shumën 600,000 lekë, çka krijon dyshime lidhur me këto veprime juridike.

- viii. Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2013 nuk janë deklaruar shpenzimet në shumën rreth 490,000 lekë, të shlyer në datën 23.5.2013, në ZVRPP-në Tiranë, me qëllim rivlerësimin e pasurive të paluajtshme truall dhe banesë.
- ix. Rezulton se vendimi nr. ***, datë 10.3.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për regjistrimin e personit fizik shtetasin “A.M”, është dhënë nga bashkëshortja e tij, gjyqtarja Shefkie Demiraj.
- x. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat nga ushtrimi i aktiviteteve private të bashkëshortit dhe, konkretisht, për periudhën 1994 – 2000, në Tropojë, tregtim i artikujve ushqimorë dhe industrialë, me shumicë dhe pakicë 1994 – 1997, “grumbullim dhe shitje të bimëve medicinale” në vitet 1997 – 2001, në shumën totale 15,000,000 lekë.
- xi. Rezulton se bashkëshorti i subjektit ka përfituar në mënyrë të paligjshme nga shpronësimi i pasurisë truall me sip. 248.2 m² (rivlerësuar në shumën 8,343,243 lekë) në shumën totale rreth 5,840,000 lekë, pasi: (a) në truallin me sip. 248.2 m² ka ndërtuar vëllai i subjektit I. D; (b) duke qenë se ndërtimi është kryer nga familjarët e subjektit kalimi i pronësisë së truallit duhet të bëhej nëpërmjet rrugëve ligjore, si p.sh., shitje, dhurim etj.; (c) zgjedhja e rrugës nëpërmjet shpronësimit është bërë me qëllimin e vetëm përfitimit si nga ana e subjektit deklarues të shumës (rreth 5,840,000 lekë), ashtu dhe nga ana e shtetasit I. D, i cili këtë truall e ka blerë në shumën 115,000 lekë, sipas kontratës për kalim pronësie të datës 22.7.2013, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit; (d) në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2012, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se toka është në emrin e tij, sepse në vitin 1998 kunati ka qenë në emigracion. Për sipërfaqen 275 m², kunati ka paguar shumën 1,100,000 lekë.
- xii. Ndërtimi i paligjshëm i pasurisë së mësipërme rëndon figurën e subjektit të rivlerësimit me pozicion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

27. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Jug¹³, konfirmohet se në emër të personit të lidhur, z. A.M, figuron e regjistruar pasuria e llojit “truall”, me sipërfaqe 461.3 m² dhe ndërtesë banimi 4 kate me sipërfaqe ndërtimore prej 145.7 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtimit për banim prej 672.9 m².

27.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë, pjesë e dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja¹⁴, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*¹⁵ dhe bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit¹⁶ për këto pasuri, rezulton se:

- i. Në datën 5.5.1998, shtetasi P.P, ka lidhur kontratë kapari¹⁷ për pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 1,666 m², Tiranë, për vlerën 5,820,000 lekë, duke paguar kaparin në vlerën 1,200,000 lekë.

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2020.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2017, e ZVRPP-së Tiranë.

¹⁵Ndodhet në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶Informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2020, të ASHK-së; shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug; shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2022, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug; shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2022, të ILDKPKI-së; shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2022, të ILDKPKI-së; dhe shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2022, të ASHK-së.

¹⁷Kontratë kapari me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.1998, redaktuar nga noteri publik T.M.

- ii. Në datën 6.7.1998, shtetasi A. M¹⁸ dhe P.P kanë blerë¹⁹ pasurinë e llojit “truall”, me sipërfaqe 1,634 m², të ndodhur pranë rrugës “****” (K e Sh.P), për vlerën 1,900,000 lekë, të njëjtën pasuri për të cilën më parë ishte nënshkruar kontrata e kaparit nga shtetasi P.P (referuar si më sipër).
- iii. Në datën 12.11.2006, personi i lidhur A.M ka vetëdeklaruar ndërtimin e objektit informal, sipas formularit nr. *** prot., “vetëdeklarim për legalizimin e objektit”, depozituar në Njësinë e Urbanistikës të Njësisë së Qeverisjes Vendore Nr. ***, Tiranë. Në këtë formular janë pasqyruar, ndër të tjera, të dhënat si vijon: (i) viti i ndërtimit: 10.12.1998; (ii) sipërfaqja e zënë: 445 m²; (iii) sipërfaqja e ndërtimit: 145 m²; (iv) numri i kateve mbi tokë: 4 (katër).
- iv. Në datën 17.12.2010, me anë të kontratës së pjesëtimit vullnetar²⁰, bashkëpronarët P.P dhe A.M kanë vendosur me mirëkuptim të ndajnë pasurinë prej 1,634 m² sipërfaqe “truall”, nga ku personi i lidhur pas pjesëtimit bëhet pronar i vetëm i sipërfaqes prej 709.5 m² truall.
- v. Në datën 6.8.2012 është lëshuar leja e legalizimit²¹ në emër të z. A.M, për objektin godinë banimi 4 kate, me sipërfaqe truall 461.3 m², sipërfaqe ndërtimi 145.7 m², sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 672.9 m².
- vi. Në datën 21.11.2012, pasuria e llojit godinë banimi 4 kate, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, referuar si më sipër, është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë²² në emër të z. A. M me nr. pasurie ***, me sipërfaqe truall 461.3 m², sipërfaqe ndërtimi 145.7 m² dhe sipërfaqe totale e ndërtimit për banim prej 672.9 m².
- vii. Po në datën 21.11.2012, pasuria truall, mbetur me sipërfaqe prej 248,2 m² (709,5 m² – 461,3 m²) është regjistruar si pasuri më vete në ZVRPP-në Tiranë²³, në emër të personit të lidhur A.M, me nr. pasurie ***.
- viii. Në datën 23.5.2013, pasuria “truall” me sipërfaqe prej 248.2 m² është rivlerësuar në vlerën 8,343,243 lekë. Rezulton se po në datën 23.5.2013 është rivlerësuar edhe pasuria e llojit “godinë” 4 kate, me sipërfaqe totale ndërtimore prej 672.9 m², bashkë me truallin me sipërfaqe 461.3 m² (pasuria objekt vlerësimi), në vlerën prej 67,766,719 lekësh.
- ix. Në datën 22.7.2013, shtetasi I.D (vëllai i subjektit të rivlerësimit) ka blerë²⁴ nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana ***, pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe prej 275 m², për vlerën 115,000 lekë, ku përfshihet edhe truall i prej 248.2 m², për të cilin ishin kryer procedurat e shpronësimit në favor të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, z. A.M. Bazuar në kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të datës 22.7.2013, pasuria e llojit “truall” me sipërfaqe prej 248.2 m² është regjistruar në emër të shtetasi I.D.

¹⁸I përfaqësuar nga shtetasi F.Gj me prokurën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.7.1998.

¹⁹Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.1998, redaktuar nga noteri publik T.M.

²⁰Kontrata e pjesëtimit vullnetar me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2010, redaktuar nga noteri publik H.S.

²¹Leje legalizimi nr. ***, datë 6.8.2012.

²²Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 21.11.2012, për pasurinë nr. ***.

²³Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 21.11.2012, për pasurinë nr. ***.

²⁴Kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.7.2013, redaktuar nga noteri publik A.B.

- x. Në datën 16.8.2013, me Vendim të Këshillit të Ministrave²⁵ është caktuar shpërblimi i personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, z. A.M, mbi sipërfaqen e pjesës takuese të shpronësuar, pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 248.2 m², duke u përcaktuar si vlerë shpronësimi shuma prej 8,343,243 lekësh.
- xi. Në datën 20.9.2013, nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kreditohet në llogarinë bankare të personit të lidhur në “Credins Bank”, shuma prej 4,755,648 lekësh, si 57% pjesë e vlerës së truallit të shpronësuar nga ALUIZNI.
- xii. Në datën 20.4.2016, nga Agjencia e Trajtimit të Pronave kreditohet në llogarinë bankare të personit të lidhur në “Credins Bank”, shuma prej 1,084,621 lekësh, si 13% pjesë e vlerës së truallit të shpronësuar nga ALUIZNI.

27.2. Të pyetur më parë nga ILDKPKI-ja²⁶ (datë 20.2.2015) në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se shtëpia private 3 kate + papafingo e ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, përbëhet nga kati përdhe, sallë fitnesi familjare, kati i parë banim që i përket familjes së të ndjerit S.M.H (vëllai i A.M), kati i dytë ku banojnë ata me familjen dhe papafingo e pabanuar. Trualli është me sipërfaqe 461.3 m², ndërtim kati përdhe 145.7 m², kati i parë 193.2 m², kati i dytë 193.2 m² dhe papafingo 140.8 m². Sipërfaqe ndërtese, totali 672.9 m², nga këto 193.2 m² është e familjes së vëllait të A.M, siç është deklaruar. Vlera totale është 15,000,000 lekë (kati përdhe, kati i dytë dhe papafingo).

27.3. Ndërsa, si burim krijimi të kësaj pasurie kanë deklaruar kontributet e tyre, ndër vite, ku përfshihen edhe të ardhurat nga: (i) shitja e dyqanit në qytetin e Bajram Currit (regjistruar më parë në emër të A.M); (ii) fitimet prej biznesit në qytetin e Bajram Currit, minimarket “***”, nga vitet 1994 – 1997 (regjistruar në emër të z. A.M); (iii) puna e z. A.M me bimë mjekësore në vitet 1997 – 2000; si dhe (iv) menaxhim punimesh në sektorin e ndërtimit, për periudhën 2000 – 2006, nga A.M.

27.4. Në vijim kanë deklaruar se shpenzimet për ndërtimin e katit, ku jeton familja e vëllait të A.M, janë mbuluar nga: (i) shitja e kamionit; (ii) shitja e shtëpisë 2+1, në Bajram Curri; si dhe (iii) nga kontributet e fëmijëve që ndodhen në Kanada (vajza V) dhe në Itali (djali I).

27.5. Lidhur me truallin ku është bërë ndërtimi kanë deklaruar se është blerë në vitin 1998 dhe ndërtimi i shtëpisë ka zgjatur nga 1998 deri në vitin 2006, kur ka mbaruar karabina (soleta, trarë, kolona dhe mure) dhe deri në vitin 2011 si rifiniturë (punimet brenda, elektriket, hidrauliket, pllaka, dyer, dritare dhe suvatime). Disa punime janë kryer edhe në vitin 2014 dhe do të vazhdojnë edhe në vitet në vazhdim. Në tokën ku është ndërtuar shtëpia, janë dy bashkëpronarë (A.H dhe P.P) regjistruar në ZVRPP, nga ku A.M ka paguar shumën 1,600,000 lekë, sa ka deklaruar. Më pas, është bërë ndarja e tokës me mirëkuptim dhe regjistrimi në ZVRPP.

27.6. Pasi Komisioni i kërkoi të deklarojë²⁷, mbi periudhën e fillimit dhe përfundimit të punimeve, të paraqesë në mënyrë kronologjike investimet e kryera/shpenzimet e realizuara në funksion të ndërtimit dhe kompletimit të godinës së banimit 3 kate + papafingo dhe burimin konkret të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për çdo shpenzim të kryer, si dhe mbi rrethana të tjera që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

i) Ndërtimi i banesës ka filluar ndërkohë që ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe të gjitha punimet e kryera për ndërtimin e saj janë menaxhuar

²⁵VKM Nr. ***, datë 16.8.2013.

²⁶Referohuni dokumentit “Sqarime në lidhje me deklarimin e pasurisë ndër vite sipas kërkesës së inspektores”, datë 20.2.2015, përcjellë nga IKDKPKI-ja në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2022.

²⁷Pyetëtori nr. ***, i dërguar nga Komisioni.

nga bashkëshorti, A.M dhe, për këtë arsye, i është dashur të konsultohet me të, për të sqaruar pyetjet e Komisionit. Për shkak të periudhës shumë të gjatë që ka kaluar që nga fillimi i ndërtimit të shtëpisë, si dhe për shkak të shtrirjes në shumë vite të ndërtimit të banesës (rreth 14 vjet), kërkon të merret në konsideratë edhe ndonjë pasaktësi e mundshme nga ana saj.

ii) Banesa ka filluar të ndërtohet në muajin gusht 1998. Në periudhën gusht – shtator 1998 ka përfunduar rrethimi i jashtëm i pronës me mure me blloqe dhe kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm. Në fund të muajit shtator 1998 kanë filluar punimet për ndërtimin e shtëpisë. Themelet, kolonat dhe soletat kanë përfunduar brenda muajit mars 1999. Në këtë kohë janë bërë edhe punimet e drenazhimit të shtëpisë. Në periudhën prill – dhjetor 1999 kanë bërë një dhomë, kuzhinë dhe tualet në katin e parë të banimit në të cilin kanë hyrë vëllai i bashkëshortit S.H dhe familja e tij. Gjithashtu, një dhomë, kuzhinë dhe tualet në katin e dytë të banimit në të cilin familja e saj, bashkëshorti dhe 2 djemtë, kanë hyrë në janar të vitit 2000 (ndërkohë që ajo vetë punonte dhe banonte në Bajram Curri). Gjatë vitit 2000 janë përfunduar muret me tulla të dy kateve banim dhe katit të parë përdhe, i cili u konceptua të përdorej si magazinë për ushtrimin e aktivitetit “grumbullim i bimëve mjekësore”, nga ana e bashkëshortit. Gjatë viteve 2001 deri në fund të vitit 2003 është punuar në katin e parë dhe të dytë banim, papafingo dhe në çati, pra është bërë ndërtimi në fazën karabina. Gjithashtu, është punuar me izolimin termik të shtëpisë, si dhe punime ndihmëse për shtrirjet e linjave elektrike dhe hidraulike, si dhe suvatimet e brendshme të ambiente tek të cilat banonin përkatësisht të dyja familjet. Janë porositur dyer druri, janë blerë pajisjet hidrosanitare, pajisjet elektrike, pllakat dhe parketi. Në vitet 2001 deri rreth 2005, kanë pasur ritme të ulta ndërtimi, të kushtëzuar nga mundësia financiare. Deri në fund të vitit 2003, ishte kryer pjesa më e rëndësishme e investimit dhe të dyja familjet kishin arritur të strehoheshin në atë shtëpi, pavarësisht se kushtet ishin jo të mjaftueshme. Ndërsa nga viti 2004 deri në fund të vitit 2012, kur banesa ka përfunduar, kanë investuar pjesë-pjesë, vit pas viti, sipas mundësive financiare.

iii) Për ndërtimin e banesës ka punuar vetë bashkëshorti i saj dhe gjithë familja e vëllait të tij kryesisht për punët që mund të kryenin (roje objekti, vinçier, drejtues betoniere, transportin me vinç të tullave, llaçit dhe sitjen e rërës), si dhe elektriket, çatinë (saldimet e kapriatës metalike, si dhe vendosjen e tjegullave dhe shkarkimet e ujërave të shiut të çatisë dhe të ballkoneve). Sqaron se të gjithë (bashkëshorti i saj dhe kunati me bashkëshorten e tij) në atë kohë ishin të papunë. Ndarja e ndërtimit në periudha, duke llogaritur vlerën e investimit është shumë e vështirë, pasi ndërtimi nuk është bërë me firmë ndërtuese, nuk ka patur një preventiv punimesh dhe as një inxhinier zbatues, i cili do të mbikëqyrte punimet. Çdo gjë është drejtuar nga bashkëshorti i saj, i cili ka ideuar projektin, ka ndjekur të gjitha punimet, ka kryer punimet elektrike në veçanti për të gjithë shtëpinë, pasi kishte njohuritë e nevojshme.

iv) Vlera në total e investuar nga familja e saj ndër vite është 15,000,000 lekë, ndërsa nga familja e kunatit është 5,000,000 lekë. Kontributi i kunatit i është dhënë bashkëshortit të saj dhe ai i ka shpenzuar në të njëjtin vit sapo i ka marrë.

v) Në lidhje me shumën e investuar çdo vit, megjithëse ka qenë e vështirë që bashkëshorti të mbante mend me saktësi këto vlera, nga bisedat që ka bërë edhe ai vetë me familjen e vëllait të tij, e ka informuar si më poshtë:

- në vitin 1998 është blerë trualli në vlerën 1,600,000 lekë;
- nga gushti deri në dhjetor 1998 është investuar dhe ndërtuar rreth 1,000,000 lekë;
- në vitin 1999 dhe 2000 është investuar dhe ndërtuar nga 1,500,000 lekë për secilin vit;
- në vitin 2001 është investuar dhe ndërtuar rreth 1,000,000 lekë;
- në vitin 2002 dhe 2003 është investuar dhe ndërtuar nga 500,000 lekë për secilin vit”.

Pra, deri në dhjetor të vitit 2003 vlera e shtëpisë së ndërtuar ka qenë 6,000,000 lekë, nga të cilat 3 milionë lekë (ose 30 milionë lekë të vjetra sikurse e ka deklaruar në deklaratën e vitit

2003) ka qenë vlera e pjesës së saj takuese prej 50% dhe 3 milionë lekë vlera e pjesës takuese të bashkëshortit, prej 50%”.

vi) Ndërkohë që, siç i ka shpjeguar bashkëshorti, nga momenti që katit përdhe iu dha forma e magazinës, pra, nga viti 2000 deri në fund të vitit 2002, u porositën, u blenë dhe u paguan materiale ndërtimi si pllaka, parket, pajisje elektrike dhe një pjesë e pajisjeve hidraulike, të cilat në total kapnin vlerën prej 2,500,000 lekë. Gjithashtu, në vitin 2003 u blenë materiale në vlerën 500,000 lekë. Këto materiale janë blerë kur gjendej ndonjë okazion dhe çmim i lirë, pasi ishte mundësia që ato të mbaheshin në magazinë (në katin përdhes). Materialet në ruajtje në magazinë, janë trupëzuar në banesë nga viti 2004 e në vijim, gradualisht, nga bashkëshorti”. Vlera e banesës së ndërtuar ishte 6 milion lekë dhe vlera e materialeve të porositura dhe të blera, të cilat do të përdroreshin për ndërtim, ishte 3 milionë lekë, duke bërë kështu që deri në fund të vitit 2003, vlera e shpenzuar për shtëpinë të ishte 9,000,000 lekë.

27.7. Si burim të këtyre investimeve (deri në fund të vitit 2003), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat: (i) nga fitimi i bashkëshortit A.M, prej ushtrimit të aktivitetit tregtar si person fizik në Bajram Curri, për vitet 1994 – 1997; (ii) kontribute të kunatit në shumën prej 600,000 lekësh nga shitja e kamionit; (iii) shuma prej 200,000 lekësh, nga shitja e dyqanit në Bajram Curri në vitin 1999; (iv) shuma prej 800,000 lekësh nga shitja e shtëpisë në Bajram Curri në vitin 2001; si dhe (v) pagat e saj nga ushtrimi i funksionit si gjyqtare.

27.8. Në vijim, subjekti ka deklaruar investimet/shpenzimet e kryera për pasurinë objekt vlerësimi, për vitet 2004 – 2012, si vijon:

- i. për vitin 2004, vlera e shpenzuar ka qenë 500,000 lekë, me burim të ardhurat familjare dhe, gjithashtu, është investuar edhe shuma prej 5,000 dollarë kanadezë dhënë nga vëllai i bashkëshortit;
- ii. për vitin 2005, vlera e shpenzuar ka qenë 300,000 lekë, me burim të ardhurat e familjes dhe, gjithashtu, është investuar edhe shuma prej 5,000 dollarë kanadezë dhënë nga vëllai i bashkëshortit;
- iii. për vitin 2006, vlera e shpenzuar ka qenë 5,000 dollarë kanadezë dhënë nga vëllai i bashkëshortit;
- iv. për vitin 2007, vlera e shpenzuar ka qenë 600,000 lekë, me burim shumën 200,000 lekë e kursyer në gjendje *cash* nga të ardhurat familjare të vitit 2006 dhe diferenca 400,000 lekë nga të ardhurat familjare të vitit 2007;
- v. për vitin 2008, vlera e shpenzuar ka qenë 5,000 dollarë kanadezë, e cila është kontribut nga familja e vëllait të bashkëshortit;
- vi. për vitin 2009, vlera e shpenzuar ka qenë rreth 2,000,000 lekë, investuar nga familja e subjektit, që përbëhet nga shuma prej 1,600,000 lekë, e cila ishte kursyer në gjendje *cash* gjatë vitit 2008, nga të ardhurat familjare (pagat e saj dhe të bashkëshortit) dhe diferenca 400,000 lekë nga pagat familjare të vitit 2009, gjithashtu është investuar shuma 5,000 dollarë kanadezë, dhënë nga familja e vëllait të bashkëshortit, bashkëshortit A.M, i cili menaxhonte punimet;
- vii. për vitin 2010, vlera e shpenzuar ka qenë 700,000 lekë, kontribut i familjes dhe se, konkretisht, kjo shumë është një pjesë e shumës *cash* të kursyer gjatë vitit 2009 (*cash* 1,100,000 lekë kursyer nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit). Gjithashtu, është investuar edhe shuma 5,000 dollarë kanadezë dhënë nga familja e vëllait të bashkëshortit;
- viii. për vitin 2011, vlera e shpenzuar ka qenë 1,400,000 lekë, kontribut i familjes, me burim gjendjen *cash* prej 1,300,000 lekësh, e kursyer gjatë vitit 2010, nga të ardhurat e pagës së subjektit dhe të bashkëshortit dhe shuma 100,000 lekë prej të ardhurave nga pagat e vitit 2011. Gjithashtu, është investuar edhe shuma 5,000 dollarë kanadezë dhënë nga familja e vëllait të bashkëshortit;

ix. për vitin 2012, vlera e shpenzuar ka qenë 500,000 lekë, kontribut i familjes, me burim një pjesë të shumës *cash* të deklaruar gjatë vitit 2011 (*cash* 1,600,000 lekë, i kursyer nga pagat e saj dhe të bashkëshortit). Gjithashtu, janë investuar nga familja e vëllait të bashkëshortit edhe shumat 10,000 dollarë kanadezë dhe 500,000 lekë nga shitja e apartamentit në Bajram Curri.

27.9. Subjekti ka sqaruar se *siç duket edhe nga përshkrimet e mësipërme të investimeve të kryera sipas viteve në banesë, gjatë periudhës 2009 – 2012 janë kryer punime të kushtueshme, siç janë: dyer, dritare dhe vetratat, pasi janë bërë me material plastik, është bërë kafazi i shkallëve (granite dhe rrethimi i shkallëve me dru të punuar), është përfunduar papafingo me tavane të varura, etj., janë kryer punimet/rifiniturat nga jashtë (suvatime, sistemimi i oborrit, shtrimi rrugës hyrëse etj.). Në këto vite është investuar me intensitet të lartë, pasi u rrit mundësia financiare e familjes së subjektit dhe e familjes së vëllait të bashkëshortit.*

27.10. Për të provuar banimin e të ndjerit S.H dhe familjes së tij në katin e parë të banimit të kësaj pasurie (godinës së banimit 3 kate + papafingo), subjekti ka depozituar dokumentet, si vijon: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 22.4.2022, të Njësisë Administrative Nr. ***, Tiranë; (ii) aktin nr. *** prot., datë 21.4.2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë; (iii) librezat e telefonisë fikse (katër copë) që fillojnë nga viti 2001 e në vijim, në emër të shtetasit S dhe S.H, si dhe pagesat e kryera në vite; (iv) librezat e energjisë elektrike (tri copë) në emër të shtetasit S.H dhe pagesat në vite.

27.11. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se matësi i energjisë elektrike që i përket kontratës së lidhur nga i ndjeri S.H me operatorin përkatës, ndodhet në katin përdhes të banesës dhe se, gjithashtu, emri i tij figuron i shkruar edhe sot në citofonin e portës kryesore të banesës nr. ***. Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar si provë edhe dekoratën noteriale²⁸ të shtetasit S.H (bashkëshortja e të ndjerit S.H, vëllai i bashkëshortit të subjektit).

Analiza/verifikimet e kryer/a nga Komisioni për pjesën takuese dhe vlerën e deklaruar të pasurisë objekt vlerësimi, shtëpisë së banimit 3 kate + papafingo, ndodhur në Tiranë

28. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se vlera totale e pasurisë objekt vlerësimi është 20,000,000 lekë, duke referuar se banesa është ndërtuar përgjatë viteve 1998 – 2012. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se në DIPP/2004 subjekti ka deklaruar se kjo shtëpi banimi ka qenë e papërfunduar. Ndërsa, në DIPP/2012 subjekti ka deklaruar legalizimin e kësaj banese dhe se ajo është ndërtuar përgjatë viteve 1998 – 2012 (të njëjtin deklaram ka bërë edhe personi i lidhur në cilësinë e subjektit deklarues në ILDKPKI).

28.1. Trupi gjykues çmon të theksojë se në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe DIPP/2012, personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit kanë deklaruar shumën prej 15,000,000 lekë si vlerë takuese që lidhet me pasurinë objekt vlerësimi, duke referuar se një kat banimi është i nënës dhe familjes së vëllait të bashkëshortit (konkretisht kati i dytë). Gjithashtu, në datën 20.2.2015, në ILDKPKI kanë deklaruar vlerën e pasurisë në shumën prej 15,000,000 lekësh, duke specifikuar se ata zotërojnë katin përdhe, katin e dytë dhe papafingon.

28.2. Bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave për vitet 1998 – 2012²⁹ rezulton se kosto mesatare e ndërtimit për këto vite për objekte në qytetin e Tiranës është në

²⁸Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2022, redaktuar nga noteri publik N. K.

²⁹Vendim nr. ***, datë 28.4.1999 dhe vendimi nr. ***, datë 14.7.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K”; udhëzim nr. ***, datë 31.5.2001; udhëzim nr. ***, datë 8.5.2003; udhëzim nr.***, datë 4.3.2004, udhëzim nr. ***, datë 23.11.2005; udhëzim nr. ***, datë 7.9.2006, udhëzim nr. ***, datë 4.4.2007, udhëzim nr. ***, datë 20.8.2008; udhëzim nr. ***, datë 3.2.2010, udhëzim nr. ***, datë 23.11.2011, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”.

vlerën 25,410 lekë/m². Nëse marrim për bazë këtë kosto mesatare ndërtimi – duket se vlera e ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi paraqitet në shumën prej 17,098,389 lekësh, pra, më e vogël se vlera e deklaruar nga subjekti (sipërfaqe totale të ndërtimit për banim prej 672.9 m² * kosto mesatare e ndërtimit 25,410 lekë = 17,098,389 lekë).

28.3. Referuar deklaramëve të bëra nga subjekti rezulton se deri në fund të vitit 2003, ky objekt ishte përfunduar plotësisht në fazën karabina, ndërsa në katin e parë dhe të dytë ishin bërë nga një dhomë, kuzhinë e tualet. Nga ana tjetër, referuar deklaramit për herë të parë, por edhe deklaramëve të bëra në përgjigje të pyetësorit nr. ***, rezulton se subjekti ka deklaruar vlerën 3,000,000 lekë, si pjesë takuese të saj mbi këtë pasuri deri në fund të vitit 2003, pra, në total investimi në ndërtimin e kësaj pasurie, deri në fund të vitit 2003, ka qenë në shumën 6,000,000 lekë. Krahas investimit të kryer në ndërtimin e këtij objekti, subjekti ka deklaruar se deri në fund të vitit 2003 janë shpenzuar edhe 3,000,000 lekë të tjera që lidhen me blerjen e materialeve në funksion të kompletimit të këtij objekti, të cilat ishin magazinuar në brendësi të tij.

28.4. Me qëllim verifikimin e një vlere të përafërt të kësaj ndërtese në gjendjen karabina, Komisioni iu referua marrëveshjes së datës 17.5.2006, “Për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”³⁰, nga ku konstatohet se në tabelën nr. 3 të saj përcaktohet volumni që zënë zërat e punimeve, si vijon: (i) gjërmimet me makineri zënë 0.3 % të volumnit të punimeve; (ii) struktura betonarme zë 36.4 % të volumnit të punimeve; dhe (iii) vendosje hekur betoni zë 7.7 % të volumnit të punimeve. Në total, këto punime zënë 44.4 % të volumnit të punimeve dhe të vlerës së ndërtimit të objektit, të cilat Komisioni vlerëson paraprakisht se janë minimalisht punimet e kryera deri në fund të vitit 2003 për godinën 3-katëshe + papafingo në gjendje karabina.

28.5. Ndërsa, referuar vendimeve dhe udhëzimeve të Këshillit të Ministrave, kosto mesatare e ndërtimit, për vitet 1998 – 2003, paraqitet në vlerën 23,042 lekë/m². Pra, për sipërfaqen e ndërtuar prej 672.9 m², investimi i kryer deri në fazën karabina vlerësohet në shumën 6,822,183 lekë (sipërfaqe totale të ndërtimit për banim prej 672.9 m² * kosto mesatare e ndërtimit 23,042 lekë * 0,44 volumni i punimeve = 6,822,183 lekë).

28.6. Nga ana tjetër, në këndvështrim të faktit se ky objekt është ndërtuar në mënyrë informale, pra, jo nga subjekte të licencuar dhe të regjistruar në organin tatimor, nëse i zbritet vlera e mësipërme shumatores së vlerave që përfaqësojnë T.V.SH. + fitim + fond rezervë, vlera këto të përfshira në përlllogaritjen e koston mesatare të ndërtimit (pra, minimalisht rreth 25% të saj³¹), vlera e këtij objekti karabina shkon 5,116,637 lekë (75 % e vlerës prej 6,822,183 lekësh).

28.7. Për sa më sipër, Komisioni në analizën financiare ka reflektuar si vlerë të investimit në këtë pasuri, ndër vite, vlerën e vetëdeklaruar nga subjekti. Pra, deri në fund të vitit 2003 është reflektuar në analizë investimi i kryer në ndërtimin e këtij objekti në vlerën prej 6,000,000 lekësh dhe shuma prej 3,000,000 lekësh e shpenzuar për blerje materialesh ndërtimi. Ndërsa, për vitet 2004 – 2012, janë reflektuar në analizë për çdo vit më vete shumat e vetëdeklaruar nga subjekti si të shpenzuara për investime të kryera në pasurinë objekt vlerësimi.

28.8. Komisioni shqyrtoi dhe analizoi në nivel ligjor konstatimin për fshehje pasurie të bërë në raportin e dërguar nga ILDKPKI-ja, i cili rezulton të lidhet me mosdeklarimin prej subjektit të vlerave të shpenzimeve/investimeve të kryera gjatë viteve për kompletimin e ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi.

³⁰Lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë.

³¹TVSH (20%) + fond rezervë (5%).

28.8.1. Trupi gjykues vëren se koncepti i shpenzimeve të deklarueshme është parashikuar për herë të parë në ligjin nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

28.8.2. Në këtë kuptim, referuar ndryshimeve ligjore të bëra në vitin 2012, “shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe shpenzime të tjera të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues. Nga ana tjetër, nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore është parashikuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo shpenzim (shpenzim të deklarueshëm), me vlerë mbi 500,000 lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

28.8.3. Vlen të theksohet fakti se në kushtet kur kemi të bëjmë me një ndërtim informal, pasi u pyet nga Komisioni, subjekti ka deklaruar shpenzimet e kryera përgjatë viteve mbi këtë pasuri, nga ku rezulton se për vitin 2012 ka deklaruar se kanë shpenzuar shumën prej 500,000 lekësh, pra, jo mbi 500,000 lekë. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ të kryer, nuk u pasqyrua ndonjë provë mbi shpenzime të kryera nga subjekti gjatë këtyre viteve për ndërtimin e pasurisë objekt vlerësimi. Në këtë kuptim, sikurse u theksua edhe më sipër, Komisioni kreu analizën mbi shumën e vetëdeklaruarë si të shpenzuara/të investuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitet 2004 – 2012, përderisa nuk ngrihen dyshime mbi deklarimin e vlerës totale të pasurisë.

28.8.4. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se nuk qëndron konstatimi i bërë nga ILDKPKI-ja, për sa kohë subjekti nuk ka qenë i detyruar të deklaronte shpenzimet/vlerat e investimeve të kryera gjatë viteve 2004 – 2011 mbi këtë pasuri dhe se për vitin 2012, sipas deklarimeve të bëra gjatë hetimit administrativ, ka kryer shpenzime me vlerë 500,000 lekë, pra, në limitin e shpenzimeve të deklarueshme.

28.9. Në vijim, Komisioni kreu verifikime lidhur me vërtetësinë e deklarimeve të bëra dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit mbi banimin e familjarëve të vëllait të ndjerë të bashkëshortit të saj në godinën objekt vlerësimi dhe në këtë kuadër dhe vërtetësinë e deklarimeve mbi kontributin e dhënë prej familjes së tij në ndërtimin e këtij objekti.

28.9.1. Nga verifikimi i provave shkresore të dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, rezulton se:

- i. Referuar vërtetimit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse në Njesisë Administrative Nr. ***, Tiranë³², të datës 22.4.2002, ndërlidhësi me komunitetin, z. K.Sh, nga bashkëbisedimi me qytetarët dhe fqinjët konstaton se znj. S.H së bashku me djalin z. E.H, jetojnë në banesën e z. A.M, në Njesisë Administrative Nr. ***, Tiranë, rruga “****”, ndërtesa ***, hyrja ***.
- ii. Referuar shkresës së datës 21.4.2022, të Zyrës së Gjendjes Civile në Njesisë Administrative Nr. ***, Tiranë³³, nga verifikimet e kryera në regjistrin themeltar të shtetasve dhe regjistrin kombëtar të gjendjes civile (RKGjC) të vitit 2010, rezulton se: z. E.H është vendosur familjarisht pranë Zyrës së Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë, më 22.11.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë. Në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë është vendosur më 20.11.1999 nga Zyra e Gjendjes Civile Bajram Curri.
- iii. Gjithashtu, subjekti ka depozituar kopje të njësuara me origjinalin të dokumenteve: (a) librezë me operatorin “A”, për numrin telefonik ***, në emër të shtetasve S.M dhe S.H,

³²Vërtetim nr. *** prot., datë 22.4.2022.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 21.4.2022.

të cilat duket se referojnë pagesa të kryera prej prillit të vitit 2001 e në vijim; dhe (b) librezë energjie elektrike me operatorin KESH, në të cilën referohen të dhënat: filiali elektrik ***, lëshuar për z. S.H, rruga “****”, si dhe mbi pagesa të kryera për vitet 2007 – 2014; (c) librezë energjie elektrike me operatorin OSHEE, në të cilën referohen të dhënat: qendra ***, nr. kontratës ***, lëshuar për z. S.H, rruga “****”, si dhe mbi pagesa të kryera përgjatë vitit 2015 - 2018; dhe (ç) librezë energjie elektrike me operatorin OSHEE, në të cilën referohen të dhënat: Qendra Tirana ***, nr. i kontratës ***, lëshuar z. S.H, rruga “****”,Tiranë, si dhe mbi pagesa të kryera në vitet 2019 – 2022.

28.9.2. Shoqëria “A”³⁴, konfirmon si numër telefonik fiks të regjistruar në emër të shtetasës S.H të njëjtin numër telefonik të shënuar në librezat e telefonisë fikse të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në emër të S.H, të cilat datojnë që prej vitit 2001. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar dhe, konkretisht, kontratës së pajtimit të datës 5.6.2010, lidhur mes shoqërisë “A” dhe shtetasës S.H, rezulton se adresa e deklaruar nga shtetasja S.H është rruga “****”, pallati/godina private. Gjithashtu, konstatohet se pjesë e dokumentacionit shoqërues për lidhjen e kontratës së pajtimit me shoqërisë “A” është edhe kopje e certifikatës së vdekjes e shtetasit S.H, lëshuar në datën 31.5.2010.

28.9.3. Nëpërmjet dokumentit noterial të datës 5.5.2022³⁵, shtetasja S.H, ndër të tjera, ka deklaruar se familja e saj ka ardhur në Tiranë në vitin 1999, duke jetuar fillimisht te motra e bashkëshortit, K.M, në zonën e “****” dhe në vijim ka deklaruar kontributin e dhënë nga familja e saj, me punë konkrete dhe me investimin e vlerave monetare, në ndërtimin e godinës në truallin e blerë nga vëllai i bashkëshortit A.M, burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e vlerave të investuara, si dhe faktin e banimit të familjes së saj që prej vitit 2000 në këtë godinë.

28.9.4. Gjithashtu, në funksion të hetimit të kryer, Komisioni administroi deklaratën noteriale³⁶ të datës 9.1.2015, në referim të së cilës, ndër të tjera, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. M, ka deklaruar se *është pronar i pasurisë me nr. ***, të ndodhur në zonë kadastrale ***, godinë banimi 4-katëshe, në rrugën “****”, Tiranë. Këtë pasuri e ka fituar nga procesi i legalizimit, pasuri e ndërtuar në vitin 2010. Qysh prej vitit 2010, katin e parë të banimit ia ka lënë në përdorim pa shpërblim familjes së vëllait të tij të ndjerë, S.H. Qysh nga viti 2010 dhe aktualisht familja e vëllait të ndjerë vazhdon të jetojë në të njëjtën banesë. Deklaron se janë në procedurat ligjore për të bërë të mundur kalimin e pronësisë së katit të parë nga emri i tij në emrin e kumatës së tij.*

28.9.5. Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime mbi mospërputhjen e konstatuar në deklaratimet e bëra nga personi i lidhur, sa i përket kohës së ndërtimit të pasurisë dhe, si rrjedhim, edhe kohës gjatë së cilës ajo është përdorur nga vëllai i tij i ndjerë dhe familjarët e tij, si dhe për arsyet e përpilimit të kësaj deklarate, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se bashkëshorti i saj e ka lëshuar deklaratën noteriale të datës 9.1.2015, sipas kërkesës së kumatës së tij (bashkëshortes së vëllait), pasi i duhej për në Ambasadën Kanadeze, por duke sqaruar se në këtë deklaratë ka një pasaktësi, si rezultat i një gabimi të noteres, ku në vend që të shkruante vitin 2001, ka shkruar vitin 2010 dhe se me këtë gabim janë njohur vetëm pasi e ka konstatuar Komisioni. Gjithashtu, subjekti ka theksuar faktin se në përgjigje të pyetësorëve të mëparshëm ka sqaruar me detaje në lidhje me kontributin e dhënë nga familjarët e bashkëshortit për katin e tyre të banimit.

³⁴Shkresa nr. *** prot., datë 27.5.2022, e A, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.8.2022.

³⁵Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2022, redaktuar nga noteri publik N.K.

³⁶Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.1.2015, redaktuar nga noteri publik H.Sh (V), dërguar me shkresën e datës 4.2.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.2.2022.

28.9.6. Si konkluzion, Komisioni vlerëson se janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti, mbi mospërputhjen e konstatuar dhe arsyet e lëshimit të kësaj deklarate, kjo në këndvështrim të faktit se rezulton e provuar se godina e banimit është ngritur përpara vitit 2010 dhe, gjithashtu, nisur nga të dhënat e tjera të përfuara gjatë hetimit administrativ, rezulton se e bija e S.H, znj. V.K, figuron si rezidente në shtetin kanadez. Parë në këtë optikë edhe kjo deklaratë noteriale e nënshkruar nga personi i lidhur është në të njëjtën linjë me deklaratimet e bëra se vëllai i tij i ndjerë dhe familjarët e tij kanë banuar në këtë godinë banimi që nga momenti i ndërtimit të saj. Për më tepër, trupi gjykues vëren se në harmoni me deklaratimet e bëra prej subjektit dhe personit të lidhur në ILDKPKI, nëpërmjet këtij dokumenti noterial, në janar të vitit 2015, personi i lidhur ka deklaruar se janë në procedurat ligjore për të bërë të mundur kalimin e pronësisë së katit të parë nga emri i tij në emrin e kumatës së tij.

28.10. E pyetur nga Komisioni³⁷ nëse janë bërë përpjekje apo janë ndjekur hapa konkretë për kalimin e të drejtave pasurore për një kat të banimit të këtij objekti në favor të vëllait të ndjerë të bashkëshortit të saj dhe/apo të trashëgimtarëve ligjorë të tij, subjekti i rivlerësimit ka referuar disa rrethana familjare, si dhe fillimin e procesit të rivlerësimit që me daljen e ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë ndikuar që të mos realizohet ky proces, por duke konfirmuar se vullneti i familjes së saj ka qenë për t'i kaluar në pronësi familjarëve të vëllait të bashkëshortit të saj katin e parë të kësaj pasurie.

28.10.1. Komisioni vëren se të njëjtat rrethana ka deklaruar edhe shtetasja S.H në deklaratën noteriale³⁸ të bërë në datën 5.5.2022, por tani kunati ka filluar procedurat për kalimin e pronësisë të katit të tyre në emrin e saj dhe të fëmijëve të saj. Në përgjigje të pyetësorit nr.***, subjekti ka informuar se kanë nënshkruar një kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme me shtetasen S.H për pjesën takuese të pasurisë, si dhe janë kryer aplikimet për pajisjen me certifikatë pronësie³⁹ për katin e parë të banimit.

28.10.2. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë të re certifikatën e regjistrimit të pronësisë me datë lëshimi 20.9.2022, nga ku rezulton se bazuar në aktin e dhurimit⁴⁰ është regjistruar në emër të shtetasës S.H, pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 132.75 m², me nr. pasurie ***, kati i parë i banimit të godinës të regjistruar më parë tërësisht në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit A.M dhe, konkretisht, godinës nr. ***, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

28.10.3. Sa më sipër, në referim të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, deklaratimeve të bëra ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në ILDKPKI, deklaratimeve të bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ, provave të depozituara nga subjekti dhe atyre të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti me prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe ato të dhëna gjatë seancës dëgjimore, si dhe pas analizimit në harmoni të tyre, trupi gjykues krijoi bindjen se familja e vëllait të ndjerë të bashkëshortit ka banuar në vazhdimësi në të njëjtën godinë (prej vitit 2000 e në vijim) dhe, gjithashtu, është i besueshëm deklarimi bërë nga subjekti se ata kanë investuar shumën rreth 5,000,000 lekë në ndërtimin e pasurisë objekt vlerësimi⁴¹.

³⁷Pyetësi nr. ***.

³⁸Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2022, redaktuar nga noteri publik N.K.

³⁹Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. *** ka depozituar si prova mbështetëse kontratë dhurimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.6.2022, redaktuar nga noteri publik E.K dhe kopje të dy aplikimeve *online* në faqen e ASHK-së nga noteri publik E.K.

⁴⁰Rezultoi akt tjetër dhurimi (kontratë) i ndryshëm nga ai i datës 10.6.2022 (referuar dhe depozituar me përgjigjet e pyetësorit nr. ***).

⁴¹Një kat i objektit referohet nga subjekti se është në përdorim të familjes së vëllait të ndjerë të bashkëshortit të saj.

28.10.4. Si rrjedhim, në analizën financiare do të vlerësohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshorti) kanë investuar në total shumën rreth 15,000,000 lekë për ndërtimin e objektit 3-katësh + papafingo. Vlerat e investuara nga familja e vëllait të bashkëshortit do të reflektohen sipas vetëdeklarimit të bërë nga subjekti, pra, se deri në vitin 2003 ka investuar shumën 600,000 lekë dhe se në vijim, për vitet 2004 – 2012, shumat respektive të deklaruara për çdo vit më vete.

28.11. Siç u pasqyrua edhe më sipër, sa u përket investimeve/shpenzimeve të kryera për ndërtimin e katit ku jeton familja e vëllait të bashkëshortit, rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar Vetting, subjekti ka deklaruar se janë mbuluar me të ardhurat nga: (i) shitja e kamionit nga vëllai i bashkëshortit në vitin 1995; (ii) shitja e shtëpisë 2+1, në Bajram Curri, nga familja e vëllait të bashkëshortit në vitin 2012; si dhe (iii) nga kontributet e fëmijëve që ndodhen në Kanada (vajza V) dhe Itali (djali I).

28.11.1. Pasi Komisioni i kërkoi subjektit⁴² të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e të ndjerit, vëllait të bashkëshortit dhe/apo familjarëve të tij, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 5,000,000 lekësh, deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit u ka qëndruar të njëjtave deklarime si në deklaratën Vetting të parashtruar më sipër.

28.11.2. Në vijim të komunikimit me Komisionin⁴³, subjekti depozitoi si provë kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme⁴⁴ të datës 10.7.2012, në referim të të cilit nëna e bashkëshortit të subjektit, si dhe trashëgimtarët ligjorë të vëllait të tij të ndjerë, S.H, kanë shitur pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 76 m², të ndodhur në Bajram Curri, për vlerën 1,550,000 lekë.

28.11.3. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se⁴⁵ *në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar se ka prova të tjera për të depozituar. Bëhet fjalë në lidhje me dokumentacionin e automjetit tip “****” 5 tonësh me targa ***, ngjyrë bizele, me nr. shasie ***, të cilin kunati i saj S.H e ka pasur në pronësi dhe ia ka shitur shtetasit (të ndjerit) P.K në vitin 1995, në shumën prej 600,000 lekë. Kontratën e shitjes së automjetit nuk ka arritur ta sigurojë. Kunata e saj, S. H, i kishte thënë se e posedonte atë dokument, ndaj dhe e ka deklaruar më parë pranë Komisionit, por përfundimisht ajo nuk arriti ta gjente tek sendet e bashkëshortit të saj. Janë interesuar, por nuk kanë arritur ta sigurojnë atë, pasi kanë kaluar shumë vite që nga ajo kohë dhe noteri M.B, tashmë në pension, që ka bërë kontratën, i ka thënë që është djegur arkiva e atyre viteve në trazirat e vitit 1997... Sqaron se janë interesuar tek familjarët e të ndjerit P.K (blerës i automjetit të lartpërmendur) dhe kanë arritur të sigurojnë nga ana e tyre kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2001, ku dhuruesi është blerësi i automjetit të S. H, shtetasi (i ndjeri) P. K; karakteristikat e automjetit të dhuruar janë pikërisht ato të automjetit të shtetasit S.H “****”, me nr. shasie ***, me ngjyrë bizele, por ka ndryshuar targa, pasi siç thuhet dhe nga shkresa nr. *** prot., datë 15.6.2020, e DPSHTRR-së rezulton se ky mjet ka qenë i regjistruar me targën *** dhe se në vitin 2000 ka ndërruar pronësi dhe ka marrë targë tjetër⁴⁶.*

⁴²Pyetësori nr. ***.

⁴³Shpjegimet shtesë në lidhje me pyetësorin nr. ***, dërguar në rrugë elektronike me e-mail-in e datës 31.5.2022, si dhe dokumentacioni mbështetës i depozituar në protokollin e Komisionit me nr. *** prot., datë 31.5.2022.

⁴⁴Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2012, redaktuar nga noteri publik F.D.

⁴⁵Me përgjigjet e pyetësorit nr. ***.

⁴⁶Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentet kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2001, vërtetuar njësisht me origjinalin me dokumentin noterial nr. *** rep., datë 29.6.2022, redaktuar nga noteri publik I.T; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.6.2022, të DPSHTRR-së (drejtuar subjektit).

28.11.4. Rezulton se në përgjigje të kërkesës së bërë prej subjektit, DPSHTRR-ja ka informuar se arkivat e tyre fizike nuk disponojnë asnjë dokumentacion për mjetin me targa ***, pasi ky mjet rezulton të jetë i regjistruar para vitit 1999, kur është themeluar ky institucion dhe një pjesë e këtyre dosjeve të mbartura nga Policia e Shtetit janë djegur në vitin 1997. Gjithashtu, informojnë se e vetmja e dhënë që ata disponojnë aktualisht është një gjurmë e lënë në sistemin e vjetër elektronik, ku rezulton se ky mjet ka qenë i regjistruar me targa *** dhe në vitin 2000 ka ndërruar pronësi dhe ka marrë targë tjetër. Sqarojnë se karakteristikat fizike të mjetit, referuar sistemit elektronik kombëtar, rezultojnë: *forma kamion, marka “***”, tipi ***, ngjyra bizele, nr. shasie ****.

28.11.5. Për sa më sipër, subjekti pretendon se provohet që karakteristikat fizike të automjetit të lartpërmendur janë, pikërisht, ato që ka pasur automjeti i kunatit të tij, me targa ***, për të cilin rezulton se ka ndryshuar pronësi.

28.11.6. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale të shtetases S.H⁴⁷, e cila ka deklaruar se në vitin 1995 bashkëshorti i saj ka shitur mjetin e mësipërm dhe në vitin 1998 i ka dhënë të vëllait A.M shumën 600,000 lekë të përfituar nga shitja e kamionit, për ta përdorur për ndërtimin e katit të tyre të banimit, ku jeton aktualisht me djalin e saj.

28.11.7. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, ku të provohej përfitimi i të ardhurave në shumën prej 600,000 lekësh nga vëllai i ndjerë i bashkëshortit. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga vëllai i bashkëshortit të subjektit, nga shitja e kamionit në vitin 1995.

28.11.8. Në prapësimet dhe shpjegimet e tij gjatë seancës dëgjimore, subjekti u ka qëndruar të gjitha deklaratimeve të mëparshme mbi shitjen e mjetit tip “***” në vitin 1995 dhe për të ardhurat e përfituara si rezultat i këtij transaksioni, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se: (i) është përpjekur të dokumentojë çdo provë direkte dhe indirekte që ka të bëjë me shitjen e kamionit nga kunati i saj; (ii) për shkaqe objektive, nga mungesa e dokumentacionit për shkak të djegies në vitin 1997, nuk mund të dokumentohet vlera e shitjes; (iii) me anë të provave të paraqitura në përgjigje të pyetësorë ka arritur të dokumentojë në mënyrë direkte ekzistencën e mjetit motorik dhe në mënyrë indirekte se vlera e shitjes së kamionit është e përafërt me çmimin e shitjes në ato vite për këto lloj mjetesh.

28.11.9. Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se një nga burimet e të ardhurave të investuara nga familja e të ndjerit, vëllait të bashkëshortit të saj, ka qenë nga shitja e mjetit tip “***” të përfituar nga privatizimi i Ndërmarrjes së Grumbullim-Përpunimit, në vlerën 600,000 lekë, shtetasit P.K, ndërsa gjatë hetimit administrativ ka provuar se shtetasi P.K ka shitur/dhuruar një mjet të të njëjtit tip në datën 20.9.2001⁴⁸.

28.11.10. Komisioni vëren se subjekti ka bërë përpjekje për disponimin e dosjes së mjetit, por duket se ka qenë në pamundësi objektive për disponimin e saj, pasi Bashkia Tropojë ka konfirmuar se gjatë trazirave të vitit 1997 janë djegur dhe shkatërruar plotësisht dokumentacioni në zyrat, ku mund të gjendeshin të dhëna për këtë mjet. Gjithashtu, rezulton se e vetmja e dhënë e përfituar nga DPSHTRR-ja për këtë mjet ka qenë rrethana e regjistrimit të tij me targa *** dhe se në vitin 2000 ka ndërruar pronësi (gjurmë e lënë në sistemin e vjetër elektronik).

⁴⁷ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.6.2022, redaktuar nga noteri publik G.D.

⁴⁸Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., me nr. *** kol., datë 20.9.2001, redaktuar nga noteri publik V.I.

28.11.11. Sa më sipër, pas analizimit të deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratën *Vetting*, në harmoni me deklaratimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, nisur nga periudha e largët që ka ndodhur ky transaksion, faktit se pala shitëse dhe pala blerëse, të pretenduara, kanë ndërruar jetë, si dhe në vlerësim të situatës së faktuar mbi pamundësisë objektive për disponimin e kontratës së shitjes së këtij automjeti të vitit 1995, trupi gjykues krijoi bindjen se vëllai i ndjerë i bashkëshortit të subjektit ka pasur në pronësi një mjet tip “***” të përfituar nëpërmjet privatizimit dhe, në këtë kontekst, është i pranueshëm deklarimi i bërë mbi të ardhurat e përfituara prej tij, si rezultat i transaksionit të shitjes së kësaj pasurie, të kryer në vitin 1995.

28.12. Ndërsa, lidhur me të ardhurat e pretenduara si të dërguara nga shtetasja V.K (H), subjekti ka depozituar dokumentin noterial të përpiluar në shtetin kanadez⁴⁹, në referim të së cilës kjo shtetase ka deklaruar se *ka kontribuuar në ndërtimin e shtëpisë së prindërve të saj gjatë periudhës 2003 – 2012, kohë në të cilën ka jetuar dhe punuar në Toronto, Kanada dhe ka pasur si prioritet kryesor mbështetjen e familjes së saj në Shqipëri. Shumat 3,000 – 5,000 deri në 10,000 dollarë kanadezë i ka sjellë në Shqipëri më anë të personave të njohur, miqve të familjes dhe në kohën kur kthehej vetë në Shqipëri. Shumat e dërguara kanë qenë të ndryshme, por shuma totale e dërguar ka qenë 75,000 dollarë kanadezë nga të cilat rreth 65,000 dollarë kanadezë kanë shërbyer për ndërtimin dhe pjesa tjetër 15,000 dollarë kanadezë janë shpenzuar për pjesën e brendshme të shtëpisë.*

28.12.1. Sa i përket ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të shtetasës V.K (H), subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, kopje të disa dokumenteve që lidhen me deklarin e taksave dhe rimbursimin e tatimeve në shtetin e Kanadasë⁵⁰ për personin tjetër të lidhur, për periudhën 2000 – 2014, në referim të të cilave rezulton se kjo shtetase ka përfituar të ardhura për vitet 2000 – 2012, si vijon: (i) për vitin 2000, të ardhura *neto* në shumën 4,529 dollarë kanadezë; (ii) për vitin 2001 të ardhura *neto* në shumën 6,300 dollarë kanadezë; (iii) për vitin 2002, të ardhura *neto* në shumën 6,678 dollarë kanadezë; (iv) për vitin 2003 të ardhura *neto* në shumën 22,395 dollarë kanadezë; (v) për vitin 2004 të ardhura *neto* në shumën 22,395 dollarë kanadezë; (vi) për vitin 2005, të ardhura *neto* për shumën 22,633 dollarë kanadezë; (vii) për vitin 2006, të ardhura *neto* në shumën 22,160 dollarë kanadezë; (viii) për vitin 2007, të ardhura *neto* në shumën 13,491 dollarë kanadezë; (ix) për vitin 2007, të ardhura *neto* në shumën 13,491 dollarë kanadezë; (x) për vitin 2008, të ardhura *neto* në shumën 10,880 dollarë kanadezë; (xi) për vitin 2009, të ardhura *neto* në shumën 34,883 dollarë kanadezë; (xii) për vitin 2010, të ardhura *neto* në shumën 42,986 dollarë kanadezë; (xiii) për vitin 2011, të ardhura *neto* në shumën 60,023 dollarë kanadezë; dhe (xiv) për vitin 2012, të ardhura *neto* në shumën 65,559 dollarë kanadezë.

Në total të ardhurat për vitet 2000 – 2012, në shumën 337,523 dollarë kanadezë.

28.12.2. Të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga shtetasja V.K në shtetin kanadez, për periudhën 2000 – 2012, si dhe shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si të dërguara prej saj ndër vite, të cilat që kanë shërbyer për investimet e kryera në pasurinë objekt vlerësimi, paraqiten si në tabelën vijuese.

⁴⁹Deklarata noteriale e datës 23.4.2022, redaktuar nga noteri Y. K.W, në provincën e Ontarios, Kanada, konfirmuar me vërtetim përkthimi me nr. *** rep., datë 6.5.2022, redaktuar nga noteri publik N.K.

⁵⁰Të përkthyer nga përkthyesi zyrtar L.F, konfirmuar me vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 6.5.2022; nr. *** rep., datë 6.5.2022; nr. *** rep., datë 25.4.2022; dhe nr. *** rep., datë 26.4.2022, të redaktuara nga noteri publik N.K.

Tabela nr. 1

| Viti | Të ardhura <i>neto</i> të realizuara (vlerat në dollarë kanadezë) | Kontribute të deklaruarra për ndërtimin e shtëpisë (vlerat në dollarë kanadezë) |
|--------------|---|---|
| 2000 | 4 529 | |
| 2001 | 6 300 | |
| 2002 | 6 678 | |
| 2003 | 22 395 | |
| 2004 | 25 006 | 5 000 |
| 2005 | 22 633 | 5 000 |
| 2006 | 22 160 | 5 000 |
| 2007 | 13 491 | |
| 2008 | 10 880 | 5 000 |
| 2009 | 34 883 | 5 000 |
| 2010 | 42 986 | 5 000 |
| 2011 | 60 023 | 5 000 |
| 2012 | 65 559 | 10 000 |
| Total | 337 523 | 45 000 |

28.12.3. Në seancën dëgjimore të datës 26.9.2022, subjekti rivlerësimit depozitoi kopje të deklaratave të taksave dhe dokumenteve që lidhen me rimbursimin e tatimeve në shtetin kanadez për shtetasen V.K, për vitet 2000 – 2014, të referuara si më sipër, të njësuara me origjinalin nga noter publik, në Ontario, Kanada, të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes e licencuar, znj. L.F.

28.12.4. Në analizë përfundimtare të deklarimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni krijoni bindjen se shtetasja V.K ka realizuar të ardhura në shtetin kanadez, të cilat mundësojnë plotësisht kryerjen e investimeve të deklaruarra prej familjarëve të saj në funksion të ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi.

28.12.5. Ky përfundim mbështetet edhe në faktin se në këtë rast kemi të bëjmë me pasuri të investuar nga familjarë të bashkëshortit të subjektit, të cilët në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, nuk paraqiten në cilësinë e personave të lidhur, në funksion të verifikimit të pasurisë objekt vlerësimi dhe në këtë këndvështrim, trupi gjykues çmon se verifikimi i të ardhurave të tyre të deklaruarra si burim për krijimin e kësaj pasurie kërkon një nivel më të ulët provueshmërie. Por, kjo situatë sigurisht është vlerësuar në hetimin dhe analizimin e pasurisë objekt vlerësimi si një të tërë, pra, mbi mënyrën e krijimit, pjesët takuese dhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat janë deklaruar se kanë shërbyer për ndërtimin e saj.

28.12.6. Pra, si konkluzion, trupi gjykues krijoi bindjen se nga totali i vlerës së deklaruar të kësaj pasurie prej 20,000,000 lekësh, shuma 5,000,000 lekë është vlerë e investuar nga familjarët e bashkëshortit të subjektit, të cilët tashmë zotërojnë edhe *de jure* katin e parë të godinës dhe se në këtë kuptim, në analizën financiare përfundimtare për mundësinë e krijimit të pjesës takuese mbi këtë pasuri, Komisioni do të reflektojë se vlera e shpenzuar nga subjekti dhe personat e lidhur për ndërtimin e godinës është në shumën 15,000,000 lekë, e investuar, ndër vite, sipas deklarimeve të bëra nga subjekti.

Analiza/verifikimi e/i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

29. Në referim të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, ndër vite, në ILDKPKI, si dhe deklarimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ rezulton se si burime për krijimin e pasurisë objekt vlerësi janë referuar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e dy apartamenteve në Bajram Curri (njëri i përshtatur si dyqan); (ii) të ardhurat nga pagat e tyre ndër vite; (iii) të ardhurat nga kompensimi i një parcele toke, në vitin 2013 kompensuar shuma 4,755,621 lekë dhe në vitin 2016 shuma 1,084,621 lekë; si dhe (iv) të ardhurat e përfituara prej ushtrimit të aktivitetit tregtar nga bashkëshorti.

Të ardhurat nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në Bajram Curri

29.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se si burim krijimi i shtëpisë së banimit 3 kate + papafingo, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, kanë shërbyer edhe të ardhurat në shumën 200,000 lekë, të përfituara nga shitja e dyqanit në Bajram Curri me sipërfaqe 73 m², me kontratë shitje apartamenti (përshtatur njësi) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.1999 (shitur pronarit të tokës, shtetasit M.U.M)⁵¹.

29.1.1. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Zyra Vendore Tropojë⁵² rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. A.M (përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. ***, datë 13.12.2006, nga z. I.M), i ka shitur shtetasit M.M pasurinë e llojit “njësi” me sipërfaqe 73 m², të ndodhur në Bajram Curri, për shumën 600,000 lekë, në dukje e njëjta pasuri e shitur në vitin 1999.

29.1.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është vënë në dijeni të ekzistencës së dy kontratave vetëm në momentin e marrjes së pyetësorit, duke konfirmuar se në bazë të aktit noterial kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.1999, bashkëshorti i saj ka shitur apartamentin e përshtatur në dyqan dhe se në këtë moment janë zhveshur nga e drejta reale e pronësisë mbi këtë pasuri të paluajtshme.

29.1.3. Sa i përket prokurës së posaçme me nr. ***, datë 13.12.2006, e lëshuar në emër të bashkëshortit të saj, A.M, për ta përfaqësuar si shitës shtetasi I.M në kontratën me nr. *** kol., nr. *** rep., datë 27.2.2007, subjekti deklaron se është një akt i falsifikuar, pasi bashkëshorti i saj nuk e ka nënshkruar këtë dokument dhe se nuk i ka dhënë të drejta shtetasit të sipërcituar (për të cilin subjekti deklaron se bashkëshorti i saj as nuk e njej si person) për të shitur një pasuri të cilën ai e kishte shitur më parë në vitin 1999. Ndodhur në këto rrethana, pas administrimit të dosjes së plotë nga ASHK-ja, Zyra Vendore Tropojë, lidhur me transaksionet e kryera mbi këtë pasuri, subjekti ka parashtruar faktin se bashkëshorti A.M ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (një kopje të kallëzimit e ka depozituar si provë në Komision⁵³). Gjithashtu, bashkëngjitur kallëzimit penal është depozituar aktekspertimi daktiloskopik nr. ***, datë 5.5.2022 (me ekspert privat të licencuar nga Ministria e Rendit Publik, z. V.H, me dëshmi për ekspert kriminalist nr. ****), ku është arritur në përfundim se emri, mbiemri, firma e shkruar në emër të shtetasit A.M në dokumentin objekt ekspertimi, prokurë e posaçme nr. ***, datë 13.12.2006, noter publik A.H, noteria Tropojë, nuk janë shkrimi dhe nënshkrimi origjinal i shtetasit A.M.

⁵¹Depozituar kopje e kontratës me dorëzimin e deklaratës *Vetting*.

⁵²Shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2020, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kukës, Zyra Vendore Tropojë, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2020.

⁵³Kallëzimi penal nr. ***, datë 6.5.2022.

29.1.4. Nga ana tjetër konstatohet se pasurinë e mësipërme bashkëshorti i subjektit e ka blerë në datën 12.1.1995 nga shtetasi M.V për shumën 600,000 lekë⁵⁴. Subjekti ka rikonfirmuar faktin se kjo pasuri është shitur në vitin 1999, për çmimin 200,000 lekë, kjo për shkak të disa rrethanave familjare dhe për shkak se i është shitur pronarit të truallit, i cili sipas saj nuk lejonte që ta blinte dikush tjetër atë pasuri.

29.1.5. Sa më sipër, në analizën financiare për periudhën deri në datën 31.12.2003, do të pasqyrohet si shpenzim shuma 600,000 lekë, pasqyruar si çmimi i paguar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 1995 dhe shuma 200,000 lekë, si e ardhur nga shitja e kësaj pasurie në vitin 1999.

29.1.6. Gjithashtu, konfirmohet se në datën 6.12.2001 me anë të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme⁵⁵ subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë shitur apartamentin e ndodhur në Tropojë (të blerë më parë prej tyre nga SMT-ja në vlerën 2,285 lekë⁵⁶) në shumën 800,000 lekë.

Të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur

29.2. Nga verifikimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* konstatohet se subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga punësimi i saj, për periudhat, punën e kryer dhe në vlera totale si vijon:

i) Për periudhën 1.10.1991 – 30.6.1992, të ardhura nga puna si sekretare e Këshillit Popullor të Qytetit, në vlerë të papërcaktuar. Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues vërtetimin e lëshuar nga ISSH-ja, dega Tropojë⁵⁷, datë 21.10.2016, në të cilin konfirmohet se për Këshillin Popullor të Qytetit Bajram Curri nuk disponojnë bordero, libër pagash, listëpagesa për periudhën 1.10.1991 – 30.6.1992. Si rrjedhim, në analizën financiare nuk janë reflektuar të ardhura nga ky burim.

ii) Për periudhën 1.7.1992 – 1.3.1997, të ardhura nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, në total për vlerën 702,250 lekë. Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues vërtetimin e datës 20.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se subjekti ka ushtruar funksionin si gjyqtare për periudhën korrik 1992 – 31.3.2006, ndërsa listëpagesat për periudhën 1992 – 28.2.1997 nuk gjenden në arkiv, pasi janë djegur gjatë trazirave të vitit 1997.

Komisioni ka verifikuar nga dosje të tjera pagat e konfirmuara për gjyqtarë, të cilët kanë ushtruar funksionin në gjykata të tjera të shkallës së parë në Republikën e Shqipërisë për të njëjtën periudhë, nga ku rezulton i pranueshëm deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat e përfituara për këtë periudhë. Si rrjedhim, në analizën financiare do të reflektohet shuma 702,250 lekë, si të ardhura të përfituara nga subjekti prej ushtrimit të funksionit të gjyqtarës për periudhën 1992 – 28.2.1997.

iii) Për periudhën 1.3.1997 – 31.3.2006, të ardhura totale nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, në vlerën 5,502,615 lekë. Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues vërtetimin⁵⁸ e datës 20.10.2016 të kësaj gjykate, ku reflektohen këto të dhëna.

⁵⁴Kontratë shitjeje nr. *** regj., nr. *** kol., datë 12.1.1995.

⁵⁵Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme, apartament banimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2001, redaktuar nga noteri publik, znj. E.L.

⁵⁶Kontratë blerjeje pasurie datë 25.12.1993, konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.1994.

⁵⁷Vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

Komisioni pasqyroj më vete të ardhurat nga pagat e subjektit të përfituara deri në datën 31.12.2003, si dhe të ardhurat e përfituara për vitet 2004, 2005 dhe 2006 nga ushtrimi i funksionit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke i reflektuar ato në rubrikën përkatëse të analizës financiare.

iv) Për periudhën 1.4.2006 e në vijim, të ardhura nga puna si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vlerën 11,406,275 lekë. Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵⁹, bashkëlidhur listëpagesat për periudhën e sipërcituar.

Për efekt të analizës financiare këto të ardhura janë konsideruar në këtë vlerë dhe në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe kreditimeve të kryera në bankë, duke reflektuar të ardhurat përkatëse të përfituara për vitet 2006 – 2012, të cilat janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

29.2.1. Nga verifikimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* konstatohet se subjekti ka deklaruar të ardhura nga punësimi i personit të lidhur, bashkëshortit të saj, për periudhat, punën e kryer dhe në vlera totale, si vijon:

i) Për periudhën 3.10.1991 – 4.8.1992, të ardhura nga paga si mësues në shkollën 8-vjeçare “****”, Tropojë, në total në shumën 6,800 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim nga ISSH-ja, dega Tropojë⁶⁰, në të cilin konfirmohet se nga DRSSH-ja Tropojë nuk disponohet asnjë dokument për pagën për shkollën “****”, për periudhën 3.10.1991 – 4.8.1992. Gjithashtu ka depozituar vërtetimin e Zyrës Arsimore Tropojë⁶¹, në të cilin konfirmohet se shtetasi A.M.H ka punuar si mësues në rrethin e Tropojës, por nuk është i regjistruar në regjistrat themeltarë të punonjësve të arsimit që ndodhen në Zyrën Arsimore Tropojë.

Sa më sipër, në analizën financiare nuk janë reflektuar të ardhura nga ky burim i deklaruar.

ii) Për periudhën 4.8.1992 – 12.12.1992, të ardhura nga paga si sekretar i klubit sportiv “****”, në vlerën 3,120 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetimin e lëshuar nga ISSH-ja, dega Tropojë⁶², datë 21.10.2016, në të cilin konfirmohet se për Komitetin Ekzekutiv nuk disponojnë bordero, libër pagash, listëpagesa për periudhën 4.8.1992 – 12.12.1992.

Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka depozituar kopje të librezës së punës⁶³ të personit të lidhur, në të cilën pasqyrohet punësimi për këtë periudhë si sekretar i klubit sportiv Tropojë, por nuk ka të dhëna për të ardhurat e përfituara. Për rrjedhojë, në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhura nga ky burim.

iii) Për periudhën 2.12.1992 – 16.10.1993, të ardhura nga paga si kryetar i Degës së Rendit Publik, pa vlerë të përcaktuar. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetimin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme⁶⁴, në të cilin konfirmohet se personi i lidhur, z. A.M, ka punuar në strukturat e kësaj ministrie si oficer (në Degën e Punëve të Brendshme Tropojë), për periudhën 14.12.1992 – 6.10.1993, kohë në të cilën del në lirim për mosparaqitje në detyrë. Ka mbajtur gradën “major”.

⁵⁹Vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pagën *bruto* dhe *neto*, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁰Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶¹Vërtetimi nr. *** prot., datë 17.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶²Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016, i ISSH-së, dega Tropojë, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶³Vërtetuar njësia e kopjes me origjinalin nr. *** rep., datë 17.10.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. N. K.

⁶⁴Vërtetimi nr. *** prot., datë 24.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka depozituar kopje të librezës së punës⁶⁵ të personit të lidhur, në të cilën pasqyrohet punësimi për këtë periudhë si shef i Komisarariatit të Policisë Tropojë (periudha 12.12.1992 – 16.10.1993). Por, në këto dokumente nuk referohet shuma e të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur. Për rrjedhojë, në analizën financiare paraprake nuk u përfshinë të ardhura nga ky burim.

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi vërtetimin e lëshuar nga Ministria e Brendshme⁶⁶, ku konfirmohet se shtetasi A.M, ish-punonjës në strukturat e Ministrisë së Rendit Publik, ka ushtruar detyrën e kryetarit të Degës së Rendit Publik Tropojë, duke referuar nivelet e pagës për periudhën gjatë së cilës ka qenë në detyrë. Referuar këtij vërtetimi, të ardhurat kanë qenë në shumën 65,782 lekë. Komisioni do të shtojë këtë vlerë të të ardhurat në analizën financiare përfundimtare.

iv) Për periudhën 16.9.2006 – 1.1.2008, të ardhurat nga paga si drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore pranë KESH-it, në total në shumën 1,218,761 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetimin⁶⁷, ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

Për efekt të analizës financiare këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe me kreditimet e kryera në bankë.

v) Për periudhën 1.1.2008 – 16.10.2009, të ardhura nga paga si Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore pranë OSSH-së, në vlerën 2,691,063 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim⁶⁸, ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

Për efekt të analizës financiare, këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe kreditimet e kryera në bankë.

vi) Për periudhën 10.3.2010 – 31.8.2011, të ardhura nga paga si Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, në total në shumën 2,050,533 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim⁶⁹, ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

Për efekt të analizës financiare, këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe kreditimet e kryera në bankë.

vii) Për periudhën 1.9.2011 – 22.6.2012, të ardhura nga paga si administrator i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, për vlerën 951,728 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim⁷⁰, ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

Për efekt të analizës financiare këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues ligjor dhe kreditimet e kryera në bankë.

viii) Për periudhën 25.6.2012 – 15.5.2013, të ardhura nga paga si kryetar i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve pranë Ministrisë së Ekonomisë, në total shuma 1,219,780 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim⁷¹, ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

⁶⁵Vërtetuar njësisht e kopjes me origjinalin nr. *** rep., datë 17.10.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. N.K.

⁶⁶Vërtetim nr. *** prot., datë 19.9.2022.

⁶⁷Vërtetim nr. ***, datë 2.11.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁸Vërtetim për bazën e vlerësueshme, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁹Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁰Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷¹Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

Për efekt të analizës financiare këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues ligjor dhe kreditimet e kryera në bankë.

ix) Për periudhën 15.5.2013 – 19.8.2015, të ardhura si drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, në total për shumën 2,760,048 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim⁷², ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

Për efekt të analizës financiare këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues ligjor dhe kreditimet e kryera në bankë.

x) Për periudhën 2007 – 2015, të ardhura nga paga si këshilltar pranë Njesisë Bashkiake Nr. ***, në total shumën 1,031,333 lekë. Në mbështetje të deklaramit të bërë ka depozituar vërtetim⁷³, të lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. ***, ku konfirmohet periudha e punësimit dhe paga *neto* e përfituar prej personit të lidhur.

Për efekt të analizës financiare këto të ardhura janë reflektuar në përputhje me dokumentacionin justifikues ligjor dhe kreditimet e kryera në bankë.

Të ardhurat e përfituara nga kompensimi i truallit

29.3. Siç u konstatua më sipër, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “truall” më sipërfaqe 461.5 m², që i përket shtëpisë që ndodhet në adresën: rruga “****”, sipër Q.S, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë. Toka me sipërfaqe 710 m² është blerë në vitin 1998 nga bashkëshorti (provuar ky fakt me kontratën e shitblerjes truall me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.1998).

29.3.1. Në deklaratën fillestare të pasurisë (viti 2003), subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese të shtëpisë së banimit 180 m² dhe truallit prej 400 m², ndërsa në deklaratën e interesave private të vitit 2004 ka deklaruar se zotëron 35% të pasurisë tokë prej 400 m², në zonë informale me vlerë 1,500,000 lekë.

29.3.2. Në deklaratën para fillimit të detyrës (viti 2012), bashkëshorti i subjektit A.M ka deklaruar se toka mbi të cilën është ndërtuar shtëpia është blerë në vitin 1998 në bashkëpronësi me shtetasin P.P, ndarë në vitin 2010 dhe regjistruar në ZRPP në vitin 2011 me certifikatë pronësie nr. ***, volumi ***, faqe ***, datë 7.1.2011. Toka është blerë me 3,500 lekë m², nga trashëgimtarët e shtetasit M.Zh. Vlera: 1,600,000 lekë. Burimi financiar është kontributi i dy bashkëshortëve në vite nga punë të ndryshme, si dhe puna e tij në sektorin privat në vitet 1994 – 2006, kjo e dokumentuar dhe deklaruar nga znj. Shefkie Mataj (Demiraj).

29.3.3. Gjithashtu, në seksionin e të dhënave konfidenciale të deklaratës para fillimit të detyrës, në vitin 2012, personi i lidhur ka deklaruar se në ZRPP-në Tiranë figuron e regjistruar në emrin e tij toka me sipërfaqe 736 m², por ai ka në pronësi reale 461 m², ku është ndërtuar shtëpia e legalizuar. Sipërfaqja prej 275 m² është e kunatit, z. I.D. Në vijim ka deklaruar se *kunati i tij (vëllai i subjektit) ka ndërtuar mbi këtë sipërfaqe një shtëpi dhe është në proces legalizimi. I ka dhënë një deklaratë noteriale dhe janë në proces të kalimit të pronësisë për sipërfaqen 275 m². Deri tani ka qenë e pamundur për arsye procedurash. Pra, ai (bashkëshorti i subjektit) ka 461 m² tokë faktike. Toka është në emrin e tij sepse në vitin 1998 kunati ka qenë në emigracion dhe nuk vinte dot në Shqipëri. Për sipërfaqen 275 m², kunati ka paguar 1,100,000 lekë të reja. Çmimi për metër katror, 4,000 lekë”.*

29.3.4. Siç u konstatua edhe më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, lidhur me pasurinë e llojit “truall”, ka rezultuar se: (i) në datën

⁷²Vërtetim nr. *** prot., datë 27.10.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷³Vërtetim i ndodhur në aneksin nr. ***, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

5.5.1998, z. P.P ka lidhur një kontratë kapari për pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 1,666 m², të ndodhur në Tiranë, për vlerën 5,820,000 lekë, duke paguar vlerën e kaparit në shumën 1,200,000 lekë; (ii) në datën 6.7.1998, z. A.M (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi F.Gj) dhe z. P.P kanë blerë si bashkëpronarë pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 1,634 m², të ndodhur pranë rrugës “****” (K e Sh.P), për vlerën 1,900,000 lekë, truall i cili duket se është i njëjtë me atë për të cilin ishte lidhur kontrata e kaparit e sipërcituar; (iii) në datën 17.12.2010, me anë të kontratës së pjesëtimit vullnetar, bashkëpronarët P.P dhe A.M kanë vendosur me mirëkuptim të ndajnë pasurinë prej 1,634 m² në dy pjesë takuese, ku z. P.P ka përfituar 924.5 m², ndërsa z. A.M ka përfituar 709.5 m²; (iv) në datën 6.8.2012 është nxjerrë leja e legalizimit në emër të z. A.M, për objektin godinë banimi 4 kate, me sipërfaqe trualli 461.3 m², sipërfaqe ndërtimi 145.7 m², sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 672.9 m²; (v) në datën 21.11.2012, pasuria godinë banimi 4 kate, referuar si më sipër, është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të z. A.M, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe trualli 461.3 m², sipërfaqe ndërtimi 145.7 m² dhe sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 672.9 m²; (vi) në datën 21.11.2012, pasuria e llojit “truall” e mbetur me sipërfaqe prej 248.2 m² (709.5 m² – 461.3 m²) është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të z. A.M, me nr. pasurie ***; (vii) në datën 23.5.2013, pasuria e llojit “truall” me sipërfaqe 248.2 m² është rivlerësuar në vlerën 8,343,243 lekë; (viii) në datën 16.8.2013, pasuria e llojit “truall” me sipërfaqe 248.2 m² është shpronësuar, duke u përcaktuar si vlerë shpronësimi shuma 8,343,243 lekë; (ix) në datën 3.9.2013, pasuria “truall” me sipërfaqe 248.2 m² është regjistruar në favor të shtetasit I.R.D (vëllait të subjektit) sipas kontratës së lidhur midis tij dhe ALUIZNI-t kundrejt çmimit të blerjes 115,000 lekë; (x) në datën 20.9.2013, nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kreditohet shuma 4,755,648 lekë në “Credins Bank” në favor të shtetasit A.M si pjesë e 57% të vlerës së truallit të shpronësuar nga ALUIZNI; dhe (xi) në datën 20.4.2016, nga Agjencia e Trajtimit të Pronave kreditohet shuma 1,084,621 lekë në “Credins Bank” në favor të shtetasit A.M, si pjesë e 13% të vlerës së truallit të shpronësuar nga ALUIZNI.

29.3.5. Pasi Komisioni i kërkoi të japë detaje lidhur me blerjen e truallit⁷⁴, subjekti ka shpjeguar se *trualli ku kanë ndërtuar shtëpinë me 3 kate + papafingo është siguruar nga P.P, i cili ka takuar pronarët (trashëgimtarët dy djem dhe katër vajza) të familjes M.Zh, që kishin në pronësi 10,000 m² tokë sipër Q.S, lagje “Xh.Sh”, në pranverë të vitit 1998. Secili nga trashëgimtarët përfitonte 1666 m². Meqenëse parcela e tokës truall ishte me sipërfaqe 1666 m² dhe kishte disa bashkëpronarë (vëllezër dhe motra), të cilët nuk pranonin ta shisnin pjesë - pjesë, P u pagoi kapar 1,200,000 lekë, duke u lënë një afat për përfundimin e akteve të pronësisë. P.P nuk kishte mundësi financiare të blinte të gjithë sipërfaqen e parcelës dhe, për këtë arsye, pasi vjen në Bajram Curri i bën një ofertë bashkëshortit të saj që ai të blinte një pjesë të tokës, pasi e dinte se ai ishte në kërkim të një parcele toke, ku të ndërtonte një shtëpi në vitet në vazhdim, por donte që toka të ishte me dokumente të rregullta. Bashkëshorti i saj dhe P.P me vëllezër ishin rritur bashkë në të njëjtin pallat dhe ishin miq të vjetër. Gjithashtu, ajo vetë me P dhe vëllezërit e tij janë kushërinj të afërt nga nënat (nënat e tyre vajza xhaxhallarësh). Bashkëshorti i saj bie dakord duke i thënë P që ai kishte mundësi të blinte deri në 1,500,000 lekë për afërsisht 450 deri 500 m², ku do të ndërtonte shtëpi së bashku me vëllain e tij S.H. Gjithashtu, vëllai i saj i vogël (i ndjeri A.D) afrohet që mund të merrte 250 m², por pagesën do ta bënte në vitet në vazhdim me këste. Kështu ranë dakord në parim dhe hollësisht do ta shikonin në terren. Sqaron se toka është blerë nga P.P, pasi pronarët realizuan përpjesëtimin e pasurisë në parim dhe në terren konkretisht. Bashkëshorti i saj i ka dhënë shumën 1,600,000 lekë për pjesën e tij 461.5 m² me çmimin 3,500 lekë/m². Në aktin e shitjes së tokës në kontratë shitje në prezencë të noteres T.M në cilësinë e blerësit ishin P.P dhe A.H, përfaqësuar nga kunati saj F.Gj me prokurë (i cili jeton në Tiranë). Bashkëshorti i saj nuk*

⁷⁴Pyetësori nr. ***.

ishite prezent në blerjen e tokës, pasi në këtë periudhë, brenda 1 muaji ajo humbi dy vëllezërit saj, i ndjeri A.D dhe vëllai i madh, i ndjeri B.D. Bashkëshorti i saj vjen në Tiranë në gusht të vitit 1998 dhe fillon punën për rrethimin e gjithë tokës, si dhe kanalën e ujërave të zeza dhe të ujit të pijshëm. Toka ndahet në tri pjesë me mure. Parcela e P afërsisht 915 m², parcela e bashkëshortit 461.5 m² dhe parcela e mbetur 248.2 m² e porositur nga vëllai i saj, i ndjeri A.D. Bashkëshorti i saj në shtator 1998 fillon themelet e shtëpisë dhe ndërtimin karabina tra kollone. Vëllai i saj, I.D, pas vdekjes së vëllezërve erdhi nga Zvicra dhe mori familjen e tij, bashkëshorten dhe vajzën dhe bashkëshorten e vëllait të madh me dy djem si dhe prindërit dhe u vendosën në A Tiranë. Në vitin 1999, vëllai I.D filloi ndërtimin e shtëpisë. Bashkëshorti i saj, i shpjegon vëllait të saj, I.D, marrëveshjen e bërë më parë me vëllain e saj, A.D, që nuk jetonte më, për truallin me sipërfaqe 250 m², për likuidimin që do t'i bënte atij me këste, i cili e pranoi marrëveshjen. Vëllai i saj, ndërtoi shtëpinë karabina 2 kate + papafingo dhe bëri suvatimet në katin e parë. Në vitin 2001, bashkëshorti i saj, i kujton vëllait të saj pagesën e tokës që duhej t'i bëhej P.P, por ai iu përgjigj që kur të ketë mundësi do t'ia paguante, në atë kohë do të mbaronte shtëpinë. Këtu filloi krisja e parë e marrëdhënies së bashkëshortit me vëllain e saj, I.D. Bashkëshorti i saj ra dakord me P.P dhe vëllezërit B dhe H.P që punimet e shtëpisë së tyre t'i ndiqte ai meqenëse projekti ishte i njëjtë, veçse shtoej një kat më shumë dhe pagesat për punën do t'ia zbrisnin tek vlera 1,100,000 lekë e tokës prej 250 m² (bëhet fjalë për tokën e vëllait të saj I.D)⁷⁵. Në vitin 2010 P.P dhe bashkëshorti i saj kanë bërë ndarjen e tokës ku bashkëshorti kishte parcelën prej 709 m² (e ndarë në dy pjesë 461.5 m² dhe 248.5 m²), ku ishin ndërtuar dy shtëpi, të cilat ishin në përfundim dhe në proces legalizimi. Në vitin 2011 e kanë regjistruar në ZRPP Tiranë tokën (truallin). Në vitin 2007 bashkëshorti ka aplikuar për legalizim të shtëpisë së tyre, duke deklaruar se janë në proces të regjistrimit të truallit në ZRPP Tiranë, duke paraqitur kontratën e shitjes së tokës të vitit 1998.

29.3.6. Ndërsa si burim për blerjen e truallit subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga biznesi, aktivitet tregtar “shitje me shumicë dhe pakicë artikuj ushqimorë dhe industrialë”, market “****”.

29.3.7. Në vijim të verifikimit të shpjegimeve të dhëna me përgjigjet e pyetësorit nr. ***, lidhur me shumën e paguar për blerjen e këtij trualli dhe marrëdhënien mes vëllait të subjektit dhe bashkëshortit të saj mbi këtë pasuri, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të tjera shtesë, të cilat në thelb përmbliken në dy pretendimet si vijon: (i) vlera e paguar nga bashkëshorti i saj për blerjen e truallit në vitin 1998 është 1,600,000 lekë, me burim të ardhurat nga aktiviteti tregtar i tij; dhe (ii) vëllai i saj nuk ka paguar shumën 1,100,000 lekë për blerjen e këtij trualli.

29.3.8. Subjekti ka deklaruar se duke qenë në një marrëdhënie të posaçme familjare, marrëdhënie mes kunetërve, bashkëshorti i saj A.M, në mirëbesim, i ka lëshuar vëllait të saj I.D, një deklaratë me shkrim në lidhje me pagimin e detyrimit në shumën e mësipërme, për ta përdorur tek ALUIZNI për efekt legalizimi të banesës, por ajo nuk është ekzekutuar. Vëllai i saj nuk arriti t'i përgjigjej nga ana financiare as me këste, A.M, shumën e premtuar prej 1,100,000 lekësh për pasurinë “truall”, mbi të cilën ishte ndërtuar tashmë shtëpia dhe regjistruar në favor të vëllait të saj, I.D. Bashkëshorti i saj ka deklaruar se pas ndodhjes së aksidentit të djalit të tyre, B.M i është drejtuar I për t'i dhënë shumën e parave të premtuara, qoftë edhe me këste, por ai është përgjigjur që nuk ka pasur mundësi t'ia jepte dhe le të bënte çfarë të donte. Bashkëshorti i saj i ka thënë se ishte i detyruar ta deklaronte si pushtues, pasi

⁷⁵Në mbështetje të deklaramëve të saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.5.2022, të shtetasve B.P dhe H.P (vëllezërit e shtetasit P.P), redaktuar nga noteri publik N.K, pjesë e dokumentacionit mbështetës të depozituar në protokollin e Komisionit në datën 31.5.2022 (protokolluar me nr. ***).

ata po i ndihmonin njerëz të ndryshëm për hallin që i kishte zënë me B dhe ai nuk po i përgjigjej për lekët e truallit për vite të tëra. Në këto rrethana, bashkëshorti i saj A.M i është drejtuar ALUIZNI-t për të vijuar me procedurat ligjore, ku më pas është përgatitur praktika përkatëse për kompensimin e truallit të lartpërmendur. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në zbatim të VKM-së nr. 685, datë 16.8.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 22.8.2013, ka kompensuar parcelën prej 248.5 m², e cila ishte e regjistruar në emër të bashkëshortit të saj A.M.

29.3.9. Në vijim të deklaramit të saj, subjekti ka dhënë shpjegime duke pretenduar se për shkak të asaj situate të krijuar, bashkëshorti dhe vëllai i saj vazhdojnë të jenë në marrëdhënie të ngrira, ndërsa ajo vetë ruan marrëdhënie normale me vëllain e saj, I.D. Deklaron me përgjegjësi të plotë se nuk ka pasur dijeni për këtë fakt, pasi nëse do të kishte dijeni, do ta kishte reflektuar në deklaratën Vetting. Sqaron gjithashtu se periudha për të cilën bëhet fjalë ka qenë një nga më të errëtat e jetës së saj, me gjendje tejet të rënduar psikologjike dhe kjo për shkak se djali i saj vazhdonte të ishte në gjendje kritike për jetën në spital në Itali. Bashkëshorti dhe vëllai i saj nuk e kanë vënë në dijeni në atë kohë në lidhje me këtë fakt, rreth të cilit është informuar më vonë. Pasi ka ardhur në dijeni të këtij fakti, i ka kërkuar shpjegime bashkëshortit, i cili i është shprehur për marrëdhënien e krijuar me vëllain e saj I, duke i thënë se nuk ka dëshiruar që të rëndojë më tej gjendjen e saj psikologjike me fakte të kësaj natyre në atë periudhë, duke e konsideruar më shumë neglizhencë nga ana e tij.

29.3.10. Në mbështetje të deklaramëve të saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë dokumentin noterial⁷⁶ të datës 26.4.2022, në referim të të cilit vëllai i saj I.D, ndër të tjera ka deklaruar se: “Ai dhe kunati i tij i quajtur A.M kanë bërë një deklaratë noteriale në marrëdhënie mirëbesimi, sikur i ka paguar shumën prej 1,100,000 lekësh për blerjen e truallit prej 248.5 m², për ta përdorur tek ALUIZNI për efekt legalizimi të banesës së tij. Sqaron se kjo deklaratë nuk është ekzekutuar. Deklaron me përgjegjësi të plotë se vlerën monetare të pasqyruar në deklaratën noteriale prej 1,100,000 lekësh nuk ia ka dhënë realisht kunatit të tij, A.M, me gjithë dëshirën e mirë që kishte. Kunati i tij, A.M, ia ka kërkuar lekët me këmbëngulje, duke arsyetuar se i nevojiteshin, pasi kishte djalin (nipin e tij) në gjendje të rëndë shëndetësore nga aksidenti automobilistik i shkaktuar në datën 25.12.2012. Ai përfundimisht i ka thënë A se nuk ia jepte dot lekët për truallin e regjistruar në emrin e tij, ku ishte ndërtuar dhe banesa e tij dhe të bënte çfarë të donte, pasi nuk kishte mundësi financiare. Për këtë shkak, nga ajo kohë e në vijim me kunatin e tij i kanë marrëdhëniet e ngrira, ndërsa me motrën e tij Shefkie Demiraj (Mataj) marrëdhëniet i ka të mira.

29.3.11. Në vijim të komunikimit me Komisionin⁷⁷ subjekti ka depozituar një marrëveshje siguroese⁷⁸, nënshkruar nga shtetasit H.M, I.M, P.P dhe A.M, në referim të së cilës deklarohet se në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme (truall) çmimi i shitjes është shënuar gabim 1,900,000 lekë, pasi çmimi real është ai që është përcaktuar në kontratën e kaparit 5,820,000 lekë, vlerë e cila është likuiduar plotësisht nga blerësit në atë kohë jashtë zyrës noteriale.

29.3.12. Pasi Komisioni i kërkoj subjektit⁷⁹ të depozitonte kopje të deklaratës noteriale të bërë nga bashkëshorti i saj A.M, për kalim e pronësisë së truallit në emër të vëllait të saj, I.D, të referuar prej tij në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (DIPPF/2012), si dhe në përgjigje të pyetësorëve të mëparshëm, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *sikurse ka*

⁷⁶Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.4.2022, redaktuar nga noteri publik M.J.

⁷⁷Shpjegimet shtesë në lidhje me pyetësorin nr. ***, dërguar në rrugë elektronike me e-mailin e datës 31.5.2022, si dhe dokumentacioni mbështetës i depozituar në protokollin e Komisionit me nr. *** prot., datë 31.5.2022.

⁷⁸Marrëveshje siguroese nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.2022, redaktuar nga noteri publik S.M.

⁷⁹Pyetësori nr. ***, i dërguar subjektit.

shpjeguar edhe më parë, personalisht nuk ka qenë në dijeni për atë çka është deklaruar në raportet e detyrimit midis tyre, ndonëse kemi të bëjmë me marrëdhënie absolutisht të posaçme. Duke qenë se një akti i tillë është kërkuar për t'u paraqitur si dokument, janë vënë në lëvizje, por nuk e kanë gjetur këtë akt formal. Nga bisedat e vazhdueshme të bëra me bashkëshortin në lidhje me faktin se tek cili noter ishte hartuar ai akt noterial, i është përgjigjur se: "Nuk e mban mend noterin dhe as vitin e bërjes së deklaratës, pasi ka kaluar kohë e gjatë". Bashkëshorti i ka sqaruar se ishte hera e parë që plotësonte deklaratën e interesave private dhe mund të ketë bërë gabime. Në vlerësimin e saj, bashkëshorti ka pasur mbase perceptim të gabuar për deklaratën noteriale të lëshuar prej tij, pasi në vështrim të legjislacionit material civil, trualli nuk mund të shitej përveçse me një kontratë shitjeje në formën e kërkuar nga ligji. Rithekson se ka deklaruar më parë se bashkëshorti i saj A.M, në mirëbesim, i ka lëshuar vëllait të saj I.D një deklaratë noteriale në themel të së cilës qëndron një marrëdhënie juridike detyrimi, akt të cilin ai do ta përdorte bashkë me aktet e tjera bashkëngjitur aplikimit pranë ALUIZNI-t, në funksion të legalizimit të banesës së ndërtuar prej tij në mënyrë informale. Për sa i përket detyrimeve që përmbaheshin në të, ky akt nuk është ekzekutuar. Këtë fakt e ka deklaruar referuar bisedës që ka bërë me bashkëshortin, pasi vetë personalisht asnjëherë nuk e ka pasur këtë informacion për këtë deklaratë noteriale, po është informuar vetëm kur i kanë ardhur pyetjet e Komisionit. Gjithashtu, ka biseduar me vëllain e saj, I.D në lidhje me këtë deklaratë noteriale, i cili i ka thënë se me sa mban mend A.M i ka dhënë një deklaratë noteriale, por duke qenë se ka kaluar një kohë e gjatë nuk e mban mend te cili noter dhe në cilin vit është bërë.

29.3.13. Lidhur me çmimin e paguar për blerjen e truallit, Komisioni konstaton se bazuar në kontratën e kaparit të datës 5.5.1998, z. P.P, trualli prej 1,666 m², paraqitet në vlerën 5,820,000 lekë, pra rreth 3,500 lekë/m², sikurse e ka deklaruar çmimin për metër katror edhe vetë personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit. Në këtë këndvështrim, nisur nga fakti se pas kontratës së pjesëtimit vullnetar, bashkëshorti i subjektit ka përfituar sipërfaqen prej 709.5 m², Komisioni vlerëson se personi i lidhur ka paguar shumë më prej 2,483,250 lekësh për blerjen e tij (709.5 m² * 3,500 lekë = 2,483,250 lekë). Si rrjedhim, në analizën financiare do të reflektohet kjo vlerë si çmim i paguar për blerjen e truallit.

29.3.14. Në vijim të verifikimeve të kryera lidhur me praktikën e kompensimit financiar të truallit, pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁸⁰, Agjencia e Trajtimit të Pronave na dërgoi⁸¹ dokumentacionin e ndodhur në dosjen nr. ***, datë 18.9.2013, në emër të subjektit përfitues, A.M⁸². Nga verifikimi i praktikës së dërguar nga ATP-ja rezultoi se në vitin 2013, shtetasi A.M i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke i parashtruar faktin e aplikimit të bërë prej tij për kompensim për një tokë të zënë nga ndërtimet pa leje dhe miratimit të bërë me VKM-në Nr. 685, datë 16.8.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 22.8.2013, dhe ka kërkuar që dosja e tij të shqyrtohet me përparësi si rast i veçantë, pasi ndodhet në një situatë ekonomike të vështirë, për shkak të problemeve shëndetësore të djalit dhe shpenzimeve të larta spitalore⁸³.

29.3.15. Në datën 18.9.2013, zv/drejtori dhe drejtori i përgjithshëm i ATP-së kanë urdhëruar⁸⁴ pranimin e kërkesës dhe shqyrtimin e aplikimit, si një rast i veçantë, për arsye shëndetësore,

⁸⁰Shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, e Komisionit.

⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2022, e ATP-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.6.2022.

⁸²Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka depozituar praktikën e plotë të dosjes nr. ***, datë 18.9.2003, në emër të shtetasit A.M, administruar nga ATP-ja, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2022.

⁸³Ka depozituar bashkëlidhur kërkesës dokument mbi historikun mjekësor të djalit.

⁸⁴Urdhri nr. ***, datë 18.9.2013.

për shpërblimin e subjektit përfitues, z. A.M.M, mbi sipërfaqen takuese të pasurisë së paluajtshme, pronë private që preket nga ndërtimet informale.

29.3.16. Referuar informacionit të dërguar nga “Credins Bank” rezulton se në datën 20.9.2013, në llogarinë e personit të lidhur është kredituar shuma 4,755,648 lekë nga AKKP-ja, që i përgjigjet 57% të vlerës së kompensimit të truallit (konstatuar si më sipër), pasi në këtë llogari, në datën 17.10.2013, është kredituar edhe shuma 3,282,151 lekë nga Ministria e Shëndetësisë, sipas VKM-së përkatëse për mbulim shpenzimesh për kurimin e djalit, në datën 21.10.2013 personi i lidhur ka krijuar depozitën me afat 6-mujor në shumën 7,000,000 lekë. Gjatë vitit 2014, pasi është investuar sërish depozita së bashku me interesin e përfituar, janë kryer tërheqje në data të ndryshme nga kjo llogari, në total shuma prej 7,102,900 lekësh.

29.3.17. Ndërsa në datën 20.4.2016, në llogarinë në “Credins Bank” të personit të lidhur është kredituar shuma 1,084,624 lekë, e cila përfaqëson 13% të vlerës së kompensimit të truallit. Kjo shumë rezulton se është tërhequr plotësisht nga personi i lidhur nga data 27.4.2016 deri në datën 20.8.2016.

29.3.18. Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga kompensimi i truallit (trualli mbi të cilin është ndërtuar shtëpia e vëllait të subjektit) kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi. Por, nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar se kjo banesë është ndërtuar në vitet 1998 – 2012, ndërkohë që të ardhurat nga kompensimi i këtij trualli janë përfituar në vitet 2013 dhe 2016. Gjithsesi, Komisioni konstaton se në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 20.2.2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se disa punime në pasurinë objekt vlerësimi janë kryer edhe në vitin 2014 dhe do të vazhdojnë edhe në vitet në vazhdim.

29.3.19. Referuar DIPP/2014, në seksionin “Shpenzime të deklarueshme” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për vendosjen e ashensorit spitalor në banesën e tyre për transportin e djalit dhe pajisje për ushtrim në kushte shtëpie, në shumën 1,000,000 lekë, por pa referuar burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

29.3.20. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me praktikën e kompensimit financiar për shpronësimin e truallit të regjistruar në emër të personit të lidhur, në referim të së cilës rezulton se ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, duke përfituar nga buxheti i shtetit kompensim monetar në vlerë të konsiderueshme për një truall, i cili është deklaruar më parë në pronësi të vëllait të saj dhe se ishte paguar prej tij çmimi përkatës. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi të deklarojë mbi destinacionin e shumave të përfituara si rezultat i kompensimit, të tërhequra nga personi i lidhur në “Credins Bank” gjatë viteve 2014 dhe 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

30. Me anë të prapësimeve të depozituara në Komision, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore të datës 26.9.2022, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se sa i përket të ardhurave të siguruara nga buxheti i shtetit, në funksion të kompensimit monetar në vlerë të konsiderueshme të një pasurie truall, vlerëson se ka pasur një perceptim të gabuar nga Komisioni, si në lidhje me titullin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të shpronësuar dhe më pas të kompensuar nga ALUIZNI, ashtu edhe në lidhje me shumën e përfituara nga shpronësimi, kjo pasi:

i) Së pari, Komisioni çmon se duhet të merret në konsideratë fakti se titulli i pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të llojit truall, të shpronësuar, i përkiste formalisht, vetëm bashkëshortit A.M. Duke u qëndruar atyre shpjegimeve që ka dhënë në përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm, rithekson se, nga pikëpamja administrative, sa u përket procedurave të rivlerësimit nga ZVRPP-ja Tiranë dhe atyre të shpronësimit, nga ana e organit

shtetëror të ngarkuar me ligj për kompensimin e pasurive të paluajtshme të shpronësuara, është vepruar vetëm mbi bazën e certifikatës së pasurisë së paluajtshme, duke kompensuar financiarisht vetëm personin potencialisht pronar të ligjshëm të pasurisë së paluajtshme, në rastin konkret, bashkëshortin A.M.

Në rastin konkret, jo vetëm që institucioni shtetëror i ngarkuar me ligj për kompensimin e pasurive të shpronësuara ka vepruar absolutisht në përputhje me ligjin, sa i përket vlerës së pasurisë së paluajtshme të shpronësuar, por ka respektuar në mënyrë korrekte edhe kërkesat e ligjit, sa i përket rrethit të personave të shpronësuar që duhet të kompensoheshin financiarisht, fakt i cili është përcaktuar nominalisht në aktin normativ me karakter individual, vendim nr. ***, datë 16.8.2013, i Këshillit të Ministrave, ku janë shpronësuar 1487 shtetas.

ii) Së dyti, sa i përket vlerës së kompensimit të pasurisë së paluajtshme të shpronësuar, në emër të bashkëshortit A.M, deklaroi se kjo vlerë ka qenë në përputhje të plotë me atë çka përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Në këtë kuptim, sa i përket respektimit të parimit të barazisë para ligjit, i cili qëndron në themel të sistemit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë, ka evidentuar faktin se sikundër rezultoi nga akti nënligjor VKM-ja Nr. 685, datë 16.8.2013, bashkëshorti i saj A.M i listuar me numrin rendor *** nuk ka pasur asnjë qindarkë favorizim nga pikëpamja ekonomike në raport me subjektet e tjera të shpronësuara, të trajtuara me të njëjtin akt nënligjor, sa i përket kompensimit financiar për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të lartpërmendur. Sa i përket mënyrës së vlerësimit dhe asaj çka është disponuar nga ana e organit shtetëror të ngarkuar me ligj për kompensimin financiar të truallit të shpronësuar, akti përkatës administrativ individual, VKM-ja Nr. 685, datë 16.8.2013, rezultoi të jetë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 22.8.2013.

iii) Së treti, lidhur me atë çka është kërkuar nga Komisioni për destinacionin e parave të përfituara nga kompensimi për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, sikundër u citua më lart, ka sqaruar se edhe në përgjigjet formale të dhëna ndaj pyetjeve të mëparshme të bëra nga Komisioni në pyetësorët respektivë ka deklaruar se një pjesë e madhe e të ardhurave kanë shkuar për mbulimin e shpenzimeve për kurimin e djalit, B.M, fakte të cilat janë dokumentuar nga ana e saj në të gjitha deklaratat periodike të të ardhurave dhe detyrimeve pranë ILDKPKI-së. Duke u ndodhur përpara një fatkeqësie të madhe familjare, për shkak të dëmtimit mjaft të rëndë të shëndetit fizik të djalit, deri në pamundësi totale të këtij të fundit për të lëvizur, përballimi i kësaj gjendjeje ka kërkuar gjithnjë shpenzime të mëdha dhe kjo shumë e përftuar nga kompensimi për shpronësimin e një pjese të pasurisë së paluajtshme ka shkuar pikërisht për nevojat e trajtimit të shëndetit dhe jetesës së djalit. Më konkretisht, në funksion të nevojave të rehabilitimit fizik dhe trajtimit shëndetësor të djalit B.M, janë kryer shpenzime në vlera të konsiderueshme për blerje të pajisjeve për lëvizjen apo spostimin fizikisht të tij. Më konkretisht, nga ana e tyre është mundësuar blerja dhe montimi i një miniashensori në banesë, në shumën 1,000,000 lekë, i deklaruar më parë ky fakt, duke prishur kafazin e shkallëve për të vendosur miniashensorin, një karrocë, një karrel, dy pajisje në funksion të rehabilitimit të djalit, duke përfshirë këtu edhe përditshmërinë e shpenzimeve të domosdoshme për përkujdesjen e shëndetit personal të djalit.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

31. Komisioni, fillimisht, analizoi kuadrin ligjor mbi parashikimet e bëra për kompensimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese pronë private që preken nga ndërtime pa leje, kjo me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së kompensimit financiar të kryer në favor të personit të lidhur dhe procedurave të ndjekura në këtë funksion.

31.1. Në nenin 1, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, është përcaktuar ndër të tjera se ky ligj ka

për objekt: (1) legalizimin e ndërtimeve informale dhe të objekteve me leje, me shtesa informale në objekt; (2) kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

31.1.1. Ndërsa, në nenin 15 të ligjit të sipërcituar (në fuqi në kohën kur është kryer procedura e kompensimit/shfuqizuar me ligjin nr. 50/2014) përcaktohej se:

“1. Pronat e legalizuara sipas këtij ligji regjistrohen në regjistrat e pronave të paluajtshme në përputhje me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 ‘Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme’. Regjistrimi i pronës bëhet sipas të dhënave që përmban leja e legalizimit që lëshohet sipas nenit 28 të këtij ligji.

2. Në rast se parcela ndërtimore e legalizuar figuron në regjistrat e pronave të paluajtshme në emër të subjekteve private, atëherë me regjistrimin e lejes së legalizimit, subjekti privat i lind e drejta për shpërblim në natyrë ose në lekë.

3. Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, për të gjitha rastet e konstatuara në pikën 2 të këtij neni, i dërgon Këshillit të Ministrave çdo 3 muaj listën e subjekteve fizike ose juridike që shpërblehen sipas këtij ligji, me të dhënat për çdo pronar dhe sipërfaqet takuese. Afati i parë i dorëzimit të listës pranë Këshillit të Ministrave është data 1 dhjetor 2006.

4. Këshilli i Ministrave, brenda 30 ditëve nga afati i dorëzimit të listës nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, merr vendim për shpërblimin e pronarëve dhe sipërfaqet takuese. Komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave në qarqe kompensojnë subjektet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave brenda 3 muajve.

5. Komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave në qark, për efekt të përlllogaritjes së sipërfaqes që kompensohet, e trajton atë si truall në përputhje me metodikën për vlerësimin e pronës së paluajtshme që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim, sipas ligjit 9235, datë 29.7.2004 ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronës’, të ndryshuar”.

31.1.2. Nga ana tjetër, në nenin 16 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, është parashikuar rregullimi specifik për ata që disponojnë parcelën ndërtimore, sipas një akti të ligjshëm të paregjistruar, si vijon:

“1. Nëse subjekti, që disponon objektin pa leje, posedon kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, të lidhur ose të vërtetuar përpara noterit publik, me pronarin e ligjshëm vetë ose nga personi, i cili i ka kaluar të drejtën e pronësisë, pavarësisht nga numri i transaksioneve të kryera, ai i dorëzon ato në zyrën e urbanistikës.

2. Për të gjithë këtë rreth personash që posedojnë këto kontrata, kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore regjistrohet sipas kontratës, duke paguar vetëm tarifën në fuqi për regjistrimin në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pa kamatëvonesë dhe taksa të zbatueshme. Në kuptim të këtij neni, termi “kontratë” i referohet çdo veprimi juridik për kalimin e pasurisë së paluajtshme të njohur nga dispozitat e Kodit Civil në formën e një kontrate të veçantë, përfshirë edhe marrëveshjet e lidhura apo të vërtetuara përpara një noterit publik, me objekt disponime të pronësisë së paluajtshme.

3. Pronari, i cili ka kryer kalimin e parcelës ndërtimore, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, zhvishet nga e drejta e kompensimit të pronës sipas këtij ligji ose sipas ligjit ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronave’”.

31.1.3. Komisioni konstatoi se në datën 21.11.2012, pasuria objekt kompensimi, e llojit “truall” me sipërfaqe 248.2 m² është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në emër të z. A.M, me

nr. pasurie ***. Gjithashtu, rezultoi e provuar se mbi këtë pasuri ka ndërtuar objektin e tij informal (pa leje) shtetasi I.D.

31.1.4. Pasi u administrua nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁸⁵ dosja e legalizimit të objektit informal në emër të shtetasit I.D, Komisioni konstaton se në formularin për vetëdeklarimin “Për legalizimin e objektit” – Shtojca A⁸⁶, datë 13.11.2006, krahas deklarimit të të dhënave të tjera, në rubrikën ku deklarohej prona mbi të cilën është ndërtuar objekti informal ka shënuar “pronë private”. Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes së dërguar nga ASHK-ja nuk u konstatua ndonjë dokument, deklaratë e lëshuar nga personi i lidhur, shtetasi A.M, që të lidhej me truallin mbi të cilin ishte ndërtuar objekti i shtetasit I.D.

31.1.5. Siç u konstatua më sipër, në DIPPF-në e vitit 2012, personi i lidhur ka deklaruar se *i ka dhënë një deklaratë noteriale dhe janë në proces të kalimit të pronësisë për sipërfaqen 275 m². Deri tani ka qenë e pamundur për arsye procedurash. Pra, ai vetë ka 461 m² tokë faktike. Toka është në emrin e tij, sepse në vitin 1998 kunati ka qenë në emigracion dhe nuk vinte dot në Shqipëri. Për sipërfaqen 275 m², kunati ka paguar 1,100,000 lekë të reja. Çmimi për metër katror 4,000 lekë”.*

31.1.6. Në nenin 163 të Kodit Civil përcaktohet se pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Një nga format e fitimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme është ajo me anë të kontratës, përcaktuar në nenin 164 të Kodit Civil. Kontrata është një veprim juridik për kalimin e pronësisë, veprim i cili për të qenë i vlefshëm duhet të bëhet në përputhje me urdhërimet e Kodit Civil, në formën e kërkuar nga ligji.

31.1.7. Format e veprimit juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme përcaktohen në nenet 83, 750 dhe 764 të Kodit Civil. Neni 83 i Kodit Civil përcakton: “*Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm*”. Ndërsa në nenin 750 të Kodit Civil përcaktohet: “*Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme*”. Në nenin 764 të Kodit Civil përcaktohet gjithashtu se: “*Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm*”.

31.1.8. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur me shumicë votash të bëjnë unifikimin e praktikës gjyqësore që konsiston në faktin se për t’u bërë pronar i ligjshëm i një pasurie të paluajtshme mjafton që veprimi juridik për kalimin e pronësisë, pra kontrata të jetë bërë në formën e kërkuar nga ligji, pra me akt noterial, ndërsa mosregjistrimi i saj në ZRPP (zyrën hipotekore) nuk e bën të pavlefshëm veprimin juridik. Më konkretisht, ato arsyetojnë se: “*Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep blerësit mundësinë e tjetërsimit të saj te të tretët⁸⁷ ...”.*

31.1.9. Në këtë këndvështrim, do të lindte diskutim/nevoja për interpretim nëse deklaratat noteriale me përmbajtje pagimin e vlerave monetare për blerjen e një sipërfaqeje trualli, do të përbënin në thelb një nga mënyrat e reja të përfitimit të pasurive të paluajtshme, kjo parë edhe

⁸⁵Shkresë nr. *** prot., datë 15.8.2022, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.8.2022.

⁸⁶Protokolluar me nr. *** prot., në Njësinë e Urbanistikës së Njësisë së Qeverisjes Vendore nr. ***, Tiranë.

⁸⁷Vendimi unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

në kuptim të parashikimeve të bëra në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, në të cilin në nenin 16 të tij përcaktohet se: *“Në kuptim të këtij neni, termi ‘kontratë’ i referohet çdo veprimi juridik për kalimin e pasurisë së paluajtshme të njohur nga dispozitat e Kodit Civil në formën e një kontrate të veçantë, përfshirë edhe marrëveshjet e lidhura apo të vërtetuara përpara një noteri publik, me objekt disponime të pronësisë së paluajtshme”*.

31.1.10. Në vijim të arsytimit, Komisioni vlen të theksojë faktin se krahas mungesës faktike të deklaratës noteriale të pretenduar (mungesës së provës së mundshme) nuk ka informacion mbi objektin konkret të saj, pra nëse ishte deklaruar vetëm kryerja e pagesës, njohja e detyrimit apo edhe e drejta për kalimin e pronësisë së truallit, si dhe nëse kjo deklaratë e pretenduar ka qenë e njëanshme apo e dyanshme, kjo në vlerësim të situatës nëse ajo do të përfshihej si një rast marrëveshjeje e lidhur para noterit publik me objekt mbi disponimin e pronësisë së paluajtshme, në funksion të rregullimeve specifike të bëra në nenin 16 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, mbi bazën e të cilit mund të bëhej kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore.

31.1.11. Parë në këtë këndvështrim, do të ishte për detyrë dhe kompetencë e organeve përkatëse, në këtë rast e ALUIZNI-t, të vlerësohej nëse një dokument i tillë do të mund të shërbente për kalimin e parcelës ndërtimore në pronësi të ndërtuesit informal, duke paguar vetëm tarifën në fuqi për regjistrimin në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme pa kamatëvonesë dhe taksa të zbatueshme. Pra, nëse do të pranohej si i tillë, në këtë rast do të shmangej kompensimi financiar.

31.1.12. Por, në dosjen e legalizimit të objektit informal të shtetasit I.D nuk rezultoi të jetë depozituar ndonjë deklaratë noteriale, nëpërmjet së cilës ai të pretendonte për pagesën e kryer për blerjen e truallit në favor të pronarit të ligjshëm dhe, si rrjedhojë, disponimin e të drejtave të pronësisë mbi të. Nga ana tjetër rezulton se të gjitha veprimet e bëra para organeve shtetërore, me qëllim përfitimin e kompensimit financiar për truallin e “zaptuar” nga shtetasi I.D (vëllai i subjektit) janë kryer nga personi i lidhur, z. A.M, kjo edhe për shkak të faktit se ai figuronte i regjistruar si pronar i vetëm i kësaj pasurie në dokumentet hipotekore.

31.1.13. Gjithashtu rezulton se këto veprime dhe transaksionet në vijim të tyre janë kryer kryesisht në periudhën që subjekti i rivlerësimit ka qenë jashtë shtetit, për shkak të problemeve shëndetësore të djalit (rezulton se për periudhën 24.1.2013 - 30.7.2014, subjekti ka qëndruar në shtetin italian)⁸⁸ dhe në këtë këndvështrim konsiderohet i besueshëm deklarimi i bërë mbi padijeninë e saj në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

31.1.14. Në vijim të arsytimit rezulton se në një situatë hipotetike subjekti i rivlerësimit është vënë përpara faktit të kryer, pra të kryerjes së këtyre veprimeve nga bashkëshorti dhe vëllai i saj, e detyruar ta pranonte këtë situatë, kjo edhe për shkak të situatës emergjente shëndetësore në të cilën ndodhej djali i saj.

31.1.15. Sa më sipër, në kushtet kur rezultoi se të gjitha veprimet e lidhura me transaksionet e kalimit të parcelës ndërtimore dhe kompensimit financiar janë kryer nga personi i lidhur, fakti se nuk u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm paligjshmëria e kryerjes së transaksioneve apo se veprimet e personit të lidhur të jenë kryer në keqbesim, me qëllim përfitimin e paligjshëm, si dhe për sa kohë nuk u provua dijenia e subjektit mbi këto veprime në kohën e kryerjes së tyre, trupi gjykues përfundimisht çmon se në këtë rast nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me probleme të karakterit etik.

⁸⁸Shihni informacionin e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.5.2020.

31.1.16. Trupi gjykues çmon të theksojë se me dërgimin e rezultateve të hetimit nuk u ngritën dyshime mbi trajtim të mundshëm preferencial në përcaktimin e vlerës së kompensimit të truallit, thjesht u konstatua fakti se shuma e përcaktuar për kompensim është në vlerë të konsiderueshme, në kuptimin financiar.

31.1.17. Sa i përket deklarimit të destinacionit të shumave të përfituara nga kompensimi i parcelës ndërtimore, Komisioni gjen bindëse deklarimet e subjektit, kjo në funksion të shpenzimeve të larta, të cilat vlerësohet se nevojiteshin për trajtimin mjekësor të djalit dhe atyre të lidhura me to.

Të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit

31.2. Siç u konstatua më sipër, në deklaratën fillestare të pasurisë (deklarata për vitin 2003) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit A.M, me objekt të veprimtarisë “tregti artikuj industrial dhe ushqimor”, të realizuara në periudhën prill 1994 – korrik 1997.

31.2.1. Ndërsa në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar se si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer edhe të ardhurat në shumën 15,000,000 lekë të realizuara nga ushtrimi i aktivitetit privat i bashkëshortit A.H (M) për periudhën 1994 – 2000 në Tropojë, me aktivitet “tregtim i artikujve ushqimorë dhe industrialë me shumicë dhe pakicë”, për vitet 1994 – 1997, pajisur me kod fiskal nr. *** dhe nr. serial ***. Gjithashtu ka deklaruar se për vitet 1997 – 2001 ka ushtruar aktivitetin e grumbullimit dhe shitjeve të bimëve medicinale.

31.2.2. Për të provuar faktin e ushtrimit të aktivitetit privat të bashkëshortit, subjekti ka depozituar bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës; dhe (ii) vërtetimin nga ISSH-ja për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për shtetasin A.M, që i përket periudhës 1.1.1994 – 1.2.1997.

31.2.3. Referuar shkresës së DRT-ja Kukës rezulton se personi fizik “A.H” ka qenë i regjistruar në Degën e Tatimeve Tropojë për periudhën 9.3.1994 – 3.12.1997, me kod fiskal *** dhe nr. serial *** (pasi për periudhën në fjalë nuk ka funksionuar NIPT-i), me aktivitet “tregtim i artikujve të ndryshëm industrial dhe ushqimorë”, me adresë: lagjja “****”, Bajram Curri. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese, DRT-ja Kukës ka informuar personin e lidhur se dosja e tij si person fizik me emrin “A.H” me të dhënat e saj ndodhet në Agjencinë Tatimore Tropojë me nr. ***, të vitit 1994. Ndërsa, referuar vërtetimit të ISSH-së konstatohet se z. A.M, për vitet 1995 – 1996 dhe muajin janar të vitit 1997, ka deklaruar të ardhura nga paga mbi të cilat ka paguar kontributet, si person i vetëpunësuar.

31.2.4. Gjithashtu, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 27.10.2010, lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, në referim të të cilit konfirmohet se shtetasi A.M.M, lindur më 28.3.1960, banor i kësaj njësie bashkiake, ne nr. identiteti ***, është i njëjti person me shtetasin A.M.H, pasi me vendimin nr. ***, datë 21.4.2000, të Këshillit Bashkiak Tiranë, ka bërë ndryshim mbiemri nga “H” në “M”, me të njëjtat gjeneralitete.

31.2.5. QKB-ja⁸⁹, ndër të tjera, informon se në dosjet e transferuara nga gjykata figuron kërkesa drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për njohjen si person fizik të shtetasit A.M.M, i datëlindjes 1960 (data/muaji i lindjes nuk mund të verifikohen). Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur shkresës së QKB-së rezulton se shtetasi i sipërcituar ka përpiluar një kërkesë (pa datë) drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt

⁸⁹Shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2020, e QKB-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.5.2020.

njohjen e tij si person fizik, shitës në njësinë e shitjes për tregtimin e artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë.

31.2.6. Ndërkohë, referuar shkresës së QKB-së, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së⁹⁰, konfirmohet se shtetasi A.H (datëlindja nuk mund të verifikohet) figuron i regjistruar si person fizik, me vendimin nr. ***, datë 10.3.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për të cilin nuk gjendet NIPT. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar rezulton se vendimin për regjistrimin e këtij personi fizik e ka marrë subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Shefkie Mataj (Demiraj).

31.2.7. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, të administruar në lidhje me aktivitetin tregtar të personit të lidhur, konstatohet se pas komunikimit elektronik të bërë mes ILDKPKI-së dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës⁹¹, kjo e fundit ka konfirmuar se nga të dhënat që disponon Agjencia Tatimore Tropojë (ish-Dega e Tatimeve), si dhe nga verifikimi i bërë nga specialistët e shërbimit për tatimpaguesin në regjistrat e subjekteve ndër vite, rezulton se Personi Fizik “A.M” ka qenë i regjistruar në Degën e Tatimeve Tropojë për periudhën 9.3.1994 – 3.12.1997, me kod fiskal nr. *** dhe nr. serial ***, me aktivitet tregtim i artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë, me adresë: lagjja “****”, Bajram Curri, Tropojë.

31.2.8. Pasi Komisioni kërkoi sërish⁹² të dhëna lidhur me aktivitetin tregtar të personit të lidhur, ku të përfshihej edhe informacioni mbi qarkullimin dhe fitimin *neto* të këtij tatimpaguesi, DRT-ja Kukës informon se⁹³ në arkivin e saj nuk disponon të dhëna për subjektin A.H, me kod fiskal nr. *** dhe nr. serial ***.

31.2.9. Në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *për periudhën 1994 – 1997, bashkëshorti i saj A.M ka tregtuar artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë me shumicë dhe pakicë, market “****” Bajram Curri, Tropojë. Me aktivitetin e tij ka furnizuar edhe Komisariatin e Policisë Tropojë për vitet 1994, 1995 dhe 1996, si dhe Drejtorinë Spitalore Tropojë për periudhën 1995, 1996 dhe 1997. Për këtë periudhë ka fituar afërsisht 15,400,000 lekë. Në verën e vitit 1997 deri në fund të vitit 1999 ka grumbulluar bimë mjekësore dhe ka bashkëpunuar me shoqërinë “****” sh.p.k. në Elbasan, e cila funksiononte si pikë shumice që i përpunonte dhe eksportonte bimët medicinale.*

31.2.10. Krahas dokumenteve të depozituara më parë me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, me qëllim provueshmërinë e zhvillimit të aktivitetit tregtar nga bashkëshorti i saj, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin shtesë si vijon:

i) Kopje të librezës së punës⁹⁴ të bashkëshortit A.M, me nr. *** regjistri themeltar. Referuar këtij dokumenti rezulton se data e fillimit të punës së personit të lidhur/A.M, në njësinë private “****” është shënuar 16.3.1994, ndërsa data e mbylljes së aktivitetit është 4.4.1997 (sipas vendimit të gjykatës).

ii) Deklaratë noteriale⁹⁵ e shtetasit H.M, datë 22.4.2022. Nëpërmjet këtij dokumenti noterial shtetasi H. M ka deklaruar se *në vitin 1996 deri nga mesi i vitit 1997 ka punuar në Drejtorinë*

⁹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 17.7.2017, e QKB-së, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹¹Shih *e-mailin* e dërguar nga DRT-ja Kukës, Sektori i Asistencës dhe Shërbimit, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹²Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2022, drejtuar DRT-së Kukës.

⁹³Shkresë nr. *** prot., datë 15.4.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.4.2022.

⁹⁴Vërtetuar njësia e kopjes me origjinalin nr. *** rep., datë 17.10.2016, redaktuar nga noteri publik N.K.

⁹⁵Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.4.2022, redaktuar nga noteri publik E.K.

e Shëndetit Publik Tropojë në pozicionin zëvendës drejtor ekonomik. Kur e ka marrë detyrën në Drejtorinë e Shëndetit Publik Tropojë në këtë pozicion, e ka gjetur të lidhur kontratën mes Drejtorisë së Shëndetit Publik Tropojë me z. A.M (H) si subjekt fizik sipas ligjit “Për shoqëritë tregtare”, me objekt furnizimin e kësaj drejtorie me të gjithë artikujt (sipas tenderit) dhe e ka zbatuar këtë kontratë deri në përfundim të afatit të saj. Shërbimet në furnizime kanë qenë për lloje e artikuj të ndryshëm si: dyshekë, batanije, çarçafë, jastëkë, ushqime dhe mobilie e orendi. Në vitin 1997, kohë kur ishte edhe kryetar i Komisionit të tenderimeve, në dijeninë e tij është bërë tenderi përkatës dhe është shpallur fitues subjekti juridik A.M për të gjitha furnizimet për Drejtorinë e Shëndetit Publik, përjashtuar produktet e mishit dhe bukën. Në atë periudhë në Tropojë, z. A.M tregtonte artikuj ushqimorë dhe industrialë, me shumicë dhe pakicë dhe ishte ndër të vetmit tregtues që të gjitha produktet i mbante dhe ruante në frigorifer, ftohës ose ngrirës. Z. A.M, me market “***” kishte siguri në furnizimin dhe ishte korrekt në përmbushjen e detyrimeve sipas kontratës së lidhur midis tij dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik Tropojë, me të gjithë artikujt ushqimorë, industrialë dhe të tjerë artikuj, përveç artikujve ushqimorë “bukë”, që kontraktor sipas tenderit ishte një furrë buke dhe “mish”, që kontraktor sipas tenderit ishte një biznes kasapi. Ky tregtar furnizonte në atë kohë edhe institucione të tjera, siç mund të përmendim Komisariatin e Policisë Tropojë. Të gjitha likuidimet i kanë bërë nëpërmjet bankës. Nuk mund të përcaktonte xhiron reale, por saktëson se market “***” ka furnizuar Drejtorinë e Shëndetit Publik Tropojë dhe nëpërmjet saj edhe spitalin D, spitalin Tropojë.

Bashkëlidhur kësaj deklaratë është depozituar edhe kopje e librezës së punës⁹⁶ e shtetasit H.M, me nr. regjistri themeltar ***, nga ku rezulton se në datën 2.7.1996 ky shtetas ka filluar punën si zëvendës drejtor ekonomik në Drejtorinë e Shëndetit Publik Tropojë dhe se në datën 1.4.1997 është transferuar në detyrë tjetër.

iii) Deklaratë noteriale⁹⁷ datë 28.4.2022, e shtetasit B.H. Nëpërmjet këtij dokumenti noterial, shtetasi B.H ka deklaruar se ka qenë në marrëdhënie pune pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë nga data 1.3.1993 deri më 1.5.1998, i titulluar “oficer”, me detyrë shef finance. Në vitet 1994 – 1996, Komisarati i Policisë Tropojë ka pasur kontratë furnizimi për ushqime të ndryshme me firmën market “***” me administrator A.M(H). Furnizimet kanë qenë të llojeve të ndryshme, ushqimore dhe miell për postat kufitare. Z. A.M (H) kishte siguri në furnizim dhe ishte korrekt në përmbushjen e detyrimeve sipas kontratës së lidhur midis tij dhe Komisarariatit të Policisë Tropojë. Të gjitha likuidimet për furnizimet sipas kontratave për artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe miell janë bërë nëpërmjet Degës së Thesarit dhe Bankës Tropojë. Për sa u përket vlerave të kontratave dhe likuidimeve që janë bërë për llogari të market “***” nuk i kujtohen shumat përkatëse.

Bashkëlidhur kësaj deklaratë është depozituar edhe kopja e librezës së punës⁹⁸ e shtetasit B.H, me nr. regjistri themeltar ***, nga ku duket se në periudhën 1.3.1993 – 1.5.1998 ky shtetas ka qenë me detyrë oficer – shef finance në Komisariatin e Policisë Tropojë.

iv) Shkresë e datës 29.4.2022 e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Tropojë⁹⁹. Referuar kësaj shkresë rezulton se pas kërkesës së bërë nga personi i lidhur/A.M, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tropojë ka informuar se për tenderin “Për furnizimin e Drejtorisë së Shëndetit Publik Tropojë për artikujt: dyshekë, jastëkë, çarçafë, këllëfë për jastëkë, batanije, artikuj industrialë të ndryshëm, si dhe artikuj të ndryshëm ushqimorë”, nga verifikimi që kanë bërë në arkivin e

⁹⁶Vërtetuar njësia e kopjes me origjinalin nr. *** rep., datë 6.5.2022, redaktuar nga noteri publik B.S.

⁹⁷Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.4.2022, redaktuar nga noteri publik E.D - L.

⁹⁸Njësuar me origjinalin nga ISSH-ja, Dega Rajonale Tropojë.

⁹⁹Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.4.2022.

spitalit nuk gjenden të dhëna të asaj periudhe, pasi gjatë trazirave të vitit 1997 arkivi është dëmtuar dhe disa dokumente janë djegur.

v) Shkresë e datës 4.5.2022 e Komisarariatit të Policisë Tropojë¹⁰⁰

Referuar kësaj shkrese rezulton se pas kërkesës së bërë nga personi i lidhur/A.M, Komisarati i Policisë Tropojë e ka vënë në dijeni se pas verifikimeve të bëra në arkivin që disponon rezulton se dokumentacioni financiar dhe juridik për të dhënat e kërkuara për njësinë ekonomike “****”, për artikuj ushqimorë dhe industrialë me shumicë dhe pakicë për vitet 1993 – 1997, kod fiskal *** dhe nr. serial *** nuk rezultojnë të jenë. Kjo për arsye se përgjatë trazirave të vitit 1996 - 1997, Komisarati i Policisë Tropojë është djegur plotësisht, duke humbur edhe arkivin e periudhës në fjalë.

31.2.11. Në vijim të komunikimit të mbajtur me Komisionin, sa u përket të dhënave të kërkuara mbi aktivitetin tregtar të personit të lidhur, Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës¹⁰¹ ka konfirmuar se pas riverifikimit të bërë prej tyre në arkivin e Agjencisë Tatimore Tropojë rezultoi se subjekti “A.M.M (H)” figuron i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës për periudhën 1994 – 1997, me kod fiskal *** dhe nr. serial ***, me nr. dosje ***, të vitit 1994¹⁰². Për sa i përket fitimit *neto* të realizuar nga DRT-ja Kukës informon se në atë periudhë nuk ka pasur deklarime mbi të ardhurat dhe shpenzimet, por janë tatuar me tarifa fikse apo me përqindje xhiroje dhe se është e pamundur prej tyre të përcaktohet saktë fitimi *neto* i realizuar sipas viteve kalendarike.

31.2.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DRT-ja Kukës që i përket dosjes nr. ***, të vitit 1994, për subjektin tregtar “A.M.M (H)”, Person Fizik, nuk konstatohen formularë me të dhëna mbi qarkullimin e realizuar dhe/apo mandatpagesa detyrimesh tatimore të kryera në funksion të qarkullimit, në referim të legjislacionit fiskal të kohës.

31.2.13. Nga ana tjetër konstatohen certifikata regjistrimi në organin tatimor¹⁰³, për vitet 1994, 1995, 1996 dhe 1997, lëshuar në emër të z. A.M.M, për ushtrimin e aktivitetit “tregtim i artikujve të ndryshëm industrialë e ushqimorë”, me adresë ushtrimi në lagjen “****”, Bajram Curri (certifikata të nxjerra për çdo vit, bazuar në kërkesat e bëra nga personi i lidhur).

31.2.14. Gjithashtu, Komisioni konstaton se pjesë e dosjes së këtij subjekti tregtar, dërguar nga DRT-ja Kukës, janë edhe dokumentet: (i) deklaratat e bëra nga shtetasi A.M mbi të punësuarit në këtë njësi tregtare dhe për pagën mujore fikse mbi bazën e së cilës do paguhen kontributet, si dhe vërtetime nga Zyra e Punës Tropojë¹⁰⁴; (ii) mandatpagesa të ndryshme për taksë regjistrimi, taksë pastrimi, tatim ndërtese, taksë pasurie, taksë tabele, për pagesa të kryera ndër vite në favor të Degës së Tatimeve Bajram Curri; (iii) vërtetim datë 9.3.1994 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se z. A.M, me vendimin nr. ***, datë 9.3.1994, është njohur si person fizik privat, si shitës i artikujve të ndryshëm (lëshuar nga gjyqtari i çështjes, z. G.Z); (iv) vendim datë 10.4.1997 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë (gjyqtare F.I), mbi çregjistrimin si person fizik privat të subjektit A.H (M);

¹⁰⁰Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.5.2022.

¹⁰¹Shkresë nr. *** prot., datë 23.5.2022, e DRT-së Kukës, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.5.2022.

¹⁰²DRT-ja Kukës ka informuar Komisionin se shkresa e tyre me nr. *** prot., datë 15.4.2022, është dërguar pa kryer verifikime në Agjencinë Tatimore Tropojë.

¹⁰³Certifikatë regjistrimi në organin tatimor, me kod fiskal *** dhe me nr. serial ***, për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë nga data 15.3.1994 – 31.12.1994; certifikatë regjistrimi në organin tatimor, me kod fiskal *** dhe me nr. serial ***, për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë për periudhën 26.1.1995 – 31.12.1995; certifikatë regjistrimi në organin tatimor, me kod fiskal *** dhe me nr. serial ***, për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë për periudhën 5.2.1996 – 31.12.1996; certifikatë regjistrimi në organin tatimor, me kod fiskal *** dhe me nr. serial ***, për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë për periudhën 24.1.1997 – 31.12.1997.

¹⁰⁴Vërtetimet e datave 15.1.1995 dhe 2.2.1996 dhe i vitit 1997 të Zyrës së Punës Tropojë.

(v) vendim¹⁰⁵ datë 3.12.1997 i Degës së Tatim Taksave Tropojë, për çregjistrimin e Personit Fizik “A.M.M (H)”, nga verifikimi i të cilit Komisioni vëren se në përmbajtje të këtij dokumenti referohet fakti se vendimi i marrë nga kryetari i Degës së Tatimeve është bazuar edhe në procesverbalin e paraqitur nga inspektori përkatës i sektorit të pranimit për rakordimin e detyrimeve tatimore deri në datën e këtij vendimi; (vi) vërtetime nga Bashkia Tropojë¹⁰⁶ për shlyerjen e detyrimeve (taksave) nga subjekti A.H (M); (vii) vërtetim nga Zyra e Kontrollit dhe Kalibrimit të mjeteve matëse të Rrethit Tropojë, datë 90.1.1997, ku vërtetohet se z. A.M, pronar i njësisë private ushqimore, ka kryer regjistrimin dhe verifikimin e mjeteve matëse që përdor në aktivitetin e tij privat; (viii) vërtetim i filialit elektrik, dega e shitjes Bajram Curri, datë 20.1.1997, ku vërtetohet se z. A.M është i rregullt në likuidimin e energjisë elektrike; (ix) vërtetim nga Banka e Kursimeve, Agjencia nr. ***, Bajram Curri, nëpërmjet të cilit konfirmohet se shtetasi A.M ka numër llogarie pranë kësaj banke dhe se për vitin 1996 ka pasur veprime bankare.

31.2.15. Në vijim të komunikimit me Komisionin¹⁰⁷, subjekti ka depozituar si provë të re shkresën “kthim përgjigje” të DRT-së Kukës¹⁰⁸, të datës 23.5.2022, nga verifikimi dhe analizimi i së cilës rezulton se është dhënë i njëjti informacion dhe është bashkëlidhur i njëjti dokumentacion, të cilin DRT-ja Kukës e ka vënë në dispozicion Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.5.2022, referuar si më sipër.

31.2.16. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ rezulton se për periudhën mars 1994 – prill 1997 bashkëshorti i subjektit ka ushtruar aktivitetin e tij tregtar si person fizik në Bajram Curri, Tropojë. Por, Komisioni konstatoi se nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e deklaruara si të realizuara nga ushtrimi i aktivitetit privat të personit të lidhur të ardhura, të cilat janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

31.2.17. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë¹⁰⁹, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 2,483,250 lekë për blerjen në datën 31.7.1998 të pasurisë së llojit “truall”, në Tiranë, si dhe për kryerjen e investimeve në objektin 3 kate+ papafingo për periudhën deri më 31.12.2003, si dhe për vitet 2004 – 2012, të pasqyruar në tabelën në vijim.

¹⁰⁵Vendimi nr. *** prot., datë 3.12.1997, i Degës së Tatimeve Tropojë.

¹⁰⁶Vërtetimet e datave 5.2.1996 dhe 20.1.1997 të Bashkisë Tropojë.

¹⁰⁷ Shpjegimet shtesë në lidhje me pyetëtorin nr. ***, dërguar në rrugë elektronike me *e-malin* e datës 31.5.2022, si dhe dokumentacioni mbështetës, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 31.5.2022.

¹⁰⁸Shkresë nr. *** prot., datë 23.5.2022, e DRT-së Kukës.

¹⁰⁹Në kushtet kur Komisioni analizoi më vete të ardhurat e deklaruara si burim për kontributin në vlerën 5 milionë lekë që i takon pjesës takuese të investimit të kryer nga vëllai i bashkëshortit dhe familjarët e tij në pasurinë objekt vlerësimi, në këtë analizë financiare është shënuar vlera e plotë e investimit në shumën prej rreth 20 milionë lekësh, por duke reflektuar në rubrikën përkatëse të ardhurat e deklaruara nga familja e vëllait të bashkëshortit si të shpenzuara për godinën objekt vlerësimi, kjo për efekt përlllogaritjeje të mundësisë së investimit për pjesën e mbetur të kontributit të deklaruar në shumën prej 15 milionë lekësh.

Tabela nr. 2

| | Periudha 31.07.1992 - 31.07.1998 | 1992-2003 | 2007 | 2008 | 2009 | 2011 |
|--|-------------------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| A) PASURI | 3,083,250 | 12,083,250 | 1,012,982 | 2,139,768 | 1,769,280 | 2,257,745 |
| Blerje apartamenti të përshtatur në njësi tregtare 73 m2, në Bajram Curri. | 600,000 | 600,000 | | | | |
| Truall në Tiranë, *** | 2,483,250 | 2,483,250 | | | | |
| Shtëpi banimi tre kate + papafingo e ndërtuar në vitet 1998-2012 Truall më sipërfaqe 709.5 m2. | | 9,000,000 | 600,000 | 368,500 | 2,460,500 | 1,913,600 |
| Automjeti ***, blerë në datë 03.10.2008. | | | | 500,000 | | |
| Ndryshim likuiditeti | 0 | 0 | 412,982 | 1,271,268 | -691,220 | 344,145 |
| B) DETYRIME | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| C) PASURI NETO (A-B) | 3,083,250 | 12,083,250 | 1,012,982 | 2,139,768 | 1,769,280 | 2,257,745 |
| D) TË ARDHURA | 1,262,543 | 5,727,945 | 1,703,924 | 2,598,982 | 2,649,890 | 2,766,485 |
| Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar bashkëshorti në Bajram Curri | 0 | 0 | | | | |
| Të ardhura nga paga si i vetpunësuar, b/shorti subjektit | 91,030 | 91,030 | | | | |
| Të ardhura nga vëllai /familja e vëllait të bashkëshortit të subjektit | | 600,000 | | 368,500 | 460,500 | 513,600 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,171,513 | 4,036,915 | 797,160 | 815,784 | 1,045,153 | 1,067,319 |
| Të ardhura nga paga bashkëshorti i subjektit | | - | 808,281 | 1,293,198 | 1,020,037 | 1,061,366 |
| Të ardhura si Këshilltar njësia Bashkiake nr.*** bashkëshorti i subjektit | | - | 98,483 | 121,500 | 124,200 | 124,200 |
| Të ardhura nga shitja e apartamentit të përshtatur në njësi tregtare 73 m2, në Bajram Curri. | | 200,000 | | | | |
| Të ardhura nga shitja e apartament banimi 3+1 në Bajram Curri me sip 96 m2. Shitur në dt 06.12.2001. | | 800,000 | | | | |
| E) SHPENZIME | 833,278 | 3,288,953 | 848,755 | 854,436 | 979,405 | 940,718 |
| Shpenzime jetike | 833,278 | 2,879,453 | 546,480 | 546,480 | 546,480 | 546,480 |
| Shpenzime mobilimi | | 409,500 | | | 90,000 | 137,000 |
| Shpenzime për arsimin e fëmijëve | | | 302,275 | 307,956 | 342,925 | |
| Shpenzime udhëtimi jashtë vendit | | | | | | 257,238 |
| Balanca e fondeve (D-C-E) | -2,653,985 | -9,644,258 | -157,813 | -395,222 | -98,795 | -431,978 |

31.2.18. Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 31.7.1998, për blerjen e truallit në Tiranë, si dhe investimet dhe shpenzimet e kryera për ndërtimin e pasurisë objekt vlerësimi, për periudhën deri në datën 31.12.2003 dhe për vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2011.

31.2.19. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të paraqesë argumentet/shpjegimet përfundimtare, si dhe të depozitonte prova të reja të mundshme për të dokumentuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur në Bajram Curri, Tropojë, si dhe mbi konstatimet e mësipërme që lidhen me pamundësinë financiare për të justifikuar krijimin e pasurive.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

32. Komisioni vëren se për shkak se pamundësia financiare e konstatuar në krijimin e dy pasurive lidhet kryesisht me dokumentimin e të ardhurave të deklaruara dhe të pretenduara si të realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit në qytetin e Bajram Currit, me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit u fokusua në parashtrimin e rrethanave dhe fakteve mbi kryerjen e aktivitetit tregtar nga bashkëshorti i saj, si dhe provueshmërinë e të ardhurave të përfituara nga ky aktivitet.

32.1. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë argumentet e saj, si dhe ka depozituar prova të reja shtesë, me qëllim kundërshtimin e rezultateve të hetimit që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi, të paraqitura në mënyrë të përmblëdhur si vijon:

32.2. Duke pasqyruar vendime të tjera të marra nga organet e rivlerësimit, subjekti referon se Komisioni dhe Kolegji zbatojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, lidhur me fuqinë provuese të provave shkresore. Kështu, pas analizimit të kuadrit ligjor, subjekti argumenton se fuqia e provave shkresore përcaktohet drejtpërdrejt nga ligji që është Kodi i Procedurës Civile dhe se ndryshe nga proceset e tjera si p.sh., procesi penal, në procesin civil dhe administrativ fuqia shkresore përcaktohet drejtpërdrejt nga ligji dhe nuk është lënë në

diskrecionin e Komisionit apo të Kolegjit. Një provë shkresore mund të kundërshtohet nëse ajo është e falsifikuar. Në këtë kuadër, referon se ka fuqi të plotë provuese shkresa e dërguar nga DRT-ja Kukës ku, ndër të tjera, citohet se *për sa i përket fitimit neto të realizuar nga subjekti në atë periudhë, nuk ka pasur deklarime të ardhurash dhe shpenzimesh, por ato janë tatuar me tarifa fikse apo me përqindje xhiroje dhe është e pamundur të përcaktohet saktë fitimi neto i realizuar sipas viteve kalendarike.*

32.3. Subjekti arsyeton se fakti që legjislacioni i kohës nuk parashikonte deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por vetëm pagimin e një tarife fikse që të mundësohej nga organet tatimore përlllogaritja e fitimit *neto*, është një fakt juridik që nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi atë si subjekt rivlerësimi. Sipas saj, ky qëndrim është mbajtur në një rast të ngjashëm me vendimin nr. 6 (JR), datë 17.3.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin H. K.

32.4. Megjithatë, në vijim të prapësimeve të saj, subjekti parashtron se fakti që bashkëshorti i saj ka realizuar të ardhura të ligjshme nga aktiviteti dhe që ka pasur një xhiro në ngritje provohet me këto prova: (i) deklaratë noteriale e shtetasit H.M; (ii) deklaratë noteriale e shtetasit B.H. Në rastin konkret, subjekti arsyeton se deklaratat noteriale nëpërmjet të cilave kanë dhënë deklarime shtetasit H.M dhe B.H, të bëra para noterit, janë akte zyrtare dhe përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tij.

32.5. Në vijim, subjekti argumenton se është provuar me dokumentacion se bashkëshorti ka ushtruar aktivitete për periudhën 9.3.1994 – 10.4.1997, kur ai ka kërkuar në gjykatë mbylljen e aktivitetit të tij, veprim ky i kryer për shkak të situatës shumë të rëndë që ishte krijuar në Bajram Curri. Ndërkohë pretendon se meqenëse dyqani kishte inventar të trashëguar nga periudhat e mëparshme, bashkëshorti ka vijuar përpjekjet e tij për të shitur mallin, kështu që në fakt të ardhurat janë marrë deri në fund të vitit 1997. Pasi malli që kishte gjendje në dyqan u shit pothuaj përfundimisht, bashkëshorti kërkoi që t'i bëhej edhe auditimi i fundit nga zyra e tatim taksave, veprim ky i materializuar me shkresën nr. *** prot., datë 3.12.1997 “vendim çregjistrimi i personit fizik” nga DRT-ja Tropojë, sipas të cilit është vendosur të kryhet çregjistrimi i Personit Fizik “A.M”, bazuar në vendimin nr. *** prot., datë 10.4.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe pas rakordimit të detyrimeve tatimore deri në datën e këtij vendimi.

32.6. Subjekti ka shpjeguar se në cilësinë e Personit Fizik, bashkëshorti i saj nuk ka ruajtur dhe nuk disponon dokumentacion në lidhje me të ardhurat konkrete të fituara apo tatimet e paguara për disa arsye, të cilat listohen si vijon:

i) Së pari, për shkak të kohës shumë të gjatë që ka kaluar (mbi 25 vjet) do të kishte qenë praktikisht e pamundur ruajtja e tyre. Gjithashtu, ajo deklaroi se ka bërë përpjekje si subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 ose 6 vjet më vonë nga mbyllja e aktivitetit të bashkëshortit, çka e ka bërë të pamundur që të mendonte se këto dokumente do t'i nevojiteshin apo t'i kërkoheshin një ditë.

ii) Së dyti, familja e saj u largua në Tiranë në gusht 1998, veprim të cilin nuk e kishin planifikuar asnjëherë më parë. Kështu, ikja e bashkëshortit dhe e dy fëmijëve ka qenë jo vetëm e paplanifikuar, por nën një presion psikologjik të jashtëzakonshëm nga situata e krijuar. Në këto rrethana mbajtja, marrja me vete në Tiranë apo ruajtja e dokumenteve nuk ka qenë prioritet i tyre në atë moment. Për më tepër, subjekti argumenton se bashkëshorti nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për t'i ruajtur këto dokumente për një kohë kaq të gjatë. Asnjë institucion shtetëror nuk i ka kërkuar dhe nuk e ka detyruar atë t'i mbante dhe t'i ruante dokumentet e kësaj periudhe të largët. Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 8 parashikon se afati maksimal i ruajtjes së dokumentacionit nga subjektet tregtare është maksimumi 10 vjet. Nga ana tjetër, sjell në vëmendje të Komisionit se bashkëshorti vetë ka

qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së për herë të parë në vitin 2012, si nëpunës në Ministrinë e Financave, pra 13 vjet pas mbylljes së aktivitetit e tij në Bajram Curri në vitin 1997. Është e provuar se edhe ILDKPKI-ja (institucion i ngarkuar me ligj) nuk i ka kërkuar dokumente mbi të ardhura konkrete nga biznesi i tij, as në vitin 2012 dhe as në vitet në vijim kur bashkëshorti vazhdonte të deklaronte pasurinë për shkak të detyrës si funksionar publik, që do të thotë se as subjekti nuk do të gjendej në këtë situatë.

iii) Së treti, për shkak se bashkëshorti nuk dispononte dokumentacion për të vërtetuar para Komisionit shuma konkrete të xhiros ose fitimit nga dyqani gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit, ai i është drejtuar dy herë DRT-së Kukës, e cila tashmë mbulon edhe Rrethin e Tropojës. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2022, dërguar Komisionit, DRT-ja Kukës ka konfirmuar se shtetasi A.M figuron i regjistruar pranë kësaj drejtorie tatimore dhe ka paguar detyrimet ndaj shtetit por, *për sa i përket fitimit neto të realizuar në atë periudhë nuk ka pasur deklarime mbi të ardhurat dhe shpenzimet, por janë tatuar me tarifa fikse apo me përqindje xhiroje dhe se është e pamundur nga ana e tyre të përcaktohet saktë fitimi neto i realizuar sipas viteve kalendarike*. Kjo shkresë nuk informon pra, as për xhiron, fitimin apo tatimin e paguar, nga ku mund të llogaritej xhiroja.

iv) Së katërti, përpjekjet e bashkëshortit për të siguruar dokumentacion provues kanë vazhduar edhe me institucione të tjera. Duke marrë parasysh se ai ka bashkëpunuar në mënyrë vijuese me dy institucione në Tropojë dhe pikërisht Drejtorinë e Shëndetit Publik (dhe nëpërmjet kësaj furnizonte me mallra spitalin e qytetit Bajram Curri, spitalin D, spitalin Tropojë dhe të gjitha qendrat shëndetësore të Rrethit Tropojë), si dhe me Komisariatit e Policisë Tropojë, ai iu është drejtuar këtyre institucioneve, duke kërkuar çdo dokumentacion të mundshëm për marrëdhënien e Personit Fizik “A.M” me këto institucione. Në vijim të përpjekjeve të tij, meqenëse pagesat prej këtyre institucioneve ndaj subjektit A.M janë bërë nëpërmjet Bankës së Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), bashkëshorti i është drejtuar “Raiffeisen Bank”, duke i kërkuar informacion për veprime të llogarisë së Personit Fizik gjatë viteve 1994 – 1997. Subjekti thekson faktin se me shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2022, përcjellë Komisionit nga DRT-ja Kukës rezulton të ketë një vërtetim të datës 21.1.1996 nga Banka e Kursimeve, dega Tropojë, i cili vërteton se *z. A.M ka numër llogarie pranë bankës dhe për vitin 1996 ka pasur veprime bankare*.

32.7. Pra, subjekti pretendon se pavarësisht të gjitha përpjekjeve, bashkëshorti u përball me një mungesë të informacionit, sikurse edhe vetë Komisioni në hetimet e tij duke u gjendur kështu në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar me dokumentacion shuma konkrete të ardhurash nga aktiviteti i tij.

32.8. Prandaj, pas ezaurimit të të gjitha hapave, veprimeve dhe dokumentacionit të mundshëm të mbledhur prej tyre, përveç deklarimeve që i ka dorëzuar në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka depozituar si provë të re, konkretisht, aktekspertimin privat, të përgatitur nga eksperti fiskal z. A.Ç, i cili është i regjistruar në regjistrin e ekspertëve fiskalë me nr. ***, datë 8.6.2015, provuar ky fakt nga certifikata e datës 8.6.2015, lëshuar nga Instituti i Ekspertëve Fiskalë.

32.9. Subjekti ka parashtruar se ky ekspert, pasi ka përgatitur metodat alternative për përlllogaritjen e fitimit, arrin në këto përfundime. Nga përlllogaritjet e kryera në këtë akt është provuar se sa ka qenë qarkullimi dhe fitimi për vitet 1994 – 1997, për subjektin tregtar “A.M”, sikurse është treguar në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3

| Vitet | Xhiroja vjetore | Fitimi bruto vjetor (marzhi 20%) | Shpenzime vjetore | Fitimi neto | Progressive |
|---------------|-----------------|----------------------------------|-------------------|-------------|-------------|
| Nga Mars 1994 | 21,375,000 | 4,275,000 | 1,275,000 | 3,000,000 | 3,000,000 |
| 1995 | 26,000,000 | 5,200,000 | 1,300,000 | 3,900,000 | 6,900,000 |
| 1996 | 30,000,000 | 6,000,000 | 1,500,000 | 4,500,000 | 11,400,000 |
| 1997 | 27,000,000 | 5,400,000 | 1,400,000 | 4,000,000 | 15,400,000 |

32.10. Në rrethanat e prezantuara më lart dhe nga hetimi i kryer nga Komisioni, subjekti pretendon se duket qartazi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sikurse përcaktohet nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të vënë në dispozicion informacionin mbi të dhëna konkrete financiare të Personit Fizik “A.M” për periudhën mars 1994 – dhjetor të vitit 1997.

32.11. Subjekti deklaron se gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë këtyre parashtrimeve, ka provuar se organi përgjegjës tatimor, institucionet shtetërore të cilat i ka pasur klientë, Banka e Kursimeve (atëherë bankë shtetërore), të cilat janë organet kompetente ligjzbatuese (rasti i DRT-së Kukës) dhe që administrojnë dokumentacionin, si dhe kanë detyrimin ligjor të ruajtjes së tij, kanë pranuar në formë shkresore mungesën e plotë apo pjesore dhe pamundësinë e vënies në dispozicion të këtij informacioni për shkaqe objektive dhe konkretisht:

a) Pamundësinë e informimit për shumën konkrete të të ardhurave nga biznesi i bashkëshortit (sipas shkresës së DRT-së Kukës), e cila bashkëlidhur ka përcjellë ato dokumente që kjo drejtori ka disponuar, asnjë prej të cilave nuk provon shumën e të ardhurave të përfituara dhe/ose shumën e tatimeve të paguara, në mënyrë që të mund të përlllogaritej xhiroja vjetore. Pra, DRT-ja Kukës nuk ka të dhëna që tregojnë shumat e xhirove dhe fitimit të realizuar dhe shprehet se *është e pamundur t’i përlllogarisë ato*.

b) Pamundësinë e informimit të faturave të paguara/xhiros së realizuar të Personit Fizik “A.H” me dy institucionet shtetërore në Tropojë, për shkak të situatës së krijuar në vitin 1997, sikurse informojnë të dyja në shkresat përkatëse të referuara më sipër.

32.12. Subjekti referon se çështja e pamundësisë objektive është trajtuar dhe pranuar në vendime të mëparshme të organeve të *vettingut* dhe, konkretisht, sipas saj në një rast identik, Kolegji i Posaçëm i Apelit është mbështetur vetëm në aktekspertimin privat për përlllogaritjen e të ardhurave, ku ato kanë qenë në nivelin deklarativ, për rrjedhojë i ka bërë pjesë në analizën financiare¹¹⁰.

32.13. Në lidhje me legjitimitetin e këtyre të ardhurave, subjekti deklaron se bashkëshorti i saj i ka paguar të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit, fakt i cili vërtetohet me disa dokumente që janë vënë në dispozicion nga DRT-ja Kukës, të cilat gjithashtu janë cituar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ.

¹¹⁰I referohet vendimit nr. 20 (JR), datë 14.6.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

32.14. Sa më sipër, subjekti ka kërkuar që mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, arsyetimin e bërë me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe mbështetur në “aktekspertimin privat”, të depozituar si provë të re, të përfshihen në analizën financiare të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga aktiviteti “shitje artikujsh të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë”, market “****”, Person Fizik, për periudhën mars 1994 – dhjetor 1997.

32.15. Gjithashtu, nëpërmjet prapësimeve të depozituara në Komision, subjekti ka ngritur pretendime mbi rezultatet e analizës financiare që i përkasin viteve 2007, 2008 dhe 2011, nga ku konstatohet se për vitet 2007 dhe 2008 kërkon përfshirjen në rubrikën e të ardhurave të dietave të përfituara nga personi i lidhur, ndërsa për vitin 2011 ka kërkuar reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, pasi pretendon se ato janë kryer në vitin 2012.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

33. Në përmbledhje të prapësimeve të bëra nga subjekti, Komisioni vëren se sa i përket të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit ka ngritur dhe ka parashtruar argumentet dhe pretendimet se: (a) provohet zhvillimi i aktivitetit tregtar dhe ligjshmëria e të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet; (b) ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive (neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016) për të siguruar informacion mbi të ardhurat dhe fitimin e realizuar nga ky aktivitet; dhe (c) të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar të reflektohen sipas aktekspertimit, të përgatitur nga eksperti A. Ç.

33.1. Komisioni vlen të theksojë faktin se me dërgimin e rezultateve të hetimit është vënë në dijeni subjekti se në vlerësim të dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit rezulton e provuar se për periudhën mars 1994 – prill 1997, bashkëshorti i saj ka ushtruar aktivitet tregtar si person fizik, në Bajram Curri, Tropojë.

33.1.1. Në këtë këndvështrim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dokumentuar të ardhurat *neto* të fituara nga realizimi i këtij aktiviteti.

33.1.2. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive në sigurimin e këtij informacioni dhe ka depozituar si provë të re aktekspertimin financiar të punuar nga eksperti A.Ç, i cili rezulton se mbështetet tërësisht në deklaratimet e saj dhe/apo personit të lidhur mbi të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet. Në këtë kuadër, së pari, trupi gjykues duhet të vlerësojë nëse subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pra të pamundësisë objektive për sigurimin e informacionit dhe, nëse vlerëson se ndodhet në këtë situatë, të pasqyrojë me përfaqësi shumë të ardhurave potenciale, të cilat mund të jenë realizuar nga zhvillimi i këtij aktiviteti.

33.1.3. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacion mbi të ardhurat e realizuara nga zhvillimi i aktivitetit tregtar të bashkëshortit të saj për vitet 1994 – 1997, në qytetin e Bajram Currit, por se nuk ka mundur të disponojë të dhëna konkrete për shkak të informacionit të cunguar të dërguar nga DRT-ja Kukës. Gjithashtu rezulton se subjekti ka bërë përpjekje për të siguruar informacion edhe nga institucione të tjera, me të cilat pretendon se bashkëshorti i saj ka pasur marrëdhënie financiare në funksion të zhvillimit të aktivitetit tregtar.

33.1.4. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar pretendimi i bërë nga subjekti se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, për periudhën e sipërcituar, duke sjellë si pasojë aplikimin në këtë rast të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.*

Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

33.1.5. Si rrjedhim, Komisionit i lind detyra të verifikojë dhe analizojë pretendimet e bëra nga subjekti mbi shumën e të ardhurave të fituara nga ky aktivitet në raport dhe harmoni me provat e depozituara, legjislacionin fiskal, si dhe realitetin social - ekonomik të kohës.

33.1.6. Në përputhje me nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni e bazon vendimin e tij vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Anëtarët e trupit gjykues të Komisionit kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. Në këtë këndvështrim, vendimmarrja e Komisionit bazohet në tri elemente: (i) vërtetësinë e provave; (ii) mjaftueshmërinë e provave; dhe (iii) bindjen e brendshme.

33.1.7. Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se trupi gjykues administroi në cilësinë e provës aktekspertimin e përgatitur nga eksperti fiskal A.Ç, duke e vlerësuar në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë procesit dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, sa i përket të ardhurave të përfituara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të saj.

33.1.8. Referuar legjislacionit të kohës¹¹¹ rezulton se nuk është e qartë ndarja e bizneseve dhe përgjegjësia tatimore e tyre. Në dukje përgjegjësia tatimore përcaktohej nga statusi i regjistrimit si person fizik apo juridik dhe, në këtë kuptim, rezulton se personat fizikë trajtoheshin nga ligji nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” (shfuqizuar me ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”), pavarësisht qarkullimit të kryer prej tyre.

33.1.9. Vetëm me Dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 1486, datë 6.5.1996, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, neni 1 i ligjit nr. 7679/1993 ndryshon si vijon: “*Të gjithë personat fizikë e juridikë që kryejnë apo do të kryejnë një qarkullim më të vogël se 2,000,000 lekë në një vit kalendarik dhe që nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen tatimit mbi biznesin e vogël*”.

33.1.10. Gjithsesi, në vijim të arsyetimit, Komisioni konstaton se ligji i sipërcituar nuk parashikonte deklarin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por nga ana tjetër përcaktonte pagesën e tatimit bazuar në qarkullimin dhe jo pagimin e një tarife fikse, sikurse pretendon subjekti. Kështu, nëse DRT-ja Kukës do të dispononte të dhëna mbi tatimin e paguar nga personi fizik A.M, Komisioni, bazuar në legjislacionin në fuqi, do të arrinte të përlllogariste qarkullimin e realizuar dhe, bazuar në një normë fitimi të pranueshme, do të nxirrte edhe konkluzione të përafërta mbi fitimin *neto* të realizuar nga ky subjekt tregtar.

33.1.11. Sa u përket pretendimeve mbi qarkullimin dhe fitimin e realizuar të deklaruar më parë nga subjekti dhe të mbështetura nga aktekspertimi i përpiluar nga z. A. Ç, Komisioni çmon se ato nuk i përgjigjen realitetit social - ekonomik të kohës. Në këtë kuptim, rezulton i vështirë realizimi i një qarkullimi prej rreth 104,000,000 lekësh, për një periudhë 4-vjeçare nga zhvillimi i këtij aktiviteti tregtar në qytetin e Bajram Currit, njësinë e shërbimit me sipërfaqe prej vetëm 32.3 m². Gjithashtu, Komisioni vëren se aktekspertimi i z. A. Ç bazohet tërësisht në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti dhe/apo personi i lidhur. Ai nuk bazohet në legjislacionin e kohës, të dhëna konkrete shkencore, studimore apo dokumentacion mbështetës si fatura tatimore blerje/shitje, kontrata të ndryshme, evidenca e të dhëna të tjera

¹¹¹Shihni ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”; ligjin nr. 7677, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi fitimin”; ligjin nr. 7676, datë 2.3.1993, “Për tatimin mbi qarkullimin”; ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”; dhe ligjin nr. 7681, datë 4.3.1993, “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”.

mbi qarkullimin. Për më tepër, në këtë akt nuk janë referuar si shpenzime detyrimet e mundshme tatimore, të cilat sipas legjislacionit të kohës do të ishin në përpjesëtim me qarkullimin. Në këtë këndvështrim, Komisioni nuk mund t'i japë fuqi provuese këtij akti, për sa kohë duket se ai mbështetet kryesisht në të dhëna deklarative dhe se nuk i përgjigjet realitetit social - ekonomik të kohës.

33.1.12. Gjithsesi, për një qasje garantuese në kryerjen e analizës financiare, në vlerësimin përfundimtar lidhur me shumën e të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar në qytetin e Bajram Currit, Komisioni do të marrë të mirëqenë se: (i) aktiviteti tregtar është kryer për 4 vite të plota, për periudhën 1994 – 1997; (ii) personi i lidhur ka kryer aktivitet tregtie me pakicë dhe shumicë; dhe se (iii) norma e fitimit ka qenë rreth 15%, kjo në kushtet kur megjithëse në aktekspertim është pretenduar norma e fitimit prej 20%, nga ana tjetër nuk janë pasqyruar/reflektuar shpenzime të kryera për pagesën e tatimit mbi qarkullimin.

33.1.13. Për të verifikuar qarkullimin e mundshëm/të pranueshëm të realizuar nga subjekti tregtar “A.M”, në një vlerësim alternativ dhe sa më objektiv të të gjitha rrethanave të tjera të përfituara gjatë hetimit administrativ, Komisioni iu referua përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ku në germën “gj” të nenit 3 të tij parashikohej se masa e tatimit për tregtarët që bëjnë tregti me shumicë, të çdo lloji, është 6% e të ardhurave, por jo më pak se 50,000 lekë/vit.

33.1.14. Në këtë kuptim, në kushtet kur rezulton se subjekti tregtar “A.M”, Person Fizik, nuk ka pasur detyrime tatimore të papaguara në momentin e çregjistrimit, do të konsiderohet se ai ka paguar minimalisht shumën prej 50,000 lekësh në vit për ushtrimin e aktivitetit të tregtisë me shumicë. Vlerësuar kjo pagesë minimale e detyrueshme në raport me përqindjen e pagesës së tatimit mbi qarkullimin për këtë aktivitet, rezulton se i përgjigjet një qarkullimi vjetor në shumën prej 833,333 lekësh (50,000 lekë përbëjnë 6% të shumës 833,333 lekë). Pra, rezulton se minimalisht subjekti tregtar “A.M” të ketë realizuar në total qarkullimin në shumën rreth 3,333,332 lekë për periudhën 1994 – 1997.

33.1.15. Në vijim të arsyesimit, në kuadër të mbajtjes së një qasjeje sa më garantuese, Komisioni kreu analizimin e rastit hipotetik, sikur subjekti tregtar “A.M” të ketë realizuar 10-fishin e qarkullimit vjetor, për të cilin kishte detyrimin për të paguar tatimin në shumën 50,000 lekë dhe, në këtë kuptim, të ketë paguar 10-fishin e këtij detyrimi minimal tatimor. Në këtë rast, qarkullimi vjetor do të ishte 8,333,333 lekë dhe qarkullimi total për periudhën 4-vjeçare do të ishte në shumën 33,333,332 lekë. Në aplikim të normës së fitimit të pranuar nga Komisioni, fitimi *neto* nga ky aktivitet tregtar për periudhën 1994 – 1997 do të ishte në shumën rreth 5,000,000 lekë.

33.1.16. Bazuar në këtë vlerë hipotetike të ardhurash, të vlerësuar si të përfituar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar i personit të lidhur, në qytetin e Bajram Currit, si dhe në vlerësim të pretendimeve të tjera të ngritura nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit¹¹², Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 2,483,250 lekë për blerjen në datën 31.7.1998 të pasurisë së llojit “truall” në Tiranë dhe për kryerjen e investimeve në objektin 3 kate + papafingo, për periudhën deri më 31.12.2003, si dhe për vitet 2004 – 2012, të pasqyruar në tabelën vijuese.

¹¹²Komisioni reflektoi në analizën financiare të vitit 2011 reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit, duke i pasqyruar me vlerë 0 (zero), pasi rezultoi e provuar se ato janë kryer për vitin 2012. Ndërsa, sa u përket pretendimeve mbi analizën paraprake financiare të viteve 2007 dhe 2008, Komisioni nuk kreu ndryshime, duke arsyetuar se dietat në vetvete janë mbulim i shpenzimeve të kryera më parë.

Tabela nr. 4

| | Periudha 31.07.1992 - 31.07.1998 | 1992-2003 | 2007 | 2008 | 2009 | 2011 |
|--|-------------------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| A) PASURI | 3,083,250 | 12,083,250 | 1,012,982 | 2,139,768 | 1,769,280 | 2,257,745 |
| Blerje apartamenti të përshtatur në njësi tregtare 73 m2, në Bajram Curri. | 600,000 | 600,000 | | | | |
| Truall në Tiranë, ***** | 2,483,250 | 2,483,250 | | | | |
| Shtëpi banimi tre kate + papafingo e ndërtuar në vitet 1998-2012 Truall më sipërfaqe 709.5 m2. | | 9,000,000 | 600,000 | 368,500 | 2,460,500 | 1,913,600 |
| Automjeti ***, blerë në datë 03.10.2008. | | | | 500,000 | | |
| Ndryshim likuiditeti | 0 | 0 | 412,982 | 1,271,268 | -691,220 | 344,145 |
| B) DETYRIME | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| C) PASURI NETO (A-B) | 3,083,250 | 12,083,250 | 1,012,982 | 2,139,768 | 1,769,280 | 2,257,745 |
| D) TË ARDHURA | 6,328,325 | 10,793,727 | 1,703,924 | 2,598,982 | 2,649,890 | 2,766,485 |
| Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar bashkëshorti në Bajram Curri | 5,000,000 | 5,000,000 | | | | |
| Të ardhura nga paga si i vetpunësuar, b/shorti subjektit | 91,030 | 91,030 | | | | |
| Të ardhura nga vëllai /familja e vëllait të bashkëshortit të subjektit | | 600,000 | | 368,500 | 460,500 | 513,600 |
| Të ardhura nga paga subjektit i rivlerësimit | 1,171,513 | 4,036,915 | 797,160 | 815,784 | 1,045,153 | 1,067,319 |
| Të ardhura nga paga bashkëshorti i subjektit | 65,782 | 65,782 | 808,281 | 1,293,198 | 1,020,037 | 1,061,366 |
| Të ardhura si Këshilltar në Bashkiakë nr.*** bashkëshorti i subjektit | | - | 98,483 | 121,500 | 124,200 | 124,200 |
| Të ardhura nga shitja e apartamentit të përshtatur në njësi tregtare 73 m2, në Bajram Curri. | | 200,000 | | | | |
| Të ardhura nga shitja e apartament banimi 3+1 në Bajram Curri me sip 96 m2. Shitur në dt 06.12.2001. | | 800,000 | | | | |
| E) SHPENZIME | 876,695 | 3,332,369 | 848,755 | 854,436 | 979,405 | 683,480 |
| Shpenzime jetike | 876,695 | 2,922,869 | 546,480 | 546,480 | 546,480 | 546,480 |
| Shpenzime mobilimi | | 409,500 | | | 90,000 | 137,000 |
| Shpenzime për arsimin e fëmijëve | | | 302,275 | 307,956 | 342,925 | |
| Shpenzime udhëtimi jashtë vendit | | | | | | |
| Balanca e fondeve (D-C-E) | 2,368,380 | -4,621,892 | -157,813 | -395,222 | -98,795 | -174,740 |

33.1.17. Sa më sipër, edhe me këtë qasje garantuese të mbajtur nga Komisioni, megjithëse rezulton se përmbyset balanca negative e fondeve në momentin e blerjes së truallit, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës takuese në godinën e banimit, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

34. Pasuria e llojit “automjet”, e markës “**”, tip “****”, vit prodhimi 2008, me targa AA***, blerë¹¹³ në datën 10.2.2014, me vlerë 950,000 lekë, në pronësi të bashkëshortit A.M. Pjesa takuese: 50%.**

34.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”, e vitit 2000, me targa TR ***, në vlerën 450,000 lekë; dhe (ii) pjesa tjetër nga kursimet e familjes.

34.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në DIPP/2014, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: (i) shtim i pasurisë së luajtshme që vjen nga blerja e automjetit tip “****”, me targa AA ***, në pronësi të bashkëshortit A.M. Vlera: 900,000 lekë; (ii) pakësim i pasurisë së luajtshme që vjen nga shitja e automjetit tip “****”, me targa TR *** në pronësi të bashkëshortit A.M. Vlera: 450,000 lekë.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

35. DPSHTRR-ja¹¹⁴ konfirmon se bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit A.M ka të regjistruar në emrin e tij automjetin me targa AA ***, të markës “****”, tip “****”, vit prodhimi 2008. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit, pjesë e dosjes së dërguar lidhur me këtë automjet, Komisioni konstaton se:

i) Në datën 13.2.2009 ky automjet me vlerë të deklaruar 28,000 USD, është ngarkuar për transport nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në emër të shtetasit V. M, me vlerë transporti 2,650 USD.

¹¹³Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2014.

¹¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 8.5.2020, e DPSHTRR-së.

ii) Në datën 30.3.2009 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti në Degën Doganore Durrës dhe janë paguar detyrime doganore, në total shumën 727,029 lekë.

iii) Në datën 27.4.2009 ky automjet është regjistruar në pronësi të shtetasit M, me targa TR ***.

iv) Në datën 10.1.2014 automjeti i është shitur shtetasit E.K kundrejt çmimit 950,000 lekë. Po në këtë datë, ky automjet është regjistruar në emër të blerësit dhe ka marrë targat AA ***.

v) Në datën 10.2.2014 shtetasi E.K ia ka shitur këtë automjet personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit), për shumën 950,000 lekë.

vi) Në datën 13.2.2014 personi i lidhur A.M e ka regjistruar këtë automjet në emrin e tij, me targë të re AA ***. Ky automjet vijon të jetë në pronësi të personit të lidhur.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

36. Siç u konstatua më sipër, si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “***”, vit prodhimi 2000, me targa TR***, në shumën 450,000 lekë; dhe (ii) kursimet familjare.

36.1. DPSHTRR-ja¹¹⁵ konfirmon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.M, ka pasur të regjistruar automjetin me të dhënat e mësipërme. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit, pjesë e dosjes së dërguar lidhur me këtë automjet, Komisioni konstaton se:

i) Shtetasi Dh.S ka pasur të regjistruar këtë automjet në pronësi të tij në shtetin italian, me targa ***.

ii) Në datën 2.10.2008 ka kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti në shtetin shqiptar, duke paguar në total detyrime doganore në vlerën 328,272 lekë.

iii) Në datën 3.10.2008 shtetasi Dh.S ia ka shitur këtë automjet personit të lidhur, z. A.M, kundrejt çmimit 500,000 lekë.

iv) Në datën 10.2.2014, bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ia ka shitur¹¹⁶ këtë automjet shtetasit E.K, kundrejt çmimit 450,000 lekë.

36.1.1. Pra, konstatohet se automjeti i markës “***”, vit prodhimi 2000, tip “***”, është shitur në të njëjtën datë në të cilën është blerë nga personi i lidhur pasuria objekt vlerësi, automjeti i markës “***”, tip “***”, vit prodhimi 2008. Gjithashtu rezulton se blerësi i këtij automjeti (“***” me vit prodhimi 2000) është i njëjti person, i cili i ka shitur bashkëshortit të subjektit pasurinë objekt vlerësi (“***” me vit prodhimi 2008).

36.1.2. Komisioni konstaton se në DIPP/2008 subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pasurinë e llojit “automjet” të markës “***”, blerë nga bashkëshorti i saj në datën 3.10.2008. Rezulton se bashkëlidhur DIPP/2008 është dorëzuar formulari që i përket deklaratës së interesave private të personave të lidhur, por se nuk është plotësuar asnjë seksion i tij dhe as nuk ka nënshkrime mbi të.

36.1.3. Nga ana tjetër, konstatohet se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (DIPPF e vitit 2012), në seksionin “Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, z. A.M, në cilësinë e subjektit që mbart detyrimin për deklarim, ka deklaruar pasurinë e llojit “automjet” të markës “***”, vit prodhimi 2000, me vlerë 500,000 lekë, blerë në vitin 2008 me të ardhurat personale.

¹¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 8.5.2020, e DPSHTRR-së.

¹¹⁶Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2014, redaktuar nga noteri publik Sh.Gj.

36.1.4. Në DIPP/2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar pakësimin e kësaj pasurie, nëpërmjet shitjes së automjetit të markës “****” me targa TR***, duke përfituar të ardhura në shumën 450,000 lekë.

36.1.5. Gjithashtu, Komisioni konstaton se në deklaratat e interesave private periodike vjetore, të depozituara në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime lidhur me disponimin e gjendjeve të likuiditeteve *cash*.

36.1.6. Të pyetur nga ILDKPKI-ja,¹¹⁷ subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se gjendja *cash* në datën 31.12.2013 ka qenë 0 (zero) dhe se paratë e kursyera në të gjitha vitet janë investuar në ndërtimin e shtëpisë dhe për kompletimin e saj. Pra, referuar vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në fund të vitit 2013 gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë në vlerën 0 (zero) lekë.

36.1.7. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2014 – 10.2.2014, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 950,000 lekë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, nga ku rezulton se ata nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht: (i) blerjen në datën 10.2.2014 të automjetit të markës “****”, tip “****”, vit prodhimi 2008; (ii) shtesën e likuiditeteve në bankë për periudhën 1.1.2014 – 10.2.2014; si dhe (iii) kryerjen e shpenzimeve të tjera të konstatuara nga Komisioni për këtë periudhë, balanca negative e fondeve rreth 450,000 lekë.

36.1.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitonte prova të reja të mundshme mbi konstatimin e mësipërm, në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

37. Me anë të prapësimeve të depozituara në Komision, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore të datës 26.9.2022, subjekti i rivlerësimit ka dhënë argumentet e saj, si dhe ka depozituar prova të reja shtesë, me qëllim kundërshtimin e rezultateve të hetimit që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

i) Së pari, ka parashtruar se për shkak të problemeve shëndetësore të djalit, gjendjes së rënduar fizike, automjeti, të cilin e kishin në pronësi, nuk ishte më i përshtatshëm për transportin e karrocës, e cila shërbente për lëvizjet e tij për kryerjen e vizitave mjekësore të nevojshme. Në këto kushte, u detyruan që në mënyrë të menjëhershme të shisnin automjetin ekzistues dhe të blinin një automjet të përshtatshëm me portobagazh me hapësirë të madhe.

ii) Së dyti, ka theksuar faktin se shitja dhe blerja e automjeteve është formalizuar me kontrata në të njëjtën datë, me palë të njëjta. Në këtë kontekst ka sqaruar se bashkëshorti i ka dhënë automjetin e parë shtetasit E.K dhe mori automjetin që ai kishte në shitje tek stadiumi “****”, duke rënë dakord për çmimet e blerjes dhe atë të shitjes. Në vijim, ka shpjeguar se, duke qenë se bashkëshorti i saj do të duhej ta regjistronte shumë shpejt automjetin në emër të tij, që të mund të qarkullonte me të, kontratat përkatëse të shitjes dhe blerjes u formalizuan në të njëjtën datë dhe mjetet u këmbyen po atë datë. Ka referuar faktin se bashkëshorti i saj e ka regjistruar mjetin vetëm 3 ditë pas formalizimit të kontratave.

¹¹⁷Dokument i datës 20.2.2015, “Sqarime në lidhje me deklarimin e pasurisë ndër vite sipas kërkesës së inspektores”, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 11.2.2022.

Nisur nga argumentet e parashtruara si më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se në datën e kontratës bashkëshorti i saj nuk ka paguar asnjë shumë financiare, pasi në fakt, ky ka qenë një veprim shkëmbimi mjet me mjet, pavarësisht se në kontratë, si kontratë tip, është shënuar se palët deklarojnë se janë likuiduar totalisht mes tyre.

iii) Së treti, deklaron se si ndërmjetës për këtë marrëdhënie shkëmbimi ka qenë shtetasi I.Z, duke pretenduar se ka qenë pikërisht ky shtetas që ka ndërmjetësuar me shtetasin E.K, duke marrë përsipër rolin e garantit me anë të favorizimit në likuidim për një periudhë 3 deri në 6 muaj të pjesës së mbetur borxh (pa paguar) prej 500,000 lekësh.

Në mbështetje të prapësimeve të saj, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 20.9.2022, të shtetasit I.Z¹¹⁸. Komisioni konstaton se, nëpërmjet këtij dokumenti noterial, shtetasi I.Z ka deklaruar se *ka njohje shoqërore dhe familjare me shtetasin E.K prej vitesh. Shtetasi E.K për vite të tëra ka ushtruar aktivitetin e shitblerjes së makinave në Shqipëri, me vend ushtrimi aktiviteti pranë stadiumit “****”. Ai blinte makina të përdorura jashtë dhe brenda vendit dhe i shiste pasi u bënte shërbimet e duhura. Në fillim të vitit 2014 ka ndërmjetësuar tek E për të ndihmuar një të njohurin e tij të quajtur A.M, i cili kishte djalin e sëmurë rëndë, pas një aksidenti automobilistik të ndodhur në dhjetor 2012. Shtetasi A. M kishte një veturë të markës “****” dhe i duhej një makinë me portobagazh të madh. Për këtë arsye, shoku i tij E.K kishte një fuoristradë tip “****”, “****” të vitit 2008, të blerë në Tiranë dhe i përshtatej shtetasit A.M. Në datën e kontratës shtetasi A.M nuk ka paguar asnjë lekë, pasi në fakt ky ka qenë një veprim shkëmbimi mjet me mjet, pavarësisht se në kontratë, si kontratë tip është shënuar: palët deklarojnë se janë likuiduar totalisht mes tyre. Vetura e A.M u vlerësua 450,000 lekë dhe “****” tip “****” shitej me 950,000 lekë. Pra, diferenca ishte 500,000 lekë që A.M i detyrohej E.K. Z. E. K pranoi të ndihmojë A.M nisur edhe nga halli dhe nga ndërhyrja e tij. Ai u bë garantues dhe ndërmjetës i këtij shkëmbimi dhe favorizimit në likuidim për një periudhë 3 deri në 6 muaj për pjesën e mbetur borxh prej 500,000 lekësh dhe ata kanë vepruar në mirëbesim midis tyre.*

iv) Së fundmi, subjekti pretendon se bashkëshorti i saj diferencën e çmimit të automjetit e ka paguar tek shtetasi E.K në fund të marsit të vitit 2014, pasi atëherë kanë qenë mundësitë e tyre financiare.

Analiza e shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti/vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë pasuri

38. Pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, shqyrtoi parashtrimet, shpjegimet dhe provat e subjektit të paraqitura me shkrim, si dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, Komisioni vëren se mbetet i karakterit deklarativ pretendimi i ngritur nga subjekti se në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka paguar vlerën e plotë të blerjes së kësaj pasurie, në konsideratë edhe të faktit se nuk mbështetet së paku nga pala shitëse.

38.1. Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*. Ndërsa në nenin 660 të Kodit Civil parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*.

38.1.1. Në këtë kuptim, personi i lidhur në bashkëpunim me palën shitëse ka pasur mundësi që të përcaktojë lirshëm përmbajtjen e kësaj kontrate, ku në rast hipotetik mund të nënshkruhej një kontratë e tipit “premtim shitje”, në të cilën mund të referohej edhe detyrimi i mbetur pa u paguar. Në vijim të analizimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni

¹¹⁸Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2022, redaktuar nga noteri publik Sh.Gj.

vlerëson se nuk është kusht ligjor që përdoruesi i automjetit të jetë edhe detyrimisht pronar i tij.

38.1.2. Në analizë të dispozitave të mësipërme, provave të administruara, si dhe duke u mbështetur në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”, trupi gjykues përfundimisht çmon se mbeten të karakterit deklarativ dhe, për pasojë, të paprovuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se nuk ka paguar vlerën (çmimin) e plotë në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

38.1.3. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë për periudhën 1.1.2014 – 10.2.2014, të pasqyruara në tabelën në vijim.

Tabela nr. 5

| Analiza financiare për periudhën 1.1.2014 – 10.2.2014 | Vlerat në lekë |
|--|-----------------------|
| A) Pasuri | 1,420,815 |
| Automjeti “***”, tip “***”, vit prodhimi 2008 | 950,000 |
| Ndryshim likuiditeti ¹¹⁹ | 470,815 |
| B) Detyrime | 0 |
| C) Pasuri neto (A-B) | 1,420,815 |
| D) Të ardhura | 1,067,284 |
| Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit | 201,211 |
| Të ardhura nga paga, bashkëshorti i subjektit | 192,018 |
| Të ardhura si këshilltar, Njësia Bashkiake nr. ***, bashkëshorti i subjektit | 20,700 |
| Të ardhura nga ISSH/KEMP/ndihmë ekonomike, personi i lidhur B. M | 188,258 |
| Të ardhura nga interesat e depozitave bankare | 15,097 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit “***”, vit prodhimi 2000 | 450,000 |
| E) Shpenzime | 96,437 |
| Shpenzime jetike | 96,437 |
| Balanca e fondeve (D-C-E) | -449,969 |

38.1.4. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin në datën 10.2.2014 të pasurisë së llojit “automjet”, të markës “***”, tip “***”, vit prodhimi 2008, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit 84/2016.

39. Pasuri e llojit “likuiditet - gjendje cash” në banesë, në shumën 1,000,000 lekë

Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

¹¹⁹Shtesa në llogaritë bankare për periudhën objekt analize.

39.1. Deklarimi i likuiditeteve në vite

i. Në DIPP/2005, duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 100,000 lekësh, me burim të ardhurat nga paga. Por, rezulton se kjo vlerë është deklaruar në seksionin ku deklarohen të ardhurat.

ii. Në DIPP/2006, në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar vlerën 200,000 lekë.

iii. Në DIPP/2007, në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, që i përket formularit të personit të lidhur, subjekti ka deklaruar shumën 300,000 lekë.

iv. Në DIPP/2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 1,600,000 lekë, si gjendje likuiditetesh *cash* të krijuar në vitin 2008, me burim nga të ardhurat e pagës së saj dhe të bashkëshortit.

v. Në DIPP/2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 1,100,000 lekë, si gjendje likuiditetesh *cash* të krijuar në vitin 2009, me burim nga të ardhurat e pagës së saj dhe të bashkëshortit.

vi. Në DIPP/2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 1,300,000 lekë, si gjendje likuiditetesh *cash* të krijuar në vitin 2010, me burim nga të ardhurat e pagës së saj dhe të bashkëshortit.

vii. Në DIPP/2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 1,603,634 lekë, si gjendje likuiditetesh *cash* të krijuar në vitin 2011, me burim nga të ardhurat e pagës së saj dhe të bashkëshortit.

viii. Në DIPP/2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 1,700,000 lekë, si gjendje likuiditetesh *cash* të krijuar në vitin 2012, me burim nga të ardhurat e pagës së saj, të bashkëshortit dhe të djalit.

ix. Në DIPP/2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* krijuar në vitin 2013 me burim nga të ardhurat nga paga e bashkëshortit. Gjendje në llogari pranë BKT-së. Shuma: 500,000 lekë.

Por, siç u konstatua më sipër, të pyetur nga ILDKPKI-ja¹²⁰, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se gjendja *cash* në datën 31.12.2013 ka qenë 0 (zero) dhe se paratë e kursyera në të gjitha vitet janë investuar në ndërtimin e shtëpisë dhe për kompletimin e saj. Pra, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit dhe personit të lidhur, në fund të vitit 2013 gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë në vlerën 0 (zero) lekë.

x. Në DIPP/2014, në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar shumën 1,000,000 lekë si gjendje *cash* në datën 31.12.2014.

xi. Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar shumën 300,000 lekë, si gjendje *cash* në datën 31.12.2015.

xii. Në DIPP/2016, subjekti ka deklaruar shumën 1,000,000 lekë, si gjendje *cash* në datën 31.12.2016.

39.1.1. Referuar deklaramëve të bëra ndër vite në ILDKPKI, si dhe deklaramëve të bëra në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, rezulton se në deklaratat e interesave private/periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti. Gjithashtu konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në fund të

¹²⁰Dokument i datës 20.2.2015, “Sqarime në lidhje me deklarimin e pasurisë ndër vite sipas kërkesës së inspektorës”, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 11.2.2022.

vitit 2013 gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë 0 (zero) lekë. Në këtë këndvështrim, rezulton se si burim krijimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* kanë shërbyer të ardhurat e realizuara për vitet 2014 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

39.1.2. Bazuar në analizën e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni¹²¹ konstatohet se vitet 2014, 2015 dhe 2016 paraqiten me balancë pozitive fondesh. Si rrjedhim, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* në shumën 1,000,000 lekë, gjatë viteve 2014 – 2016, deklaruar si gjendje në deklaratën *Vetting*.

39.2. Pasuritë e llojit “likuiditete”, të materializuara në gjashtë llogari bankare në disa banka të nivelit të dytë, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me gjendje në datën 31.12.2016, si vijon:

- i. gjendja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank”, vlera 3,811 lekë;
- ii. gjendja e llogarisë së bashkëshortit në “Credins Bank”, vlera 19,761 lekë;
- iii. gjendja e llogarisë së pagës të djalit, B.M, në BKT, vlera 100,000 lekë;
- iv. gjendja e llogarisë së bashkëshortit në “Credins Bank”, vlera 30,125 lekë;
- v. gjendja e llogarisë së bashkëshortit në “Credins Bank”, vlera 32 euro;
- vi. gjendje e llogarisë së djalit, A.M, në “Credins Bank”, vlera 8 euro.

39.2.1. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ konfirmohen gjendjet e deklaruara të llogarive të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe djalit A.M, në datën 31.12.2016, përveçse gjendja e llogarisë së djalit B.M në BKT, pasi rezulton se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 është në vlerën 252,558 lekë dhe jo sa është deklaruar nga subjekti (në vlerën 100,000 lekë). Gjithsesi, rezulton se diferenca në vlerën e deklaruar ka si burim kreditimin e shumës 152,086 lekë nga DRSSH-ja Tiranë, si përfitim afatshkurtër nga sigurimet shoqërore.

ÇËSHTJE TË TJERA

40. Shpenzimet për trajtime mjekësore dhe dhurimet e deklaruara për mbulimin e tyre

40.1. E pyetur mbi shpenzime të mundshme për trajtime mjekësore, në përgjigje të pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *djali i quajtur B.M ka bërë aksident të rëndë automobilistik (aktualisht në KMCAP) më 26.12.2012 në Tiranë. Ndodhur në këto kushte, më 24.1.2013 e kanë dërguar djalin në Itali, pasi Ministria e Shëndetësisë kishte marrëveshje me spitalin “G” Romë, Itali. Sqaron se transporti është bërë me avion sanitar Tiranë - Romë, shoqëruar nga mjeku anestezist i bordit mjekësor; vlera e transportit 7,050 euro, paguar nga familja. Bashkëshorti A.M, në momentin që mjekët rekomanduan që djalin duhet ta nisnin jashtë shtetit për kurim, duke ditur se shpenzimet ishin të papërballueshme prej tyre, ka hapur një numër llogarie, me qëllim që donatorë të mundshëm të kontribuonin për të shpëtuar jetën e djalit”. Sqaron se donatorë kanë qenë: (i) biznesmeni i njohur nga Tropoja, R.G (10,000 euro), derdhje cash në llogarinë e bashkëshortit; (ii) kushëriri i saj, shtetasi H.P, i cili ka biznes privat klinikë dentare (10,000 euro), derdhje cash në llogarinë e bashkëshortit; (iii) djali i xhajës së bashkëshortit, shtetasi S.H (M), i cili ka pasur biznes privat sh.p.k. “****” në sektorin e minierave (15,000 euro), derdhje cash në llogarinë e bashkëshortit; (iv) shtetasi P.Sh, i cili ka aktivitet privat (20,000 euro), derdhje cash në llogarinë e bashkëshortit; dhe (v) B.H (10,000 euro), derdhje cash në llogari, shitje dyqani. Gjithashtu, ka shpjeguar se në mbulimin e shpenzimeve për kurimin e*

¹²¹Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneks ***, pjesë e këtij vendimi.

djalit ka kontribuuar në shumën 3,292,951 lekë Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë (provuar ky fakt me VKM-në Nr. 616, datë 24.3.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 6.8.2013). Në vijim të verifikimit të shpenzimeve për trajtime mjekësore të djalit, subjekti ka deklaruar: (a) shpenzime spitalore tek spitali “G”, shuma 5,415 euro (skanera, rezonanca dhe eko të ndryshme), paguar në arkën e spitalit me mandatarkëtimin nga bashkëshorti A.M; (b) shpenzime spitalore tek fondacioni “S.L” një muaj 18,000 euro, paguar me bankë nga Tirana nëpërmjet “Credins Bank”, nga bashkëshorti A.M; (c) shpenzime për pagesën e dhomës së spitalit në shumën 20,280 euro, pagesë e cila është bërë me bankë nga bashkëshorti A.M (provuar ky fakt me aktin e lëshuar nga “Credins Bank”, datë 12.5.2014 dhe fatura datë 9.5.2014, lëshuar nga fondacioni “S.L”). Burimi i të ardhurave ishte nga donatarët e lartpërmendur; (d) shpenzimet për periudhën 9.5.2014 deri në datën 31.7.2014 në vlerën 9,600 euro, diferenca e pagesës së dhomës është mbuluar nga V.H.K (provuar ky fakt me aktet përkatëse). Në përfundim të deklarimit, subjekti ka sqaruar se shpenzime spitalore në funksion të kurimit dhe rehabilitimit të djalit tim B.M, duke përjashtuar ato të lartpërmendurat, nuk kanë pasur, pasi të gjitha janë mbuluar nga shërbimi shëndetësor kombëtar i shtetit italian. Shteti italian, duke filluar nga data 8.5.2013 e ka pajisur me permeso (leje qëndrimi) me qëllim trajtim mjekësor B.M dhe ndërkohë është pajisur me tesorë sanitare, e përkthyer në mbulimin e të gjitha shpenzimeve spitore, ekzaminime ndërhyrjeje etj. (provuar sa sipër me permesso 3 copë të lëshuara për trajtim mjekësor nga Ministria e Brendshme Kuestura Romë, Itali, me kod fiskal ***, me afat 6-mujor, datë lëshimi 8.5.2013, datë lëshimi 8.11.2013 dhe datë lëshimi 8.5.2014 dhe tesera sanitare lëshuar në datat 8.5.2013, 8.11.2013 dhe 8.5.2014).

40.1.1. Nga verifikimi i DIPP/2013, Komisioni konstaton se në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) shumën 3,292,951 lekë, të ardhura për shpenzimet spitalore nga Qeveria Shqiptare për kurimin e djalit B.M, me VKM-në Nr. 616, datë 24.7.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 6.8.2012; (ii) shumën 70,000 euro, të ardhura të derdhura në janar të vitit 2013 nga donatorë të ndryshëm në llogarinë e bashkëshortit në “Credins Bank”, për transportin dhe kurimin e djalit; (iii) shumën 15,000 euro si donacion nga shtetasja V.K, e cila jeton në Toronto, Kanada, për shpenzimet hotelerie në Romë. Pagesa e kryer nga numri i llogarisë së V për shpenzimet hotelerie në Romë; (iv) shumën 7,000,000 lekë si depozitë në “Credins Bank”, me afat 6-mujor (21.10.2013), krijuar nga të ardhurat për kompensimin e tokës dhe shpenzimeve spitalore të deklaruara; (v) shumën prej 25,000 euro si depozitë në “Credins Bank”, me afat 3-mujor (21.10.2013), me burim të ardhurat nga donacionet e mbledhura në muajin janar.

40.1.2. Ndërsa, në seksionin “Shpenzime të deklarueshme” të DIPP/2013, subjekti ka deklaruar: (i) shpenzim transporti me avion sanitar, Tiranë - Romë, spitali “G”, në vlerën 7,050 euro; (ii) shpenzim spitalor në spitalin “G” për periudhën 25 janar – 31 mars 2013, shumën 5,415 euro; (iii) shpenzim spitalor në spitalin “S.L” për muajin prill 2013, shumën 18,000 euro; (iv) shpenzime hotelerie të paguara nëpërmjet bankës nga shtetasja V.K (mbesa e bashkëshortit), e cila jeton në Toronto, Kanada, shuma 15,000 euro.

40.1.3. Nga verifikimi i DIPP/2014, Komisioni konstaton se në seksionin “Shpenzime të deklarueshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) shpenzime spitalore për kurimin e djalit B.M në spitalin “S.L”, Romë, Itali, për periudhën 21.11.2013 – 8.5.2014, në shumën 20,280 euro; (ii) shpenzimet spitalore të kryera nga mbesa e bashkëshortit V.K nga Toronto, Kanada, për periudhën 10.5.2014 – 31.7.2014, në spitalin “S.L”, Romë, Itali, në shumën 9,600 euro; (iii) shpenzime për tri pjesëtarët e familjes që i kanë shërbyer djalit për periudhën 1.1.2014 – 31.7.2014 (qira shtëpie, gaz, energji, ujë, ushqim etj.), shumën 14,000 euro; (iv) shpenzime transporti me avion për djalin dhe pjesëtarët e familjes për kthimin nga Roma në Tiranë. Shpenzimet janë kryer nga mbesa e bashkëshortit V.K nga Toronto, Kanada, në shumën 1,800

dollarë kanadezë; (v) shpenzime për kurimin e djalit në spitalin “Z.K.M”, Tiranë, për fizioterapi dhe transport, për periudhën 1.9.2014 – 31.12.2014, në shumën 342,000 lekë; (vi) shpenzim i detyrueshëm për vendosjen e një ashensori spitalor për transportin e djalit, në shumën 1,000,000 lekë.

41. Krijimi i depozitave me afat në vitin 2013

41.1. Depozitë bankare me vlerë 25,000 euro në “Credins Bank”

41.1.1. Referuar dokumentacionit bankar¹²², të administruar në dosje, konfirmohet se në llogarinë e bashkëshortit të subjektit A.M në “Credins Bank” janë kryer depozitime vlerash monetare *cash* në monedhën euro, si vijon: (i) në datën 21.1.2013, depozituar *cash* nga A.M shuma 5,000 euro; (ii) në datën 21.1.2013, depozituar *cash* shuma 15,000 euro, me përshkrimin “*derdhje L G sh.p.k., të ardhura nga biznesi (dhurim për shërim djalit)*”; (iii) në datën 21.1.2013, depozituar *cash* shuma 10,000 euro, me përshkrimin “*derdh R.G dhuratë për të sëmurin B.M për kurim SP V*”; (iv) në datën 21.1.2013, depozituar *cash* shuma 10,000 euro, me përshkrimin “*derdhje TR Shitje dyqani B.H dhuratë kurim djali Itali*”; (v) në datën 23.1.2013, depozituar *cash* shuma 10,000 euro, me përshkrimin “*derdh H.P ndihmë për djalin e A për arsye shëndetësore*”; (vi) në datën 25.1.2013, depozituar *cash* shuma 20,000 euro, me përshkrimin “*derdhje nga P.Sh dhurate për kurimin e djalit në Itali*”.

41.1.2. Pra rezulton se nga data 21.1.2013 deri më 25.1.2013, në llogarinë e personit të lidhur është depozituar në total shuma 70,000 euro. Sikurse u konstatua më sipër, në DIPP/2013 subjekti ka deklaruar shumën 70,000 euro si të ardhura nga donatorë të ndryshëm të derdhura në llogarinë e bashkëshortit në “Credins Bank”, për transportin dhe kurimin e djalit.

41.1.3. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie, rezulton se: (i) në datën 26.3.2013 është transferuar në Itali shuma 18,001 euro, me përshkrimin “*Fondazione S.L P.R Per Il B.M*”; (ii) në datën 29.4.2013 është transferuar në Itali shuma 4,415 euro, me përshkrimin “*Ben.U.C.D.S Pagamento Per Il Paciente B.M*”; (iii) në datën 11.7.2013 personi i lidhur ka tërhequr *cash* shumën 10,000 euro; dhe (iv) në datën 6.9.2013 personi i lidhur ka tërhequr *cash* shumën 10,000 euro.

41.1.4. Si rrjedhojë e transfertave në Itali dhe tërheqjeve *cash* të këtyre shumave, balanca në llogari ka mbetur në vlerën 27,548 euro, nga të cilat në datën 21.10.2013, shuma 25,000 euro është investuar në depozitë me afat 3-mujor, ndërsa pjesa tjetër 2,548 euro ka qëndruar e lirë në llogari.

41.1.5. Komisioni konstaton se në DIPP/2013 subjekti ka deklaruar shumën 25,000 euro si depozitë në “Credins Bank”, me afat 3-mujor (21.10.2013), me burim të ardhurat nga donacionet e mbledhura në muajin janar (depozitë e konstatuar si gjendje në llogarinë bankare të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, z. A.M).

41.1.6. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie, rezulton se: (i) në datën 21.1.2014 depozita është maturuar, duke u përfituar interesi *neto* në shumën 107 euro dhe në vijim shuma 25,107 euro është investuar përsëri me afat 3-mujor; (ii) në datën 21.4.2014 depozita është maturuar, duke u përfituar interesi *neto* në shumën 90 euro; (iii) në datën 30.4.2014 depozita fillestare në vlerën 25,000 euro, së bashku me interesat e përfituara në shumën 197 euro, janë kaluar në gjendje të lirë në llogari të personit të lidhur dhe në vijim janë tërhequr *cash*/transferuar prej tij, përkatësisht si vijon: (1) në datën 30.4.2014 tërhiqet *cash* shuma 5,196 euro; (2) në datën 12.5.2014 shuma 20,280 euro transferohet në Itali, me përshkrimin “*Ben.Fondazione S.P.R Per Il B.M 22.11.2013 Al 9.5.2014*”.

¹²²Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, e “Credins Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.9.2020.

41.1.7. Pra, rezulton se në fund të vitit 2014 personi i lidhur ka pasur në këtë llogari shumën 182 euro, sikurse është deklaruar në DIPP/2014.

41.2. Depozitë bankare me vlerë 7,000,000 lekë në “Credins Bank”

41.2.1. Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank”¹²³, rezulton se: (i) në datën 20.9.2013, në këtë bankë, në llogarinë e pagës së personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) në monedhën lekë (me numër bazë ***) kreditohet shuma 4,755,648 lekë, me përshkrimin “*Orderer A.K.K.P. kësti 1,2,3 dhe 4 në total 57%, grupi njëzet e tre oper.datë 20.9.2013*”; (ii) në datën 17.10.2013, po në të njëjtën llogari, kreditohet shuma 3,282,151 lekë, me përshkrimin “*Ministria e Shëndetësisë, shpenzime për kurim jashtë oper.datë 17.10.2013*”; (iii) në datën 21.10.2013, si rrjedhojë e akumulimit të vlerave monetare të konstatuara si më sipër, shuma 7,000,000 lekë është investuar në depozitë me afat 6-mujor.

41.2.2. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie, rezulton se: (i) në datën 21.4.2014 depozita është maturuar, duke u përfituar interesi *neto* prej 113,000 lekësh dhe se kjo depozitë në vlerën 7,113,000 lekë është investuar përsëri me afat 6-mujor; (ii) në datën 21.10.2014 depozita 6-mujore është maturuar, duke u përfituar një interes *neto* prej 89,871 lekësh; (iii) në datën 28.10.2017 depozita fillestare në vlerën 7,000,000 lekë, së bashku me interesat e përfituara prej 202,959 lekësh, janë kaluar në llogari rrjedhëse, e në vijim rezulton se janë tërhequr *cash* nga personi i lidhur, përkatësisht fondet si vijon: (a) në datën 29.10.2014, tërhequr shuma 2,200,000 lekë; (b) në datën 21.11.2014, tërhequr shuma 2,500,000 lekë; dhe (c) në datën 17.12.2014, tërhequr shuma 2,402,900 lekë. Pra, rezulton se në fund të vitit 2014, personi i lidhur ka pasur gjendje në këtë llogari shumën prej 101,921 lekësh.

41.2.3. Komisioni konstaton se në DIPP/2013 dhe në DIPP/2014 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me gjendjet e llogarisë/llogarisë depozitë në monedhën lekë në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortit të saj.

41.2.4. Komisioni kërkoi nga subjekti¹²⁴: (i) të deklaronte shumën e saktë të dhuruar në favorin e saj/familjes për vitet 2013 dhe 2014, duke specifikuar/evidentuar/konfirmuar vlerat përkatëse nga secili dhurues dhe mënyrën e kryerjes së dhurimit; (ii) të gjithë shtetasit, të konstatuar dhe të deklaruar si dhurues, të konfirmojnë dhurimin e kryer (periudhën/mënyrën/vlerën) me akt shkresor në formën e kërkuar nga ligji; (iii) të deklaronte mbi burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të dhuruara nga shtetasit të cilët deklarohen/konstatohet në cilësinë e dhuruesve/donatorëve, duke depozituar në mbështetje të deklarimit dokumentacion justifikues ligjor për të provuar krijimin e tyre; si dhe (iv) të deklaronte mbi marrëdhënien e saj dhe/apo të bashkëshortit me dhuruesit (shtetasit të cilët kanë kryer donacione/dhurime), duke konfirmuar gjithashtu nëse ka shqyrtuar/gjykuar çështje gjyqësore civile/penale (qoftë edhe kërkesa të veçanta), ku si palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., të shfaqen shtetasit e sipërcituar dhe/apo shoqëritë tregtare, në të cilat ata kanë qenë/janë aksioner apo përfaqësues ligjor.

41.2.5. Në përgjigje të kërkesave të bëra nga Komisioni, subjekti ka rikonfirmuar faktin se për shkak të aksidentit të rëndë që ka pësuar djali, domosdoshmërisë për kurimin e tij jashtë vendit, me kërkesën edhe të njerëzve të tyre, bashkëshorti i saj A.M ka hapur numrin e llogarisë në euro në “Credins Bank”, ku ka depozituar shumën 5,000 euro, me burim nga kursimet e tyre. Në vijim, ka deklaruar se në janar të vitit 2013 janë derdhur donacione nga njerëz të afërt të familjes në shumën 65,000 euro në llogarinë e bashkëshortit në “Credins Bank”, si vijon: (i) nga shtetasi R.G shuma 10,000 euro; (ii) nga shtetasi H.P shuma 10,000

¹²³Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.9.2020.

¹²⁴Pyetësori nr. ***, i dërguar nga Komisioni.

euro; (iii) nga djali i xhaxhait të bashkëshortit S.H, shuma 15,000 euro; (iv) nga shtetasi P.Sh, shuma 20,000 euro; dhe (v) nga shtetasja B.H, shuma 10,000 euro – të gjitha këto shuma të derdhura *cash* në llogarinë e personit të lidhur. Subjekti ka sqaruar se shtetasja V.H (K), mbesa e bashkëshortit, ka bërë donacion duke mbuluar shpenzimet në shumën 15,000 euro për hotelet “****” dhe “****” në Romë, për periudhën 23.1.2013 – 22.11.2013, shpenzime për personat që qëndronin në shërbim të djalit (pagesa të cilat janë bërë nga numri i llogarisë së saj nga Toronto, Kanada, në numrin e llogarive përkatëse të hoteleve, provuar ky fakt me *statement*-in e viteve 2010 - 2014)¹²⁵. Ndërsa për vitin 2014, subjekti ka deklaruar se shtetasja V.H (K) ka bërë donacion për t'i ardhur në ndihmë familjes së saj, për periudhën 10.5.2014 – 31.7.2014, në shumën 9,600 euro. Pagesat janë bërë nëpërmjet bankës për shpenzime spitalore, nga numri i llogarisë së saj nga Toronto, Kanada, në numrin e llogarisë së fondacionit “S.L” Romë, Itali, për diferencën 160 euro/nata, pasi 600 euro i paguante Shërbimi Kombëtar Parësor i shtetit italian. Gjithashtu, ka deklaruar se edhe shpenzimet e transportit me avion për djalin dhe pjesëtarët e familjes për vitin 2014 janë mbuluar nga shtetasja V.H (K), në total shuma e shpenzuar 1,800 dollarë kanadezë. Pra, subjekti ka theksuar se shuma e dhuruar nga shtetasja V.H (K) në favor të familjes së saj për vitin 2014, është 9,600 euro dhe 1,800 dollarë kanadezë.

41.2.6. Subjekti ka sqaruar se në numrin e llogarisë së bashkëshortit, hapur posaçërisht për donacione për shkak të djalit, shuma e derdhur ka qenë 70,000 euro, fakt i deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, por duke saktësuar se në deklarimin e bërë është llogaritur edhe shuma 5,000 euro, me burim nga kursimet familjare, të cilat janë derdhur nga bashkëshorti sapo ka hapur numrin e llogarisë dhe se ajo e ka llogaritur si shumë të përgjithshme të derdhur në atë numër llogarie, pra, që do të thotë se, donacionet e derdhura *cash* në numrin e llogarisë së bashkëshortit në “Credins Bank”, janë në total në shumën 65,000 euro.

41.2.7. Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti (në deklaratat e interesave private të depozituara në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni), rezulton se të gjitha vlerat monetare të referuara si donacione nga persona të tretë gjatë viteve 2013 dhe 2014, si dhe shuma e kredituar në llogarinë e personit të lidhur nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2013, kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve në funksion të trajtimit mjekësor të djalit B.M.

41.2.7. Komisioni verifikoi në mënyrë të përmbledhur të ardhurat e deklaruara dhe të konstatuara nga donacionet/dhurimet në raport me shpenzimet e deklaruara dhe të pasqyruara për trajtimin mjekësor të djalit të subjektit dhe/apo shpenzimet e tjera të lidhura me to, të paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 6

| DONACIONET | Shuma në euro | Shuma në dollarë kanadezë | Shuma në lekë |
|------------|---------------|---------------------------|---------------|
| R. G | € 10,000 | | |
| H.P | € 10,000 | | |
| S.M (H) | € 15,000 | | |
| P.Sh | € 20,000 | | |
| B.H | € 10,000 | | |
| V.H (K) | € 24,600 | | |

¹²⁵Rezultoni se në përgjigje të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni, subjekti nuk ka depozituar *statement* të llogarisë bankare të shtetasës V.H (K), pjesë e dokumentacionit mbështetës të përgjigjeve të pyetësorit nr. ***.

| | | | |
|------------------------------------|----------|---------------------------|-----------------------|
| V. H (K) | | CAD 1,800 | |
| M.SH., VKM Nr. 616, datë 24.3.2013 | | | ALL 3,292,951 |
| Totali | € 89,600 | CAD 1,800 | ALL 3,292,951 |
| | | Konvertuar/në lekë | ALL 16,060,319 |

| SHPENZIMET SPITALORE | Shuma në euro | Shuma në dollarë kanadezë | Shuma në lekë |
|---------------------------------------|----------------------|----------------------------------|-----------------------|
| Fluturim avioni spitalor | € 7,050 | | |
| Hoteleri | € 16,000 | | |
| Shtëpi me qira dhe jetesa në Romë | € 14,000 | | |
| Fondacioni "S.L" | € 18,000 | | |
| Spitali "G" – U. C | € 5,415 | | |
| Fondacioni "S. L" | € 20,280 | | |
| Hoteleri | € 15,000 | | |
| Shpenzime | € 9,600 | | |
| Shpenzime transporti me avion | | CAD 1,800 | |
| Shpenzime vendosje ashensori spitalor | | | ALL 1,000,000 |
| Totali | € 105,345 | CAD 1,800 | ALL 1,000,000 |
| | | Konvertuar/në lekë | ALL 15,974,974 |

41.2.8. Sa më sipër, konstatohet se të ardhurat e deklaruara si donacione/dhurime janë në vlerë të përafërt me shumën e shpenzimeve të deklaruara dhe të konstatuara si të kryera për kurimin e djalit dhe shpenzimeve të tjera të kryera në funksion të tyre. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur nuk kanë krijuar pasuri me burim të ardhurat e përfituara nga donacionet.

41.2.9. Lidhur me burimin e të ardhurave të dhuruesve, subjekti ka deklaruar se të gjithë shtetasit që kanë bërë donacione/dhurime janë biznesmenë, të cilët kanë burime të mjaftueshme financiare, duke specifikuar si vijon: (i) shtetasi H.P (kushëriri i saj nga nëna dhe fqinj i familjes) ushtron profesionin e dentistit prej vitit 1992 e në vazhdim, nga viti 2006 e në vijim klinikë dentare, shërbime stomatologjike dhe bar-hotel; (ii) shtetasi S. H (djali i xhaxhait të bashkëshortit) për vite me radhë ka ushtruar aktivitetin në fushën e nxjerrjes dhe tregtimit të kromit, shoqëria "****" sh.p.k.; (iii) shtetasja B.H (bashkëshortja e Xh.H, nipi i të cilit është bashkëshorti i mbesës së personit të lidhur A.M) ka/kanë aktivitet në grumbullimin, distilimin dhe shitjen e bimëve mjekësore (biznes i madh); (iv) shtetasi R.G (lidhje shoqërore dhe fisnore e bashkëshortit) është ndërtues dhe pronar i hotel "****" (biznes i madh); (v) shtetasi P.Sh (fqinj dhe lidhje shoqërore e bashkëshortit dhe se djali i tij i quajtur H. Sh është shok i ngushtë me djalin e saj të aksidentuar B.M) ka aktivitet tregtar që nga viti 1992, bar-kafe "****", në Tiranë, si dhe ka trashëguar nga prindërit toka, ka kryer shitje të tokave dhe ka përfituar kompensime në mënyrë të vazhdueshme.

41.2.10. Subjekti ka deklaruar se nuk ka shqyrtuar/gjykuar çështje gjyqësore civile/penale (qoftë edhe kërkesa të veçanta), ku si palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., të kenë qenë personat e lartpërmendur (provuar ky fakt me shkresën nr. *** prot.,

datë 26.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë)¹²⁶.

41.2.11. Komisioni konstaton se subjekti ka depozituar deklarata noteriale të të gjithë shtetasve të cilët kanë kryer derdhje *cash* në llogarinë bashkëshortit të saj në janar të vitit 2013, në referim të të cilave kanë konfirmuar shumën e dhuruar, periudhën dhe qëllimin e dhurimit¹²⁷.

41.2.12. Në vijim të komunikimit të mbajtur me Komisionin, subjekti paraqiti shpjegime shtesë, si dhe depozitoi dokumentacion, me qëllim provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e vlerave monetare të dhuruara, të konstatuara si shuma të derdhura *cash* në llogarinë e personit të lidhur, z. A.M, në janar të vitit 2013, përkatësisht, për shtetasit H.P, S.H, B.H, R.G dhe P.Sh¹²⁸.

41.2.13. Nëpërmjet shpjegimeve të saj, subjekti ka parashtruar se *sikurse e ka deklaruar edhe në deklaratat periodike, por edhe në pyetësorët e mëparshëm, shumat e derdhura në llogarinë e bashkëshortit në janar 2013 janë dhënë si donacione nga persona të njohur, miq e të afërm, për shkak të aksidentit të djalit të tyre, B. Thekson se këto shuma janë përdorur vetëm për shpenzime spitalore apo shpenzime të tjera të lidhura ngushtësisht me kurimin e djalit. Nuk ka menduar në asnjë moment të kërkonte apo të ketë dokumentacion justifikues për të ardhurat e personave që kanë bërë donacion për t'i ardhur në ndihmë për të shpëtuar jetën e djalit, B.M, i cili ishte në gjendje kome (duke kërkuar ndjesë që po detyrohet ta përmend shumë herë këtë fakt) dhe mjekët, siç ka sqaruar, rekomanduan që djalin ta nisnin jashtë shtetit për kurim të specializuar, pasi dhanë shpresë për jetën e tij në S.U.T. Subjekti ka theksuar se, edhe pse ka kaluar një periudhë e gjatë, gati 10 vjet, e ka shumë të vështirë t'ua kërkojë këtyre personave që i janë gjendur në ditë shumë të vështira për ta, se sa dhe ku i kanë fituar të ardhurat e tyre. Megjithatë, në respekt të procesit të rivlerësimit, është përpjekur të gjejë disa të dhëna, duke i kontaktuar dhe pyetur në mënyrë diskrete, si dhe duke kërkuar te QKB-ja.*

41.2.14. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime shtesë, duke pasqyruar të dhëna të reja, si dhe depozituar dokumentacion mbështetës për secilin prej donatorëve, si vijon:

*i) H.P, me profesion dentist, ka hapur aktivitetin e tij si person fizik, me NIPT ***, që në mars të vitit 1995, duke pasur një kabinet dentar në Tropojë. Ky biznes është çregjistruar në vitin 2019. Në maj të vitit 2007, ai hapi një klinikë dentare në Tiranë si person fizik, me NIPT ***. Në korrik të vitit 2019 ai e zgjeroi objektin e aktivitetit të tij edhe me bar-hotel “***” Tropojë (përveç shërbimeve dentare), për shkak të të ardhurave dhe fitimeve mjaft të mira që i sillte klinika dentare. Nga biseda që ka bërë me të, ai i ka sqaruar se donacioni prej 10,000 euro i bërë prej tij ka si burim të ardhura nga veprimtaria private e tij.*

Subjekti ka depozituar dy ekstrakte historike të bizneseve, sipas NIPT-eve të referuara më sipër.

¹²⁶Depozituar si prova nga subjekti, pjesë e dokumentacionit mbështetës të përgjigjeve të pyetësorit nr. ***.

¹²⁷Deklarata noteriale të depozituara në Komision – protokolluar lista e dokumenteve nr. *** prot., datë 9.5.2022, si vijon: (i) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2022, e shtetasi H.P, redaktuar nga noteri publik A.B; (ii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2022, e shtetasit R.G, redaktuar nga noteri publik A.B; (iii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.4.2022, e shtetasit S.H, redaktuar nga noteri publik E.K; (iv) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2022, e shtetasit B.H, redaktuar nga noteri publik N.K; dhe (v) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2022, e shtetasit P.Sh, redaktuar nga noteri publik L.M.

¹²⁸Shpjegimet shtesë në lidhje me pyetësorin nr. ***, dërguar në rrugë elektronike me *e-mail*-in e datës 31.5.2022, si dhe dokumentacioni mbështetës i depozituar në protokollin e Komisionit në datën 31.5.2022 (protokolluar me nr. ***).

ii) S.H është ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., e themeluar në mars të vitit 2009, me NIPT ***, me objekt aktiviteti “Kërkim, nxjerrje dhe shfrytëzim mineralesh, si dhe punime me lëndë plasëse për përdorim civil. Përpunimin dhe transportimin e mineraleve, si të mallrave të ndryshëm industriale e bujqësore. Përpunimin (teknologjik) i mineraleve dhe mbeturinave të mineraleve të ndryshme. Eksport-import dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve të mineraleve”. S është djali i xhaxhait të bashkëshortit dhe nga biseda që kanë bërë bashkë, ai ka sqaruar se donacioni prej 15,000 euro është bërë nga kompania e tij “****”, pavarësisht se ka qenë administrator i shoqërisë dhe ka pasur edhe të ardhura personale prej saj. Ky fakt provohet edhe me përshkrimin që është bërë në bankë kur është derdhur shuma prej 15,000 euro (derdhje “****” sh.p.k., të ardhura nga biznesi (dhurim për shërim të djalit). Gjithashtu, nga pyetjet që i janë bërë ekonomistit të firmës, ai ka informuar se për vitin 2011, shitjet neto kanë qenë rreth 25 milionë lekë dhe fitimi rreth 15 milionë lekë. Ndërsa për vitin 2012, pavarësisht se kompania nuk ka rezultuar me fitim, z. H, si administrator dhe ortaku i vetëm, i ka marrë paratë nga arka e kompanisë. Rezulton që S ka tërhequr nga llogaria e kompanisë shumë 10,000 euro në të njëjtën ditë që e ka depozituar atë për djalin e tyre B.

Subjekti ka depozituar kopje të dokumenteve: (i) statutin e shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) bilancet e viteve 2011 dhe 2013; dhe (iv) nxjerrje të llogarisë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k.

iii) B.H është administratore e shoqërisë “****” sh.p.k., e themeluar në janar të vitit 1995, me NIPT ***, me objekt të aktivitetit eksport - import me shumicë e pakicë të bimëve medicinale etj. Në këtë kompani ortak i vetëm është bashkëshorti i saj Xh.H, ndërsa znj. B. H ka punuar në kompani si ekonomiste dhe në vitin 2019 është bërë administratore e kësaj kompanie. Kapitali i kompanisë është 80 milionë lekë, xhiro për vitin 2012 ka qenë 120 milionë lekë dhe fitimi 18 milionë lekë. Për vitin 2013 xhiro ka qenë 220 milionë lekë dhe fitimi 6 milionë lekë. Nga biseda që ka pasur me znj. H, ajo u ka shpjeguar se paratë që ka përdorur për depozitimin e shumës 10,000 euro në datën 21 janar 2013 vijnë nga shitja e një dyqani tek rruga “****”. Ky dyqan është shitur për rreth 100 milionë lekë të vjetra.

Subjekti ka depozituar kopje të dokumenteve: (i) ekstrakt historik i subjektit tregtar “****” sh.p.k.; dhe (ii) bilancin e vitit 2013 të kësaj shoqërie.

iv) R.G është aksioner në disa kompani dhe burimi i donacionit janë nga arka e këtyre shoqërive. “****” sh.p.k., themeluar në vitin 1994, me NIPT ***, ortak i vetëm dhe administrator, me aktivitet kryerjen e investimeve të ndryshme në sektorët e ndërtimit, rrugë, ura, nënkalime, mbikalime, vepra arti të mëdha dhe të vogla, autostrada, trase, porte, aeroporte, hekurudha, diga, tunele, etj. Kapitali 2,076,000,000 lekë. Për vitet 2011 dhe 2012 xhiroja e kompanisë ka qenë rreth 700 milionë lekë për secilin vit. Bashkëlidhur bilanci i vitit 2012. Shoqëria “****” sh.a., ose hotel “****”, me NIPT ***, në fushën e hotelierisë, kapitali 711,900,000 lekë dhe pjesëmarrja e z. G me 40% të aksioneve. “****” sh.a., me NIPT ***, themeluar në vitin 2009. Z. G zotëron 6.67% të aksioneve. Kapitali i kësaj shoqërie është 427,140,000 lekë.

Subjekti ka depozituar kopje të dokumentacionit: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, për shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***; (ii) pasqyrat financiare të vitit 2012, për shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***; (iii) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, për shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***; (iv) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, për shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***; (v) ekstrakti historik i regjistrimit tregtar, për shoqërinë “****” sh.a., me NIPT ***; (vi) vendim i mbledhjes së zakonshme të asamblesë së aksionerëve të shoqërisë “****” sh.a., i datës 25.3.2011; dhe (vii) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, për shoqërinë “****” sh.a., me NIPT ***.

v) P.M.Sh nga viti 1992 e deri më sot ka zhvilluar aktivitet privat në fusha të ndryshme si restorant, njësi shitjeje artikujsh ushqimorë me shumicë e pakicë në Q S, bar-kafe “Sh” etj. Ai gjithashtu ka trashëguar nga babai M.Sh pasuri të paluajtshme, të cilat i janë kthyer nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (bashkëpronar me ¼ pjesë e 3330 m² tokë të trashëguara nga babai dhe ka shitur pjesën e tij takuese 832 m²). Ka marrë disa herë kompensime për tokat e zëna. Gjithashtu, ka disa ambiente të dhëna me qira në Q.S që i sjellin përfitime të kënaqshme, si dhe një sipërfaqe toke e ka dhënë për ndërtim me 35 % një firme ndërtimi pas U.E.T.

Subjekti ka depozituar kopje të dokumentacionit: (i) ekstrakt të QKB-së për subjektin “****”, Person Fizik; (ii) kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.6.2004; (iii) vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 1.6.2014; (iv) deklaratë noteriale¹²⁹ datë 11.3.1998, e shtetasit M.Sh; (v) nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank” e shtetasit P.Sh; (vi) lëvizjet e llogarisë bankare në “ProCredit Bank” të shtetasit P. Sh; (vii) kontratë kredie¹³⁰ dhe kontratë hipotekimi¹³¹ (depozituar vetëm faqet e para të tyre); si dhe (viii) polica sigurimi prone dhe jete, lëshuar nga shoqëria “****”.

41.2.15. Pasi Komisioni analizoi deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi kreu verifikime në faqen zyrtare të QKB-së, rezultoi se kryesisht dokumentacioni i depozituar nga subjekti për të dhënat e biznesit të donatorëve/dhuruesëve është administruar nga kjo faqe, përveçse nxjerrjes së llogarisë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe disa dokumenteve të depozituara në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të shtetasit P.Sh.

41.2.16. Pas shqyrtimit të deklaratimeve të bëra, dokumentacionit të depozituar, si dhe verifikimeve të kryera në faqen zyrtare të QKB-së lidhur me aktivitetin e biznesit të personave të tjerë të lidhur dhe burimet e tjera të të ardhurave të referuara nga subjekti, rezultoi se:

a) Shtetasi H.P, në datën 29.3.1995, ka regjistruar aktivitetin e tij privat si person fizik, me NIPT ***, me fushë veprimtarie “aktivitete të praktikës dentare”, me vend ushtrimi aktiviteti në lagjen “****”, Bajram Curri, aktualisht me status “çregjistruar” që prej datës 4.10.2019.

Gjithashtu, në datën 5.4.2006, ky shtetas ka regjistruar në QKB aktivitetin privat si person fizik, me fushë veprimtarie “klinikë dentare, shërbime stomatologjike (dentist); hotel, bar”, me adresë kryesore aktuale të zhvillimit të aktivitetit në rrugën “****”, Tiranë dhe me adresë dytësore të zhvillimit të aktivitetit në rrugën “****”, Bajram Curri, adresë në të cilën rezultoi se ka filluar të zhvillohet aktiviteti i hotelierisë që prej vitit 2019, vit në të cilin ky tatimpagues ka marrë emrin tregtar “****”.

Sa më sipër, duket se shtetasi H. P ka zhvilluar aktivitet tregtar privat në fushën e shërbimeve stomatologjike, në mënyrë të pandërprerë që prej muajit mars të vitit 1995 e deri në momentin e dhurimit të vlerës monetare prej 10,000 euro, në favor të familjes M, në janar të vitit 2013, depozituar në llogarinë e personit të lidhur.

b) Shtetasi S.H ka qenë përfaqësues ligjor dhe aksioner i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., që nga data e themelimit të saj (shoqëri e regjistruar në QKB më datë 12.3.2009) deri në muajin korrik të vitit 2017 (moment kur ka shitur aksionet e tij në këtë shoqëri), me NIPT ***, me aktivitet në fushën e “kërkim, nxjerrje dhe shfrytëzim materialesh, si dhe punime me lëndë plasëse për përdorim civil. Përpunimin dhe transportimin e mineraleve si të mallrave të ndryshëm industrial e bujqësore. Përpunim (teknologjik) i mineraleve dhe mbeturinave të

¹²⁹Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.3.1998.

¹³⁰Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2007.

¹³¹Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2007.

mineraleve ndryshme. Eksport - import dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve të mineraleve”, me adresë të ushtrimit të aktivitetit në fshatin Z, B, Kukës.

Nga verifikimi i bilanceve të depozituara nga subjekti rezulton se fitimi i kësaj shoqërie për vitin 2011 ka qenë në vlerën 15,268,932 lekë, ndërsa për vitin 2012 me humbje në vlerën 2,485,989 lekë.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentit nxjerrje llogarie bankare nga “Raiffeisen Bank” e shoqërisë “****” sh.p.k., rezulton se në datën 21.1.2013 përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, shtetasi S.H, ka kryer dy tërheqje *cash* me vlerë nga 5,000 euro secila, në total në shumën 10,000 euro.

Ndërkohë, siç u konstatua më sipër, po në datën 21.3.2013, shtetasi S.H ka depozituar *cash* shumën prej 15,000 euro në llogarinë e hapur nga personi i lidhur A.M, me përshkrimin “derdhje *** sh.p.k., të ardhura nga biznesi (dhurim për shërim djalit)”.

Sa më sipër, rezulton se gjatë vitit 2011 shoqëria “****” sh.p.k., me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin S.H, ka pasur fitim në vlerë të konsiderueshme, shumë e cila mund të përballonte mbulimin e humbjeve të vitit 2012 dhe kryerjen e dhurimit/donacionit në janar të vitit 2013, në shumën 15,000 euro, në favor të familjes M.

c) Shtetasi R. G ka qenë aksioner i vetëm dhe administrator në shoqërinë “****” sh.p.k., me aktivitet tregtar prej vitit 1994 e në vijim, e pajisur me NIPT ***. Kjo shoqëri, në fillimvitin 2012 ka përthithur dy shoqëritë “****” sh.a. (hotel “****”) dhe “****” sh.a., me NIPT ***. Pas përthithjes së këtyre dy shoqërive, në datën 12.1.2012, vlera e kapitalit të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, ka qenë 1,712,000,000 lekë. Ndërsa, referuar bilancit të depozituar nga subjekti (konfirmuar nga Komisioni pas verifikimit të kryer në faqen zyrtare të QKB-së) fitimi i realizuar nga kjo shoqëri për vitin 2012 ka qenë në vlerën 33,885,799 lekë.

Sa më sipër, rezulton se shtetasi R. G zotëron të gjitha aksionet e shoqërisë “****” sh.p.k., e pajisur me NIPT ***, me vlerë të konsiderueshme kapitali (në vitin 2012 rreth 1.7 miliardë lekë) dhe me fitim të deklaruar për vitin 2012 në shumën 33,885,799 lekë.

d) Shtetasi Xh.H (bashkëshorti i shtetasës B.H) ka qenë aksioner i vetëm dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., me aktivitet në fushën e mbledhjes së bimëve medicinale etj., i pajisur me NIPT ***, prej vitit 1995 e në vijim. Nga verifikimi i bilancit të vitit 2013 rezulton se fitimi i këtij aktiviteti për vitin 2012 ka qenë në vlerën 20,376,928 lekë.

Gjithsesi, subjekti ka deklaruar që shtetasja B.H i ka shpjeguar se shuma e dhuruar ka si burim shitjen në vitin 2012 të një pasurie të paluajtshme (njësie tregtare) në rrugën “****”, Tiranë, në shumën 10,000,000 lekë.

e) Ndërsa, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në lidhje me shtetasin P.Sh konstatohet se, në referim të deklaratës noteriale të datës 11.3.1998, ai është caktuar nga babai i tij M.Sh për të vijuar aktivitetin e tij privat të tregtimit të artikujve të ndryshëm.

Shtetasi H.Sh (djali i z. P.Sh) është i regjistruar si person fizik tregtar me aktivitet bar-kafe, i pajisur me NIPT ***, prej vitit 2009 e në vijim, me adresë ushtrimi aktiviteti në rrugën “****”, godinë 1-katëshe, përballë godinës *** , në Q.S.

Shtetasi P.Sh figuron si përfaqësues me prokurë i nënës së tij N.Sh, e cila, së bashku me dy shtetas të tjerë, në datën 2.6.2004 kanë shitur pasurinë e llojit “truall” me sip. 600 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë.

Në vijim rezulton se në nëntor të vitit 2007, shtetasi P.Sh ka lidhur një kontratë kredie me Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot “Intesa Sanpaolo Bank”) në vlerën 80,000 euro, me synim pagesën e detyrimit ndaj shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., për rikonstruksion të ambienteve “****”.

Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të llogarive të shtetasit P.Sh konstatohen dy kredi të marra në “ProCredit Bank”: (i) në datën 14.7.2007, disbursuar shuma 600,000 lekë; dhe (ii) në datën 31.7.2009, disbursuar shuma 1,500,000 lekë, si dhe dy kredi të tjera të marra në “Intesa Sanpaolo Bank”; (iii) disbursuar në datën 29.12.2009 shuma 5,300 euro; dhe (iv) disbursuar në datën 18.7.2011, shuma 50,000 euro.

Gjithashtu rezulton se në vitet 2005 – 2006, nga llogaria e këtij shtetasi në “Intesa Sanpaolo Bank” janë kryer transaksione në vlera të konsiderueshme (kreditime/debitime llogarie).

Në analizë përfundimtare të deklaramëve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, kushteve dhe rrethanave në të cilat janë gjendur subjekti dhe personi i lidhur në pranimin e këtyre vlerave monetare, nisur nga fakti i depozitimit të këtyre vlerave monetare *cash* nga vetë donatorët/dhuresit në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, e hapur për këtë qëllim, pranimit prej tyre të donacionit/dhurimit të kryer dhe deklarimit të qëllimit të kryerjes së këtij dhurimi, si ndihmë financiare për shërimin e të aksidentuarit, B. M, si dhe faktit se këto vlera monetare rezultojnë se kanë shërbyer totalisht për mbulimin shpenzimeve mjekësore, një pjesë e madhe prej tyre janë vetëdeklaruar nga subjekti, Komisioni çmon se është arritur niveli i kërkuar i provueshmërisë mbi ligjshmërinë e të ardhurave të donatorëve/dhuresve dhe, në këtë kuptim, nuk ka dyshime mbi ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat janë deklaruar si burime financiare për të justifikuar donacionet/dhurimet e kryera.

f) Lidhur me donacionet/mbulimin e shpenzimeve për kurimin e djalit, të bëra nga shtetasja V. K (H) për vitet 2013 – 2014, siç u konstatua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa dokumente që lidhen me rimbursimin e tatimeve në shtetin kanadez¹³² për personin tjetër të lidhur, për periudhën 2000 – 2014, nga ku krahas të ardhurave të përfituara për vitet 2000 – 2012, në total për shumën 337,523 dollarë kanadezë, rezulton se për vitin 2013 ka përfutuar të ardhura në shumën 63,054 dollarë kanadezë dhe për vitin 2014 ka përfutuar të ardhura në shumën 67,176 dollarë kanadezë.

Subjekti depozitoi deklaratën noteriale¹³³ të datës 27.5.2022, në të cilën shtetasja V.H(K) konfirmon pagesat e kryera për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjekësor të kushëririt të saj B.M, si dhe pagesa të tjera kryera në funksion të kurimit të tij, pagesa për të cilat thotë se një pjesë janë kryer nga numri i saj i llogarisë bankare në Kanada dhe një pjesë tjetër nëpërmjet kartës së kreditit të saj¹³⁴.

Në vijim të komunikimit që lidhet me kërkesat/pyetjet e bëra, përgjigjet dhe dokumentacionin e depozituar për pyetësonin nr. ***, konkretisht të pyetjes nr. ***, nëpërmjet të cilës Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë *statement* të llogarisë bankare apo të kartës/kartave të kreditit/debitit etj., të shtetasës V.K (në formën e kërkuar nga ligji), duke pasqyruar vetëm pagesat e kryera për mbulim shpenzimesh mjekësore të djalit të saj dhe të tjerave në funksion të tyre, subjekti ka deklaruar se¹³⁵ pasi mbesa e bashkëshortit të saj ka komunikuar me bankën, kjo e fundit i ka kthyer përgjigje se nuk mund të japë informacion bankar për një periudhë më të hershme se 84 muaj (7 vjet).

¹³²Të përkthyer nga përkthyesi zyrtar L.F, konfirmuar me vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 6.5.2022; nr. *** rep., datë 6.5.2022; nr. *** rep., datë 25.4.2022; nr. *** rep., datë 26.4.2022, të redaktuara nga noteri publik N.K.

¹³³Deklaratë noteriale e datës 27.5.2022, redaktuar nga noteri R.S, në Toronto, Kanada, e përpiluar në gjuhën shqipe.

¹³⁴Referohuni shpjegimeve shtesë në lidhje me pyetësonin nr. ***, dërguar në rrugë elektronike me *e-mail*-in e datës 31.5.2022, si dhe dokumentacionit mbështetës të depozituar në protokollin e Komisionit me nr. *** prot., datë 31.5.2022.

¹³⁵Përgjigjet dhe dokumentet e depozituara në Komision, protokolluar me nr. *** prot., datë 4.8.2022.

Në mbështetje të deklaramit të bërë, subjekti ka depozituar kopje të dokumenteve: (i) shkresë “TD C.T”, datë 12.7.2022 (përkthyer nga përkthyesja e licencuar G.M, noterizuar në datën 1.8.2022, me nr. *** rep.); (ii) marrëveshje për shërbim bankar *online* e “****”, për klientët e llogarisë personale (përkthyer nga përkthyesja e licencuar G.M noterizuar në datën 1.8.2022, me nr. *** rep.); (iii) fletë të printuara nga faqja zyrtare *Online Banking* e “****”.

Siç u konstatua edhe më sipër, në seancën dëgjimore të datës 26.9.2010, subjekti ka depozituar kopje të deklaratave të taksave dhe dokumenteve që lidhen me rimbursimin e tatimeve në shtetin kanadez për shtetasen V.K, për periudhën 2000 – 2014, të cilat rezultojnë se janë të njësuara me origjinalin nga noter publik në Ontario, Kanada, të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja e licencuar L.F, nga ku konfirmohet se shtetasja V.K për vitin 2013 ka përfituar të ardhura në shumën 63,054 dollarë kanadezë dhe për vitin 2014 ka përfituar të ardhura në shumën 67,176 dollarë kanadezë.

Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur, shtetasja V.K, ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shpenzimet/pagesat e kryera në funksion të trajtimit shëndetësor të djalit të subjektit.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

42. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues konkludon se:

i) Lidhur me pasurinë godinë banimi, 3 kate + papafingo, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës së tyre takuese.

ii) Lidhur me pasurinë së llojit “automjet”, të markës “****”, tip “****”, vit prodhimi 2008, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen në datën 10.2.2014.

Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

43. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramiteve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

43.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

43.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

43.3. Komisioni ka kërkuar nga DSIK-ja përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit, në përgjigje të të cilit janë dërguar shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme.

43.4. Në këtë kontekst, DSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, porse me vendimin nr. ***, datë 20.1.2021, të KDZH-së ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

43.5. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

44. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

45. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dokumenteve ligjore/dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

45.1. Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, arsyetimin ligjor, si dhe ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit të çështjeve gjyqësore. Gjithashtu konstatohet se kjo gjyqtare ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, si dhe për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

45.2. Por, gjithsesi, në raport janë konstatuar disa gjetje që lidhen me: (i) në një rast për kohëzgjatjen e gjykimit; (ii) arsyetimin e vendimeve jashtë afatit ligjor 5-ditor; si dhe (iii) mosrespektim të afateve në shtyrjen e seancave.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

46. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë

dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, nga ku rezulton se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me kriterin e vlerësimit profesional. Por, Komisioni vlerësoi se qëndrojnë gjetjet e konstatuara në raportin për analizën e aftësive profesionale, për të cilat subjektit iu kërkuan shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit.

46.1. Në vlerësimin e gjyqtarës Mataj (Demiraj) u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe tetë denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor veprimet e kryera prej saj në shqyrtimin gjyqësor për çështjet që lidhen me dy denoncime, si më poshtë vijon:

47. Denoncim i shtetasës E.C¹³⁶

47.1. Referuar kësaj ankese konstatohet se denoncuesja ngre pretendime për zvarritje të procesit gjyqësor penal, si dhe për zbardhjen e vendimit nga gjyqtarja në shkelje të afateve ligjore, kjo, sipas saj, e bërë me qëllim që t'i kalonin afatet e ankimit.

47.2. Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë aktet e dosjes gjyqësore penale që lidhen çështjen objekt denoncimi¹³⁷; kopje të vendimit dhe akteve të dosjes gjyqësore, së bashku me kopje të njësuara me origjinalin të fletës së regjistrit penal të seancës paraprake për datën e dorëzimit të dosjes në sekretari.

47.3. Nga verifikimi i akteve që lidhen me çështjen gjyqësore objekt denoncimi konstatohet se, pas kërkesës së bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Pushimin e çështjes penale që i përket një procedimi penal të regjistruar në vitin 2018”, për veprën penale “mashttrim”, gjyqtarja Shefkie Mataj (Demiraj), në datën 7.2.2019 ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal.

47.4. Referuar fletës së regjistrit penal të seancës paraprake rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja në datën 25.2.2019, pas 18 ditëve nga shpallja e vendimit, pra jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

47.5. Sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegimet/argumentet e saj lidhur me konstatimin e mësipërm, si dhe të provonte me dokumentacion justifikues veprimet e kryera prej saj në shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore penale që nga momenti i marrjes në dorëzim të kërkesës për pushimin e çështjes deri në dhënien e vendimit.

47.6. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të konfirmonte nëse ishte njoftuar shtetasja E. C. (denoncuesja) mbi vendimin e marrë nga gjykata në datën 7.2.2019, për pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal, duke depozituar shkresën/dëftesën e komunikimit me anë të së cilës është përcjellë njoftimi së bashku me konfirmimin postar dhe/apo konfirmimin e shtetasës së sipërcituar.

48. Denoncim i shtetasës A.M¹³⁸

48.1. Referuar kësaj ankese konstatohet se denoncuesja ngre pretendime lidhur me caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A.M, i kallëzuar prej saj dhe i hetuar për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal. Denoncuesja

¹³⁶Ankesë nr. *** prot., datë 20.5.2019.

¹³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2022, e Komisionit dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.5.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2022.

¹³⁸Ankesë nr. *** prot., datë 16.7.2019.

pretendon se në vendimin për caktimin e masës së sigurimit personal gjyqtarja ka shënuar se është i padënuar, ndërkohë që, sipas saj, ai ka pasur tri dënime penale.

48.2. Komisioni administroi aktet e dosjes gjyqësore penale që lidhen me caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A.M¹³⁹, nga verifikimi i të cilave rezulton se gjyqtarja ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” dhe se ky shtetas figuron me gjendje gjyqësore i dënuar më parë. Konstatohet se në vendimin për caktimin e masës së sigurimit personal, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: “...kjo masë sigurimi për ligj kushtet dhe kriteret e neneve 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale është në përputhje me personalitetin e subjektit, i cili është i padënuar më parë për asnjë vepër penale...”.

48.3. Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime mbi këto konstatime, si dhe të argumentonte mbi kriteret dhe kushtet në të cilat u bazuan në disponimin me vendim për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi”.

49. Gjithashtu, pas verifikimit të informacioneve të pasqyruara në burime të hapura mbi çështje të gjykuara nga subjekti rivlerësimit, Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁰: (i) kopje të vendimit gjyqësor penal që lidhet me çështjen “****”, si dhe (ii) dosjen gjyqësore, që i përket çështjes penale me të pandehur shtetasin A.P, dënuar në vitin 2008, për kryerjen e veprës penale “heqje të paligjshme të lirisë”, parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal.

49.1. Pas shqyrtimit të këtyre dy çështjeve, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte në mënyrë të përmbledhur shpjegimet/argumentet e saj mbi vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (në përbërje të trupit gjykues të së cilit figuron si anëtare edhe subjekti i rivlerësimit) që lidhet me çështjen “****”, si dhe të jepte shpjegime shteruese dhe të argumentonte mbi arsyet dhe kriteret në të cilat u bazua në dhënien e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit A.P, dënuar me gjobë nga gjykata në vitin 2008, për kryerjen e veprës penale “heqje të paligjshme të lirisë”.

49.2. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet/argumentet e saj, si dhe depozitoi prova lidhur me gjetjet e relatuar në raportin për analizimin e aftësive profesionale për veprimet e kryera prej saj në shqyrtimin e dy çështjeve gjyqësore që lidhen me denoncimet e depozituara nga publiku, si dhe për dy çështjet e tjera të verifikuara nga Komisioni, të konstatuara si më sipër.

49.3. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet në raportin e KLGJ-së, mbi problematikat e ngritura pas shqyrtimit të dy denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe mbi dy çështjet e tjera gjyqësore të trajtuara, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të mjaftojnë për të mbërritur në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

50. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe dy çështjeve të tjera gjyqësore të trajtuara, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe dokumentacionit të administruar për këtë kriter, Komisioni çmon se në vlerësimin e

¹³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2022, e Komisionit dhe shkresë kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 23.5.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2022.

¹⁴⁰(i) Shkresat e dërguara nga Komisioni: (a) me nr. *** prot., datë 16.6.2022; dhe (b) nr. *** prot., datë 4.7.2022; (ii) Shkresat kthim përgjigjeje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: (a) me nr. *** prot., datë 30.6.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.6.2022; dhe (b) nr. *** prot., datë 27.7.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2022).

përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

50.1. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

V. KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. subjekti arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shefkie Mataj (Demiraj), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.9.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Pamela QIRKO
Relatore

Valbona Sanxhaktari
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

| | 1992-2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|--------------------|-------------------|------------------|
| A) PASURI | 12,083,250 | 888,800 | 847,372 | 715,112 | 1,012,982 | 2,139,768 | 1,769,280 | 1,290,872 | 2,257,745 | 3,468,932 | 10,648,866 | -10,080,043 | -1,314,131 | 721,681 |
| Blerje apartamenti të përshtatur në njësi tregtare 73 m2, në Bajram Curri | 600,000 | | | | | | | | | | | | | |
| Truall në Tiranë, *** | 2,483,250 | | | | | | | | | | | | | |
| Shtëpi banimi tre kate + papafingo e ndërtuar në vitet 1998-2012 Truall më sipërfaqe 709.5 m2. | 9,000,000 | 888,800 | 744,950 | 406,650 | 600,000 | 368,500 | 2,460,500 | 1,220,850 | 1,913,600 | 2,076,800 | | | | |
| Automjeti ***, blerë në datë 03.10.2008. | | | | | | 500,000 | | | | | | | | |
| Automjeti ***, blerë në datë 09.2.2012. | | | | | | | | | | 950,000 | | | | |
| Automjeti ***, blerë në datë 10.2.2014. | | | | | | | | | | | | 950,000 | | |
| Ndryshim likuiditeti | 0 | 0 | 102,422 | 308,462 | 412,982 | 1,271,268 | -691,220 | 70,022 | 344,145 | 442,132 | 10,648,866 | -11,030,043 | -1,314,131 | 721,681 |
| B) DETYRIME | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| C) PASURI NETO (A-B) | 12,083,250 | 888,800 | 847,372 | 715,112 | 1,012,982 | 2,139,768 | 1,769,280 | 1,290,872 | 2,257,745 | 3,468,932 | 10,648,866 | -10,080,043 | -1,314,131 | 721,681 |
| D) TË ARDHURA | 10,793,727 | 1,358,464 | 1,423,535 | 1,504,295 | 1,703,924 | 2,598,982 | 2,649,890 | 2,791,254 | 2,766,485 | 4,393,483 | 21,889,694 | 5,113,862 | 2,627,793 | 3,274,191 |
| Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar bashkëshorti në Bajram Curri | 5,000,000 | | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga paga si i vetpunësuar, b/shorti subjektit | 91,030 | | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga vëllai /familja e vëllait të bashkëshortit të subjektit | 600,000 | 388,800 | 444,950 | 406,650 | | 368,500 | 460,500 | 520,850 | 513,600 | 1,576,800 | | | | |
| Të ardhura nga paga subjektit i rivlerësimit | 4,036,915 | 969,664 | 978,585 | 828,458 | 797,160 | 815,784 | 1,045,153 | 1,043,851 | 1,067,319 | 1,085,817 | 1,072,169 | 1,307,748 | 1,319,635 | 1,323,127 |
| Të ardhura nga paga bashkëshorti i subjektit | 65,782 | - | - | 269,187 | 808,281 | 1,293,198 | 1,020,037 | 1,102,353 | 1,061,366 | 1,185,665 | 1,274,070 | 1,233,766 | 929,054 | |
| Të ardhura bashkëshorti i subjektit aktiviteti si P.Fizik Avokat | | | | | | | | | | | | | 19,469 | 304,216 |
| Të ardhura nga paga bashkëshorti i subjektit si i punësuar P.Fizik Avokat | | | | | | | | | | | | | 68,803 | 345,192 |
| Të ardhura si Këshilltar njësjë Bashkiake nr.*** bashkëshorti i subjektit | - | - | - | - | 98,483 | 121,500 | 124,200 | 124,200 | 124,200 | 134,550 | 124,200 | 124,200 | 73,800 | |
| Të ardhura nga paga personi I lidhur - B.M | | | | | | | | | | 410,651 | 45,340 | | | |
| Të ardhura nga ISSH / KEMP / ndihmë ekonomike personi I lidhur - B. M | | | | | | | | | | | 108,516 | 217,032 | 217,032 | 217,032 |
| Të ardhura nga A.K.K.P për shpronësimin e truallit në rr. *** | | | | | | | | | | | 4,755,648 | | | 1,084,624 |
| Të ardhura nga Ministria shëndetësisë për kurimin e personit të lidhur | | | | | | | | | | | 3,292,951 | | | |
| Të ardhura të dhuruara / donacione nga të afërmit, për shpenzime kurimi për personin e lidhur | | | | | | | | | | | 11,216,800 | 1,550,568 | | |
| Të ardhura nga interesat e depozitave bankare | | | | | | | | | | | | 230,548 | | |
| Të ardhura nga shitja e automjetit ***, shitur 10.2.2014. | | | | | | | | | | | | 450,000 | | |
| Të ardhura nga shitja në dt. 17.12.1999 e ap. të përshtatur në njësi tregtare 73 m2, në Bajram Curri. | 200,000 | | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga shitja e apartament banimi 3+1 në Bajram Curri me sip 96 m2. Shitur në dt 06.12.2001. | 800,000 | | | | | | | | | | | | | |
| E) SHPENZIME | 3,332,369 | 375,456 | 438,228 | 747,486 | 848,755 | 854,436 | 979,405 | 1,495,544 | 683,480 | 866,334 | 9,769,317 | 8,948,959 | 1,782,706 | 1,749,016 |
| Shpenzime jetike | 2,922,869 | 375,456 | 438,228 | 438,228 | 546,480 | 546,480 | 546,480 | 546,480 | 546,480 | 564,096 | 564,096 | 879,992 | 897,104 | 940,368 |
| Shpenzime për kurimin e personit të lidhur | | | | | | | | | | | 8,618,008 | 6,356,967 | | |
| Shpenzime Z. K.M për personin e lidhur | | | | | | | | | | | | 342,000 | 792,000 | 484,000 |
| Shpenzime vendosje ashensori | | | | | | | | | | | | 1,000,000 | | |
| Shpenzime mobilimi | 409,500 | | | | | | 90,000 | 280,000 | 137,000 | 45,000 | 100,000 | 370,000 | | |
| Shpenzime për arsimin e fëmijëve | | | | 309,258 | 302,275 | 307,956 | 342,925 | 347,025 | | | | | | 243,486 |
| Shpenzime udhëtimi jashtë vendit | | | | | | | | 322,039 | | 257,238 | | | 93,602 | 81,162 |
| Shpenzime për rivlerësim pasurie në ASHK | | | | | | | | | | | 487,213 | | | |
| Balanca e fondeve (D-C-E) | -4,621,892 | 94,208 | 137,935 | 41,698 | -157,813 | -395,222 | -98,795 | 4,838 | -174,740 | 58,217 | 1,471,511 | 6,244,946 | 2,159,218 | 803,494 |

